5) Të dhënat e Inventarit të Emisioneve për IDM		
1	Korrik 2018	Regjistri i matjeve në TC Kosova A dhe TC Kosova B për IE
2	Korrik 2018	Analiza e Linjtit TC Kosova A dhe B
Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.		
1) Prezantimi, etj. për Matjen e gazit të shkarkuar		
1	11 prill 2018	Matja në terren e gazit nga oxhaku
2	26 prill 2018 4 maj 2018	Llogaritja e mostrimit iso-kinetik të pluhurit (për 1 pikë)
2) Rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar		
1	9 Maj 2018	Rezultatet e matjeve të emisioneve në TC Kosova A
3) Procedura Standarde Operative (PSO) për Matjen e gazit të shkarkuar		
1	4 maj 2018	Procedura Standarde Operative (PSO) për Matjen e përmbajtjes së Pluhurit
2	Gusht 2019	Procedura Standarde Operative (PSO) për Matjen e Gazit të Shkarkuar me PG-350
Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit		
Nuk ka materiale		
Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.		
Nuk ka materiale		
Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.		
1) Materialet e seminarit për simulim		
1	11 dhjetor 2017	Modeli i Simulimit: Hyrje
2	20 dhjetor 2017	Modeli i Simulimit: Të dhënat e nevojshme

2) Materialet për punëtori të simulimit			
	1	14 maj 2018	Të Dhënat Hyrëse: Lartësia
	2	17 maj 2018	Të Dhënat Hyrëse: Përdorimi i tokës
	3	18 maj 2018	Të Dhënat Hyrëse: Programi MAKEGEO
	4	21 maj 2018	Shtesë: Procedura e Përgjithshme
	5	21 maj 2018	Shtesë: Si ta shfaqim Hartën e Rrjetit të Rezultuar CTGPROC
Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare për kontrollin e ndotjes së ajrit bazuar në të dhënat teknike.			
Nuk ka materiale			
Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.			
1) Materialet e seminarit dhe prezantimeve			
	1	1 dhjetor 2017	Pasqyra e Planit për Zvogëlimin e Emisioneve për IDM
	2	1 dhjetor 2017	Prezantimi i aktiviteteve të Grupit për Kaldaja
	3	4 dhjetor 2017	Orari i Grupit për Kaldaja
	4	4 dhjetor 2017	Shpjegimi i Hulumtimit të FES
	5	4 dhjetor 2017	Shtojca për FES <u>(Nuk ka version në shqip)</u>
	6	13 dhjetor 2017	Zvogëlimi i SO ₂ për IDM
	7	15 dhjetor 2017	Shpjegimi i Parimit të punës së FES-it
	8	15 dhjetor 2017	Përshkrim Shtesë
	9	6 prill 2018	Matja për studimin e shpejtësisë në FES
	10	6 prill 2018	Zvogëlimi i SO ₂ dhe Pluhurit në IDM
	11	6 prill 2018	Inspektimi i Brendshëm i FES-it në TC Kosova A
	12	12 prill 2018	Prezantimi i përmirësimit të performancës së FES-it
	13	12 prill 2018	Siguria e FES Puna në Brendësi
	14	8 maj 2018	Raporti i Hulumtimit të FES-it të TC Kosova-A
	15	25 maj 2018	Raporti i Sjelljes së SO ₂
	16	29 maj 2018	Masat mjedisore për IDM-të
2) Materiali për TC Kosova A			
	1	13 dhjetor 2017	Regjistri i operimit dhe Rezultatet e matjeve në TC Kosova A
	2	18 dhjetor 2017	Specifikacionet e FES Kosova A
	3	19 maj 2018	Analiza e Linjtit TC Kosova A
	4	19 maj 2018	Analiza e Linjtit TC Kosova B
Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së			

ajrit.		
1) Seminari		
1	20 prill 2018	Seminari: Historia e masave për ndotjen e ajrit në Japoni
Materialet e tjera (9)		
1) Materiali i prezantimit për Ministrin e MMPHI/MMPH		
1	1 nëntor 2017	Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës: Pasqyra
2	12 shkurt 2018	Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës: Pasqyra
3	11 korrik 2018	Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës: Progresi në periudhën e parë (tetor 2017 ~ qershor 2018)

2. Periudha e dytë: 12 tetor 2018 ~ 30 shtator 2019

Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.		
Nr.	Data	Titulli
1	19 tetor 2018	Plani i punës për periudhën e dytë IE dhe Simulimi
2) Materialet e seminarit dhe ligjëratave		
1	24 tetor 2018	Pasqyra e progresit të IE
2	24 tetor 2018	Pasqyra e progresit të IE (e detajuar)
3	24 tetor 2018	Progresi i IE (PIPP, Bujqësia, Pylltaria dhe Përdorimi Tjetër i Tokës (këtu e tutje “AFOLU”), Mbeturinat)
4	5 qershor 2019	Progresi i IE-së (Djegiet e vogla, Nën-sektori i shërbimeve dhe bizneseve)
5	5 qershor 2019	Progresi i IE-së (Djegiet e vogla, Nën-sektori i amvisërive)
3) Materialet e Trajnimi në punë (TNP)		
1	29 tetor 2018	Struktura e Dosjes së Llogaritjes së Inventarit të Emisioneve
2	29 dhe 30 tetor 2018	TNP për Emisionet nga Djegiet e Vogla: Amvisëritë
3	30 janar 2019	TNP për Emisionet nga KEK-u
4	4, 5 dhe 6 shkurt 2019	TNP për Emisionet nga KEK-u
Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.		
1) Rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar		
1	21 janar 2019	Raporti_1 për matjet në fabrikën e Ferronikelit
2	22 maj 2019	Raporti_2 për matjen në fabrikën e Ferronikelit
3	22 maj 2019	Raporti_1 për matjen në fabrikën e blloqeve
Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit		

1) Prezantimi, etj. për Inventarin e Emisioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit		
1	26 tetor 2018	Hyrje për MCA
2	26 tetor 2018	Temat: Monitorimi i Cilësisë së Ajrit
3	21 qershor 2019	Kërkesa për konfigurimin e SMCA-ve
4	13 qershor 2019	Kërkesa për konfigurimin e SMCA për Ekranin për shfaqjen e të dhënave
5	17 qershor 2019	Menaxhimi i të dhënave të analizatorëve të SMCA-ve
6	13 qershor 2019	Sugjerim për mirëmbajtjen e monitorimin e cilësisë së ajrit
2) Raportet, etj.		
1	Tetor 2018	Përmbledhja e Inspektimit të Stacioneve të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit në të gjithë Kosovën
2	7 gusht 2018	RAPORTI FINAL nga AGS
3	27 maj 2019	Zëvendësimi i kabinave për 3 (tri) SMCA në Zonën e Prishtinës
4	27 maj 2019	Rehabilitimi i SMCA-ve në zonën e Prishtinës
3) PSO-të dhe manualet		
1	Shkurt 2019	Prezantimi i SG741 për IHMK-në
Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.		
1) Prezantimet, etj. për analizat laboratorike		
1	26 Prill 2019	Prezantimi i Metoda Standarde Referente
2) Raportet, etj.		
1	Gusht 2018	Raporti i servisimit (ICP-MS)
2	12 tetor 2018	Raporti për ICP-MS
3	27 janar 2019	Rezultati i analizës së Metaleve të rënda nga TSP dhe PM10
4	Prill 2019	Raporti për Jon Kromatografin
5	Prill 2019	Versioni i detajuar i Raportit për Jon Kromatografin
6	Korrik 2019	Draft rezultati i analizës së metaleve të rënda në Drenas
3) PSO		
1	15 Prill 2019	PSO për mostrimin e gazit për SO _x
2	15 Prill 2019	PSO për mostrimin e gazit për NO _x
3	15 Prill 2019	PSO për mostrimin e gazit për Hg
Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.		
1) Prezantimet, etj. për simulimin		
1	Qershor 2019	Rezultati Preliminar i Modelit të Simulimit
2) Materialet e punëtorive dhe seminareve, etj. për simulim		
1	12 dhe 13 nëntor 2018	Modeli i simulimit 06 Të Dhënat Hyrëse - READ62 (Para-procesori i të dhënave të ajrit në shtresën e lartë)

	2	15 dhe 16 nëntor 2018	Modeli i simulimit 07 Të Dhënat Hyrëse - SMERGE (Para-procesori i të dhënave meteorologjike të sipërfaqes)
	3	21, 23 dhe 30 nëntor 2018	Modelimi i simulimit 08 CALMET: (Modeli meteorologjik)
	4	15 dhe 20 shkurt 2019	Modelimi i simulimit 09 Të Dhënat Hyrëse - Të dhënat e emisioneve
	5	20, 21, 22 dhe 25 shkurt 2019	Modelimi i simulimit 10 Të Dhënat Hyrëse - Programi kryesor (MAIN)
	6	24 dhe 29 shkurt 2019 6 dhe 7 qershor 2019	Modelimi i simulimit 11 Të Dhënat Hyrëse - Të dhënat e emisioneve
Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare për kontrollin e ndotjes së ajrit bazuar në të dhënat teknike.			
Nuk ka materiale			
Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.			
1) Materialet e prezantimeve			
	1	23 tetor 2018	Shpjegimi i përmirësimit të performancës së FES-së
	2	23 tetor 2018	Prezantimi në KEK. - SH. Lajqi (UP)
	3	25 tetor 2018	Shpjegimi i përmirësimit të performancës së FES-së
	4	30 tetor 2018	Kontrolli i energjizimit të FES-së
	5	30 tetor 2018	Zvogëlimi i Tymit nga Djegia e Naftës
	6	31 tetor 2018	Procedura e Testit për Zvogëlimin e NO _x
	7	22 mars 2019	Matja e Shpërndarjes së Rrjedhës së Ajrit në FES në TC Kosova A
	8	27 mars 2019	Inspektimi i Brendshëm i FES
	9	8 prill 2019	Plani i masave për zvogëlimin e SO ₂
	10	1 maj 2019	De-Sulfurimi në Vatër
2) Materialet e punëtorive dhe seminareve			
	1	26 tetor 2018	Masat mjedisore për IDM (1)
	2	31 tetor 2018	Zvogëlimi i NO _x në Kaldajën Ekzistuese
	3	1 nëntor 2018	Prezantimi për FES
	4	9 nëntor 2018	Masat mjedisore për IDM (2)
	5	28 mars 2019	Studimi për Zvogëlimin e SO ₂
	6	29 mars 2019	Kontrolli i energjizimit të FES-së
	7	12 prill 2019	Përmirësimi i Performancës së FES-së në TC Kosova A
	8	24 prill 2019	Masat mjedisore për IDM
3) Raportet, etj.			
	1	5 nëntor 2018	Kërkesa për Energjizim (draft)

	2	5 nëntor 2018	Fleta e bashkëngjitur e kërkesës
	3	8 nëntor 2018	Plani i rimodelimit të pllakave drejtuese
	4	3 Dhje. 2018	Rezultatet e simulimit të FES-së nga UP
	5	8 maj 2019	SO ₂ kundrejt Lokacionit të mullirit i cili nuk është në operim
	6	9 maj 2019	Krahasimi i të dhënave të 26 dhe 30 prillit
	7	19 maj 2019	Konsiderimi i SO ₂ kundrejt Ndryshimit të Operimit të Kaldajës
	8	9 korrik 2019	Masat e kontrollit të emisioneve për IDM
Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.			
1) Prezantimet, etj.			
	1	Janar 2019	Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030
	2	28 janar 2019 29 janar 2019	Rishikimi i Masave duke përdorur 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (këtu e tutje “OZhQ”)
	3	19 prill 2019	Vlerësimi i masave të kontrollit të ndotjes së ajrit
Materialet e tjera (9)			
1) Materiali i prezantimit për Ministrin e MMPHI/MMPH			
	1	29 tetor 20178	Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës: Pasqyra e Inventarit të Emisioneve
	2	Qershor 21, 2019	Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës: Rezultati Preliminar i Modelit të Simulimit
2) Materialet për trajnimin e parë në Japoni			
	1	28 shkurt 2019	Detyra e palës kosovare gjatë Trajnimit në Japoni
	2	1 mars 2019	Dokumenti i trajnimit i MMJ-së
	3	1 mars 2019	Masat mjedisore për IDM (2)
	4	4 mars 2019	Monitorimi i cilësisë së ajrit në Yokohama
	5	5 mars 2019	Marrëveshja Historike e Yokohama
	6	5 mars 2019	Rregulloret e Yokohama
	7	6 mars 2019	Procedura për Menaxhimin e Ndotjes në Trafik
	8	8 mars 2019	Matjet/analizat mjedisore
	9	11 mars 2019	Përvoja e z. Nihei në QMT
	10	12 mars 2019	Prezantimi final nga pala kosovare

3. Periudha e tretë: 27 shtator 2019 ~ 30 qershor 2021

Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta shtjelluar inventarin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

1) Prezantimi, etj. për Inventarin e Emisioneve

Nr.	Data	Titulli
1	5 nëntor 2019	Korniza Institucionale për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve
2	6 nëntor 2019	Progresi i Inventarit të Emisioneve për Kategorinë e Djegieve të vogla (Komeriale/institucionale të palëvizshme)
3	19 nëntor 2019	Metoda e Llogaritjes së Emisioneve nga Automjetet
4	28 Nën. 2019	Struktura e Përgatitjes së Inventarit të Emisioneve
5	27 janar 2020	Detyrat e Mbetura për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve
6	3 mars 2020	Ligjërata Përfundimtare për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve
2) Materialet e ligjëratis për Universitetin e Prishtinës		
1	27 shkurt 2020	Ligjërata për Metodën e Llogaritjes së Emisioneve nga Automjetet
3) Materialet për diskutim me MCC/MFK		
1	31 tetor 2019	Struktura e Përgatitjes së Inventarit të Emisioneve nga Projekti
2	6 prill 2020	Aktiviteti i JICA-s për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve (takimi me Skype)
4) Pyetësorët e intervistës së hulumtimit për Komuna		
1	26 nëntor 2019	Kërkesa për të dhëna nga Komuna e Obiliqit
2	29 nëntor 2019	Kërkesa për të dhëna nga Komuna e Fushë Kosovës
5) Seti i të dhënave për TNP për përgatitjen e inventarit të emisioneve		
1	2 dhjetor 2019	Seti i Dosjeve të Llogaritjes së Inventarit të Emisioneve për TNP
6) Manuali për përgatitjen e inventarit të emisioneve		
1	29 maj 2020	Manuali për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve të Ndotësve të Ajrit
Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.		
1) Prezantimi për matjen e gazit të shkarkuar		
1	Shkurt 2020	Ligjërata për matjen e gazit të shkarkuar
2) Rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar		
1	Nëntor 2019	Raporti i Matjes në Kompaninë e Asfaltit
2	Nëntor 2019	Raporti i Matjes në Kompaninë e Vajrave të Përdorura
3	Dhjetor 2019	Raporti_2 i Matjes në Fabrikën e Bllloqeve
4	Mars 2020	Pasqyra e të dhënave të matjes për IDM
Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit		
1) Prezantimet, etj. për monitorimin e cilësisë së ajrit		

	1	14 nëntor 2019	Seminari për SMCA: Manuali Japonez
	2	14 nëntor 2019	Zvogëlimi i të dhënave të pavlefshme në SMCA
2) Raportet, etj.			
	1	26 nëntor 2019	Ekranet për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit në Prishtinë
	2	Nëntor 2019	Udhëzimi për përndarjen e duhur të SMCA-ve
	3	Maj 2020	Ekрани për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit në Obiliq
3) PSO dhe/ose manualet			
	1	Mars 2020	Manuali i Mirëmbajtjes së SMCA-ve Bashkëngjitja-1 PSO për SG-741 Bashkëngjitja-2 Fleta për kontrollin e analizatorëve (Vetëm Anglisht)
	2	Janar 2020	PSO për NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ , PM _{2,5} në Emergjencia
Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.			
1) Raportet, etj.			
	1	Janar 2020	Metoda Standarde Referente për matjen e gazit
2) PSO dhe/ose manualet			
	1	Nëntor 2019	PSO (JK - Reagjentët, tretja standarde dhe mostër)
	2	Nëntor 2019	PSO (JK - Operimi)
	3	Nëntor 2019	PSO (Hg për AAS, Reagjentët)
Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.			
1) Materialet për prezantim të simulimit			
	1	3 mars 2020	Përmbledhja e Modelimit të simulimit
2) Materialet për punëtori të simulimit			
	1	7 nëntor 2019	Modeli i Simulimit: Të Dhënat Monitorimit të Cilësisë së Ajrit
	2	19, 21 nëntor 2019	Modeli i Simulimit: Të dhënat hyrëse –Emisionet (3) Burimet e zonës - Mbeturinat
	3	12, 19, 21 shkurt 2020	Modeli i Simulimit: Të dhënat hyrëse –Emisionet (5) Burimet e linjës - Automjetet
	4	8 prill 2021	Modeli i Simulimit: Emisionet e Fabrikës së blloqeve
3) Manuali			
	1	28 qershor 2021	Manuali i Simulimit
Rezultati 6: Përmirësohet vendimmarrja nga pala kosovare për kontrollin e ndotjes së ajri bazuar në të dhënat tekniket.			

1) Materialet e seminareve		
1	Janar 2020	Emisionet nga industria-1
2	Janar 2020	Emisionet nga industria-1_Llogaritja
3	Janar 2020	Emisionet nga industria-2-0
4	Shkurt 2020	Emisionet nga industria-2-1
5	Shkurt 2020	Emisionet nga industria-2_Llogaritja-1
6	Shkurt 2020	Emisionet nga industria-2_Llogaritja-2
7	Shkurt 2020	Emisionet nga industria-3
8	Shkurt 2020	Emisionet nga industria-3_Llogaritja
9	Shkurt 2020	Emisionet nga industria-4
Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.		
1) Materialet e prezantimeve		
1	19 mars 2021	Informacionet shitesë për Kaldajën
2	19 mars 2021	Zgjidhja e problemeve për FES të TC Kosova A
2) Raportet, etj.		
1	28 Nën. 2019	Studimi i të Dhënave të Operimit të TC Kosova A
2	8 shkurt 2020	Analiza e të dhënave për SO ₂ dhe NO _x
3	1 mars 2020	Masat mjedisore për TC Kosova A
4	Nëntor 19,2020	Ndryshimi i Ngarkesës së Kaldajës Kosova A-5
5	20 nëntor 2020	Kontrolli i Rrjedhës së Lëndës Djegëse për Kaldajën e Llojit me Daulle (Tambur)
6	01 dhjetor 2020	Ndikimi i zvogëlimit të ngarkesës së kaldajës në NO _x
3) Materialet për TC Kosova A		
1	28 Nën. 2019	Të dhënat e operimit gjatë matjes, nëntor 2019
Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.		
1) Materialet e seminareve		
1	5 nëntor 2019	Masat e politikave për materiale të diskutimit
2	20 nëntor 2019	Masat e politikave për përmbajtjen e amvisërive
3	22 nëntor 2019	Masat e politikave për përmbajtjen e automjeteve
4	25 nëntor 2019	Seminari për masat e politikave
5	3 dhjetor 2019	Masat e politikave - skenari i amvisërive
6	5 dhjetor 2019	Masat e politikave - skenari i automjeteve
7	22 janar 2020	Masat e politikave - Draft fleta e vlerësimit

	8	11 shkurt 2020	Masat e politikave - Ligjërata për progresin
	9	4 mars 2020	Masat e politikave - Ligjërata përfundimtare
Materialet e tjera (9)			
1) Materiali i prezantimit për Ministrin e MMPHI/MMPH			
	1	19 shkurt 2020	Prezantimi për ministrin
	2	30 korrik 2020	Prezantimi për Sekretarin e Përgjithshëm të MEA
2) Materialet për trajnimin e dytë në Japoni			
	1	2 shtator 2019	Detyra - trajnimi i dytë në Japoni
	2	3 shtator 2019	Politika e Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit në Japoni
	3	3 shtator 2019	Kontrolli i ndotjes së ajrit në Kawasaki
	4	3 shtator 2019	SMCA në Kawasaki
	5	4 shtator 2019	Monitorimi i cilësisë së ajrit në Yokohama
	6	6 shtator 2019	MMJ_Statistikat për CO2_Amvisëritë
	7	9 shtator 2019	JARI-Inventari i Emisioneve
	8	9 shtator 2019	IE dhe Simulimi i NIES
	9	10 shtator 2019	Hulumtimi i përbashkët në Japoni - Ajri Hulumtimi i përbashkët në Japoni - Uji
	10	10 shtator 2019	Procedura për Menaxhimin e Ndotjes në Trafik
	11	10 shtator 2019	Kontrolli i cilësisë së ajrit në Tokio
	12	10 shtator 2019	Prezantimi i Politikës në Tokio (Vetëm versioni në anglisht dhe nuk ka dosje në Word)
	13	11 shtator 2019	Prezantimi i Nihei
	14	12 shtator 2019	Prezantimi final nga pala kosovare
3) Aktivitetet shtesë			
	1	27 nëntor 2020	Diskutimi për Draft raportin e përfundimit
	2	24 nëntor 2020	Krijimi i Kornizës Institucionale për simulim
	3	30 nëntor 2020	Analiza e cilësisë së ajrit gjatë karantinës
	4	7 dhjetor. 2020	Seminari për menaxhimin e të dhënave të cilësisë së ajrit
	5	7 janar 2021	Diskutimi për ligjin e mbrojtjes së ajrit në Kosovë
	6	29 janar 2021	Diskutimi për ISO17025
	7	24 mars 2021	Përmbledhja e Aktiviteteve nga Distanca për Grupin e

		Modelimit të Simulimit
8	2 prill 2021	Përmbledhja e Aktiviteteve nga Distanca për Grupin e Inventarit të Emisioneve
9	6 prill 2021	Përmbledhja e Aktiviteteve nga Distanca për Grupin e Politik-Bërjes
10	21 qershor 2021	Mbështetja për analizën dhe vlerësimin e të dhënave të cilësisë së ajrit gjatë një viti
4) Materialet për Seminarin Përfundimtar		
1	9 qershor 2021	Prezantimi i Projektit “Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit”
2	9 qershor 2021	Aktivitetet e përmirësimit të monitorimit të cilësisë së ajrit
3	9 qershor 2021	Plani Kombëtarë për Zvogëlimin e Emisioneve në Kosovë dhe situata aktuale
4	9 qershor 2021	Matjet e emisioneve dhe Masat për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A
5	9 qershor 2021	Përgatitja e Inventarit të Emisioneve për Zonën e Prishtinës
6	9 qershor 2021	Simulimi i gjendjes së cilësisë së ajrit në zonën e Prishtinës
7	9 qershor 2021	Vlerësimi i masave të mundshme për kontrollin e ndotjes së ajrit
8	9 qershor 2021	Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve
9	9 qershor 2021	Çështjet e mbetura dhe drejtimi në të ardhmen për kontrollin e ndotjes së ajrit
5) Materialet për Konferencën Rajonale		
1	23 qershor 2021	Çështjet e menaxhimit të cilësisë së ajrit në Kosovë dhe Prezantimi i Projektit “Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit”
2	23 qershor 2021	Aktivitetet e përmirësimit të monitorimit të cilësisë së ajrit
3	23 qershor 2021	Plani Kombëtarë për Zvogëlimin e Emisioneve në Kosovë dhe situata aktuale
4	23 qershor 2021	Matjet e emisioneve dhe Masat për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A
5	23 qershor 2021	Përgatitja e Inventarit të Emisioneve për Zonën e Prishtinës
6	23 qershor 2021	Simulimi i gjendjes së cilësisë së ajrit në zonën e Prishtinës
7	23 qershor 2021	Vlerësimi i masave të mundshme për kontrollin e ndotjes së ajrit

	8	23 qershor 2021	Menaxhimi dhe Monitorimi i Cilësisë së Ajrit në Kroaci
	9	23 qershor 2021	Situata aktuale e ndotjes së ajrit në Maqedoninë Veriore

Republika e Kosovës
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe
Infrastrukturës

Republika e Kosovës
Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve
për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit
Raporti i Përfundimit të Projektit
Shtojca -2

Gusht 2021

Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)

SUURI-KEIKAKU CO., LTD.
JFE Techno-Research Corporation

Shtojca-2 Vlerësimi i Kapaciteteve

Projekti ka kryer Vlerësimin e Kapaciteteve nga periudha e parë deri në periudhën e tretë për ta studiuar ndryshimin në kapacitetet e palës kosovare (H/L dhe GP-H/L).

Vlerësimi i kapaciteteve ka për qëllim ofrimin e treguesve për siç vijon. Tregues të verifikueshëm duhet të jenë ata tregues përmes të cilëve mund të vlerësohet kapaciteti i nivelit individual, nivelit organizativ dhe nivelit shoqëror ndërlidhur në mënyrë sistematike për sa i përket qëllimit të përgjithshëm dhe qëllimit të projektit përmes zbatimit të Projektit. Për më tepër, treguesit e verifikueshëm janë ata tregues përmes të cilëve mund të kuptohet zhvillimi i kapaciteteve të palës kosovare nga pikëpamja e formimit të sistemit të vetë-qëndrueshëm dhe konstruktiv të menaxhimit të cilësisë së ajrit.

Vlerësimi i kapaciteteve është kryer përmes formularit të testit të vetë-vlerësimit duke i bërë bashkë të gjithë anëtarët e H/L dhe GP-H/L me 6 shkurt 2018 në periudhën e parë, 31 janar 2019 në periudhën e dytë dhe 25 shkurt 2020 në periudhën e tretë. Testet kishte disa pyetje me përgjigje PO ose JO, dhe pastaj u bë vetëvlerësimi i kapaciteteve aktuale në nivel individual, nivel organizativ dhe institucional/social e secilit aktivitet në Projekt. Rezultati i përsosur për secilën pyetje në test ishte pesë pikë dhe sistemi i rezultateve u vendos ashtu që sa më të larta të jenë kapacitetet edhe rezultati do të ishte më i lartë.

Komentet për këto rezultate të vlerësuara nga pikëpamja e JET-it janë dhënë si bashkëngjitje.

- (1) Rezultati 1: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për ta elaboruar inventarin e emisioneve për IDM-të dhe burimet e tjera.

Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultatin 1 janë paraqitur në Tabelën 1. Pastaj, paraqitet rezultati mesatar për secilin pyetësorë në të cilin janë përgjigjur H/L dhe GP-H/L dhe komentet nga ana e JET-it gjithashtu përshkruhen afër grafikut të pyetësorëve.

Pasi që të kuptuarit e përgjithshëm të H/L për përgatitjen e inventarit të emisioneve përparoi përmes aktiviteteve nga periudha e parë, rezultatet në nivelin Individual dhe nivelin Organizativ janë të larta dhe janë rritur. Në anën tjetër, meqenëse zhvillimi i bashkëpunimit me organizatat relevante përmes aktiviteteve aktuale të mbledhjes së të dhënave nuk ka përparuar sa duhet, vlerësimi në nivelin Social është mjaft i ulët. Në periudhën e tretë, meqenëse kishte shumë aktivitete specifike për ta përgatitur inventarin e emisioneve, siç është mbajtja e TNP për llogaritjen e emisioneve nga secili sektor dhe kryerja e llogaritjes së zvogëlimeve të emisioneve, si pjesë e aktiviteteve mbështetëse për Rezultatin 8, H/L ishin në gjendje t'i vlerësojnë në mënyrë objektive kapacitetet e tyre. Prandaj, rezultatet e vetëvlerësimit në periudhën e tretë nuk u rritën aq shumë. JET mendon se ky është një trend i mirë.

Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.
















	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual	Megjithëse H/L dinin për	H/L thelluan të kuptuarit e tërë aktiviteteve

(A)	<p>inventarin e emisioneve të ndotësve së ajrit, ata nuk kishin njohuri të mjaftueshme për metodën konkrete të llogaritjes dhe nuk kishin përvojë në përgatitjen e tij.</p>	<p>për përgatitjen e inventarit të emisioneve. Për më tepër, pasi që ata kryenin vetë një sërë llogaritjesh të emisioneve në secilin sektor përmes TNP-së, kapaciteti i tyre po zhvillohej. Mirëpo, në mënyrë që H/L t'i kryer aktivitetet të pavarur në të ardhmen, siç është shtimi i ndotësve të synuar të ajrit, përgatitja e inventarit kombëtar të emisioneve dhe përpilimi i planit të përmirësimit të inventarit të emisioneve, është i nevojshëm zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve.</p>
<p>Niveli organizativ (B)</p>	<p>MEA/MMPH nuk kishte përvojë në përgatitjen e inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit.</p>	<p>Shumë nga H/L i takojnë AMMK (MEA/MESP) dhe AMMK po përgatit inventarin e emisioneve si organizatë dhe kapaciteti në nivel organizativ po rritet. Për më tepër, janë bërë të qarta rolet dhe përgjegjësitë përbrenda AMMK. Mirëpo, ka dallime në aftësitë individuale dhe situata aktuale është që ngarkesa në komponentin njerëz është duke u rritur. Për më tepër, kapaciteti i organizatës për ta thelluar bashkëpunimin me organizatat relevante nuk është i mjaftueshëm.</p>
<p>Niveli social (C)</p>	<p>Kishte njohuri në nivel të ulët për inventarin e emisioneve të ndotësve të ajrit.</p>	<p>Pasi që për sa i përket aktivitetit të mbledhjes së të dhënave të inventarit të emisioneve, të dhënat nuk janë siguruar sa duhet nga organizatat relevante, situata nuk është e tillë që inventari i emisioneve të ketë mbizotëruar mjaftueshëm në nivelin social. Mirëpo, në Projekt, H/L ishin në gjendje ta përgatisin inventarin e emisioneve bazuar në të dhënat nga aktivitetet siç janë intervistat e hulumtimit për gjendjen aktuale të konsumit të lëndës djegëse në amvisëri dhe shërbime, numërimi i trafikut, etj., në bashkëpunim me komunat e synuara, Universitetin e Prishtinës, etj. Këto janë të dhënat e siguruar për herë të parë në Kosovë, dhe këto bëhen të dhëna të vlefshme nga pikëpamja administrative. Në të</p>


		<p>ardhmen, është e nevojshme të kryhen aktivitete të tilla si zhvillimi i inventarit kombëtar të emisioneve, përgatitja e inventarit të emisioneve duke zgjeruar ndotësit e synuar të ajrit dhe përdorimi i inventarit të emisioneve duke planifikuar, studiuar dhe vlerësuar Masat e Planit të Veprimt në bazë të Strategjisë së Cilësisë së Ajrit në Kosovë. Pritet që të kuptuarit e përgatitjes së inventarit të emisioneve do të nxitet edhe më tej përmes vetëdijesimit të gjerë publik dhe konsultimeve me më shumë organizata relevante.</p>
<p>Rezultati</p>		<p>Është arritje e madhe që H/L përmes TNP kanë qenë në gjendje të kryejnë një sërë procedurash të llogaritjes për inventarin e emisioneve, siç është mbledhja e të dhënave të shumë viteve, regjistrimi i këtyre të dhënave, llogaritja dhe koordinimi i emisioneve për secilin vit, etj.</p> <p>Është një përparim i madh që pas të kuptuarit e konceptit të inventarit të emisioneve, H/L kuptuan rëndësinë e mbledhjes së dhënave dhe mbledhën vetë të dhënat nga organizata relevante. Për më tepër, në GP-H/L, H/L kanë informuar për situatën ku H/L kanë pasur vështirësi në krijimin e sistemit të sigurimit të të dhënave në bashkëpunim me organizatat relevante. Meqenëse H/L i ka njohur problemet dhe përpiqen t'i zgjidhin ato, dhe është vërejtur qartë se ata në mënyrë të pavarur janë duke u munduar t'i trajtojnë këto çështje.</p> <p>Manuali për përgatitjen e inventarit të emisioneve i përgatitur nga JET-i përfshinë jo vetëm procedurën e llogaritjes së emisioneve por gjithashtu rekomandimin për kornizën institucionale duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë. Këto aktivitete kanë krijuar rrugën drejtuese për punën në të ardhmen në përgatitjen e inventarit të emisioneve.</p>
<p>Çështjet/Propozimet</p>		<p>Sfidat e tanishme janë se nuk është e lehtë të mblidhen të dhënat e kërkuara për inventarët kombëtarë të emisioneve, nuk është e lehtë të përgatiten inventarët e emisioneve për shumë ndotës të synuar të ajrit të kërkuara nga BE-ja dhe nuk është e lehtë për H/L që në mënyrë të pavarur ta bëjnë llogaritjen e shumë burimeve të emisioneve. Prandaj, rolet dhe përgjegjësitë duhet të përcaktohen jo vetëm për AMMK, por edhe për organizatat relevante siç janë organizatat të cilat sigurojnë të dhëna, dhe supozohet se nevojitet që të ndërmerret masa që përgatitja e inventarit të emisioneve të caktohet në mënyrë ligjore si aktivitete të MEA/MMPH. Si</p>

aktivitet me bazë ligjore, supozohet se përgatitja e inventarit të emisioneve caktohet si punë rutinore vjetore dhe caktohet si aktivitet thelbësor gjatë përpilimit të Planit të Veprimit në bazë të Strategjisë së Cilësisë së Ajrit në Kosovë. Këto janë të rekomanduara në Projekt.

Tabela 1 Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve për Rezultatin 1

Niveli individual	Niveli organizativ	Niveli social
1-1 Vlerësimi i të kuptuarit nga H/L për sa i përket zhvillimit të Kornizës Institucionale të IE-së		
		
1-2 Vlerësimi i të kuptuarit nga H/L për sa i përket kornizës së IE-së dhe informacionit ekzistues		
		
1-3 Vlerësimi i të kuptuarit nga H/L për sa i përket planifikimit dhe zbatimit të hulumtimit të IE për IDM		
		
1-4 Vlerësimi i planifikimit dhe zbatimit të hulumtimit të IE për burimet e tjera të palëvizshme		
		
1-5 Vlerësimi i të kuptuarit nga H/L për sa i përket metodave të llogaritjes së emisioneve për burimet e tjera (Automjete, djegie të vogla) dhe procedurën e përgatitjes së IE-së primare		
		

1-6 Vlerësimi i të kuptuarit nga H/L për sa i përket përgatitjes së IE-së bazuar në rezultatet (Aktiviteti 1-1 deri 1-5) e këtyre hulumtimeve të burimeve të emisioneve



	Pikat e Vlerësimit			
1-1	<u>Pala kosovare bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë përcaktimin e seksionit përgjegjës dhe krijojnë koordinimin e duhur me agjencitë relevante.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund t'i identifikojmë dhe përcaktojmë organizatat dhe agjencitë relevante të nevojshme për Inventarin e Emisioneve.	4,1	➔ 4.3	➔ 4.4
B	Unë jam personi përgjegjës për përgatitjen e Inventarit të Emisioneve, ose ne tashmë e kemi caktuar personin përgjegjës për përgatitjen e Inventarit të Emisioneve.	3,7	➔ 3.8	➔ 3.7
C	Ne tanimë kemi përcaktuar seksionin përgjegjës dhe kemi themeluar koordinimin e nevojshëm me agjencitë relevante.	3,4	➔ 3.5	➔ 3.7

Pasi që të kuptuarit e H/L për kornizën institucionale për përgatitjen e inventarit të emisioneve është duke përparuar, rezultatet e nivelit individual (A) vlerësohen lartë prej 4.4 nga 5. Për sa i përket nivelit organizativ (B), supozohet se krijimi i kornizës institucionale vlerësohet se po përparon deri në një masë si MEA/MMPH. Për më tepër, pasi që përmes aktiviteteve të Rezultatit 1 në periudhën e tretë, të kuptuarit e kornizës institucionale përparoi, rezultati i nivelit Social (C) gjithashtu u rrit në mënyrë të qëndrueshme.

Në anën tjetër, konsiderohet se rezultati i (B) dhe (C) nuk vlerësohet i lartë si 3.7 nga 5, për shkak të situatës në vijim: 1) situata në të cilën bashkëpunimi me organizatat relevante për sigurimin e të dhënave nuk është krijuar sa duhet, 2) situata në të cilën është e nevojshme të krijohet korniza institucionale për përgatitjen e inventarit kombëtar të emisioneve në Kosovë duke rritur numrin e ndotësve të synuar të ajrit, 3) situata në të cilën është e nevojshme mbështetja për krijimin e sistemit të raportimit tek BE, etj.

1-2	<u>Duke u bazuar në analizën e informacionit ekzistues, Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA vendos për kornizën e inventarit të burimeve të emisionit në zonën e Prishtinës.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta analizojmë informacionin ekzistues.	3,6	➔ 4.0	➔ 4.0
A	Ne tanimë e kemi shqyrtuar Udhëzuesin për inventarin e emisioneve të EMEP/EEA.	3,6	➔ 4.1	➔ 3.9
B	Ne mund ta krijojmë kornizën për Inventarin e Emisioneve të Ndotësve të Ajrit për Zonën e	3,8	➔ 4.3	➔ 4.4

	Prishtinës.			
C	Ne mund ta përcaktojmë kornizën për Inventarin e Emisioneve të Ndotësve të Ajrit për Zonën e Prishtinës.	3,4	→ 3.6	↗ 4.0

Përmes aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave dhe studimit për krijimin e kornizës institucionale për inventarin e emisioneve, H/L kanë kuptuar plotësisht kornizën për burimet e emisioneve. Duke shikuar në të ardhmen për sa i përket përgatitjes së inventarëve kombëtar të emisioneve, etj., u bë e qartë se cilat pjesë pala kosovare është në gjendje t'i kryejë në mënyrë të pavarur dhe cilat pjesë kanë nevojë për mbështetje nga donatorët, dhe H/L gjithashtu e kuptuan nevojën e mbështetjes për krijimin e sistemit të bashkëpunimit të mëtejshëm me organizatat relevante. Si rezultat, rezultatet në nivelin individual (A) dhe në atë Social (C) ishin rreth 4 nga 5 pikë. Në nivelin Organizativ (B), përmes Projektit të JICA-s H/L kanë qenë në gjendje t'i kryejnë aktivitetet pa probleme si ekip i inventarit të emisioneve, dhe H/L vlerësuan rezultat të lartë prej 4.4 nga 5.

1-3	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA-s përpilon planin dhe kryen një studim për Inventarin e Emisioneve të IDM-ve</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta kuptojmë metodën e vlerësimit të emisioneve nga IDM-të duke përdorur të dhënat e monitorimit nga hulumtimet në terren.	3,6	→ 3.8	↗ 4.0
B	Ne mund ta përpilojmë një draft plan për vlerësimin e emisioneve nga IDM-të.	3,2	↗ 3.9	→ 3.8
C	Ne mund ta kryejmë aktivitetin e vlerësimit të emisioneve nga IDM-të në përputhje me planin.	3,3	↗ 3.9	→ 3.9

Pasi që H/L e kuptuan plotësisht inventarin e emisioneve përmes TNP për emisione në TC të kryera në periudhën e dytë, mendohet se rezultati u bë shumë i lartë në periudhën e dytë. Duke konfirmuar se burimi i të dhënave të aktivitetit është raporti vjetor nga KEK-u dhe burimi i faktorëve të emisionit është rezultat i matjes së gazit të shkarkuar nga Projekti i JICA-s, ka qenë e mundur të kuptohen qartë rolet dhe përgjegjësitë e organizatave relevante në llogaritjen e emisioneve nga IDM-të. Prandaj, mendohet se kjo është arsyeja pse është arritur një rezultat kaq i mirë prej 4 nga 5 pikë. Në anën tjetër, meqenëse TC Kosova B aktualisht është planifikuar të rehabilitohet, në të ardhmen do të ndërtohet TC i ri dhe TC Kosova A planifikohet të mbyllet, është e nevojshme të rishikohen faktorët e ardhshëm të emisioneve për TC-të. Duket se rezultati është rreth 4 pikë sepse është e nevojshme mbështetja në të ardhmen për H/L për përditësimin e inventarëve të emisioneve.

1-4	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA përpilon planin dhe kryen një studim për inventarin e emisioneve të burimeve të tjera të palëvizshme.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta përpilojmë një draft plan për vlerësimin e emisioneve nga burimet e tjera të emisionit.	3,1	↑ 3.9	→ 4.0
B	Ne mund ta përpilojmë një draft plan për vlerësimin e emisioneve nga burimet e tjera të palëvizshme.	3,2	↑ 4.2	↘ 4.0
C	Ne mund ta kryejmë aktivitetin e vlerësimit të emisioneve nga burimet e tjera të palëvizshme në përputhje me planin.	3,1	↗ 3.8	↗ 4.1





Konsiderohet se H/L kanë kuptuar më mirë planifikimin dhe zbatimin e përgatitjes së inventarit të emisioneve të burimeve të tjera të palëvizshme nga përvoja e '1-3', sepse rezultati u rrit ndjeshëm në periudhën e dytë. Në anën tjetër, duke marrë parasysh përgatitjen e inventarëve kombëtar të emisioneve, ka shumë të ngjarë që do të jetë e rëndësishme të llogaritet sasia e emisioneve nga industria e prodhimit, ku në zonën e Prishtinës ekzistojnë disa burime të synuara. H/L mendojnë se ka nevojë për mbështetje shtesë në të ardhmen për burime të tilla të emisioneve, prandaj duket se kjo është arsyeja pse është vlerësuar 4 nga 5 pikë.

1-5	<u>Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA zhvillon metodologjinë për inventarin e emisioneve për burimet e tjera si automjetet dhe fabrikat e vogla me djegie, dhe elaboron inventarin preliminar të emisioneve</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta zhvillojmë metodologjinë për vlerësimin e emisioneve nga burimet e tjera.	3,1	↑ 4.0	→ 4.0
A	Ne mund ta përgatisim dhe/ose përpilojmë Inventarin preliminar të Emisioneve të Ndotësve të Ajrit duke përdorur rezultatet e emisioneve të vlerësuara.	3,5	↗ 4.0	→ 4.0
B	Ne mund ta përpilojmë një draft plan për vlerësimin e emisioneve nga burimet e tjera.	3,3	↗ 3.9	→ 4.0
B	Ne mund ta përgatisim Inventarin preliminar të Emisioneve të Ndotësve të Ajrit duke përdorur rezultatet e emisioneve të vlerësuara.	3,7	↗ 3.9	↗ 4.1
C	Në qeverinë e Kosovës mund ta themelojmë procedurën e përgatitjes së Inventarit preliminar të Emisioneve të Ndotësve të Ajrit.	3,6	↘ 3.4	↗ 3.8

H/L thelluan të kuptuarit e tyre për llogaritjen e emisioneve nga burimet e tjera përmes aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave, intervistave të hulumtimit nga studentët dhe aktiviteteve të kërkimit për mbledhjen e të dhënave nga organizatat relevante. Për më tepër, përmes ligjëratave dhe TNP, të kuptuarit e H/L për procedurat e përgatitjes së inventarit të emisioneve ka përparuar, dhe rezultatet në nivelin individual (A) dhe nivelin organizativ (B) kanë qenë të larta që nga periudha e dytë. Në anën tjetër, konsiderohet se rezultatet e nivelit social (C) janë zvogëluar sepse H/L kanë filluar ta kuptojnë vështirësinë e aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave dhe bashkëpunimi me organizatat e ndërlidhura ende nuk është krijuar në nivel të mjaftueshëm.

Pasi që testi i vetëvlerësimit për vlerësimin e kapaciteteve në periudhën e parë u krye pasi u mbajtën ligjërata të mjaftueshme për përgatitjen e inventarit të emisioneve, H/L plotësisht kuptuan metodologjinë e llogaritjes së emisioneve. Si rezultat, mendohet se rezultati ka qenë i lartë që nga periudha e parë.

1-6	<u>Bazuar në aktivitetet (1-1 deri 1-5) për burimet e emisionit, MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA elaboron inventarin e integruar të emisioneve.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Në të ardhmen mund ta përgatisim në mënyrë të vazhdueshme Inventarin e Emisioneve të Ndotësve të Ajrit duke përdorur procedurën e krijuar të përgatitjes.	3,6	↗ 4.2	→ 4.1

B	Në të ardhmen mund ta përgatisim në mënyrë të vazhdueshme Inventarin e Emisioneve të Ndotësve të Ajrit duke përdorur procedurën e krijuar të përgatitjes.	3,6	 4.2  4.0
C	Në qeverinë e Kosovës tanimë kemi themeluar procedurën e përgatitjes së Inventarit të Emisioneve të Ndotësve të Ajrit.	3,4	 3.6  3.7
<p>Pasi që H/L kanë përmirësuar të kuptuarit e përpilimit të inventarit të emisioneve përmes aktiviteteve nga 1-1 në 1-5, pikët e nivelit individual (A) dhe nivelit organizativ (B) janë në rritje. Në anën tjetër, pasi që përmes këtyre aktiviteteve është bërë e qartë se ata po kanë vështirësi të krijojnë bashkëpunimin për mbledhjen e të dhënave me organizatat relevante, konsiderohet se rezultati i nivelit social (C) është disi më i ulët. Përmes TNP të kryer në periudhën e tretë, H/L ishin në gjendje ta kuptojnë praktikën e përgjithshme të aktiviteteve për përgatitjen e inventarit të emisioneve. Si rezultat, çështjet për të ardhmen në aktivitetet të tyre u bënë më të qarta, dhe gjykohet se rezultati i periudhës së tretë u bë pak më i ulët se ai i periudhës së dytë.</p>			

(2) Rezultati 2: Zhvillohen kapacitetet për matjen e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera.

Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultatin 2 janë paraqitur në Tabelën 2. Pastaj, paraqitet rezultati mesatar për secilin pyetësorë në të cilin janë përgjigjur H/L dhe GP-H/L dhe komentet nga ana e JET-it gjithashtu përshkruhen afër grafikut të pyetësorëve.

Në aspektin e teknologjisë së matjes së gazit të shkarkuar, anëtarët e Grupit për matje kanë përvetësuar plotësisht teknologjinë e matjes. Ata kanë kuptuar jo vetëm parimet e matjes por gjithashtu edhe vështirësitë e matjes, dhe kanë arritur nivelin ku janë të aftë që vetë t'i kryejnë matjet.

Palës kosovare i janë dorëzuar në total dy komplete të pajisjeve të matjes (një komplet nga Aktiviteti Paraprak dhe tjetri nga Projekti), dhe IHMK dhe KEK-u kanë pranuar secila nga një komplet, meqenëse të dyja palët u aftësuan për të kryer matje të gazit të shkarkuar. Mirëpo, edhe IHMK e edhe KEK-u janë në situatë ku kërkohet përforcimi i stafit në mënyrë që ta bëjnë matjen në mënyrë të pavarur. Fillimisht Projekti kishte planifikuar t'ia japë palës kosovare edhe një komplet të pajisjeve për t'i zhvilluar agjencitë private për matje. Mirëpo, meqenëse është e vështirë për qeverinë që ta mbështesë një agjenci private të veçantë dhe nuk ka agjenci private të përshtatshme në Kosovë, kjo është anuluar.

Aktualisht nuk ka agjenci private e cila mund t'i bëjë matjet në mënyrë të duhur. Krijimi i kornizës institucionale ku fabrikat private bëjnë matje dhe i raportojnë rezultatet është larg nga realizimi. Në mënyrë që të zbatohet ligji në mënyrë të duhur janë të dëshirueshme udhëzimet e duhura nga zyrtarët në MEA/MMPH, prandaj është e domosdoshme që të zgjerohet njohuria për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Pasi që IHMK ka përvetësuar teknologjinë e matjes së gazit të shkarkuar, është krijuar mjedisi ku MEA/MMPH mund ta shfrytëzojë plotësisht këtë kapacitet dhe t'i udhëzojë fabrikat private në mënyrë të duhur. Është e rëndësishme që MEA/MMPH ta zhvillojë kapacitetin dhe ta shfrytëzojë teknologjinë e matjes së gazit të shkarkuar.


Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual (A)	Transferimi i teknologjisë ka filluar nga Aktiviteti Paraprak. Në pikën fillestare H/L kanë pasuri njohuri deri në një masë për matjet.	Gjatë periudhës së Projektit H/L kanë përsëritur matjet për IDM përmes TNP dhe gjithashtu kanë kryer matje në burimet e tjera të palëvizshme. Përmes këtyre përvojave H/L kanë fituar aftësi të mjaftueshme.
Niveli organizativ (B)	Një person nga DMMU/DMNI, një nga IHMK-ja dhe një nga KEK-u e kanë mësuar teknologjinë. Mirëpo, ata nuk kanë arritur nivelin ku mund t'i kryejnë vetë matjet.	Një person nga DMMU/DMNI, një nga IHMK-ja dhe dy nga KEK-u e kanë përvetësuar teknologjinë. Manualët për punët janë organizuar dhe janë vënë në dispozicion. Në rast se këta persona bashkëpunojnë mund të kryhet matje e duhur. Edhe IHMK e edhe KEK-u i posedojnë pajisjet e matjes dhe mund të kryejnë matje në mënyrë të pavarur. Mirëpo, në veçanti për matje të pluhurit kërkohen së paku tre persona dhe asnjëra palë nuk mund ta sigurojë numrin e nevojshëm të personave.
Niveli social (C)	As MEA/MMPH e as fabrikat private nuk e kuptojnë plotësisht rëndësinë e matjes së gazit të shkarkuar.	Ligji qartas i obligon fabrikat private që të kryejnë matje dhe t'i raportojnë rezultatet, por në realitet ligji nuk zbatohet në nivel të mjaftueshëm. Anëtarët e DMMU/DMNI, IHMK dhe KEK-ut e kanë kuptuar rëndësinë e matjeve. Mirëpo, përveç anëtarëve të grupit të matjeve, zyrtarët në MEA/MMPH dhe fabrikat private nuk e kuptojnë rëndësinë. Matja e gazit të shkarkuar që është bazë për administrimin mjedisor nuk është përhapur dhe korniza institucionale nuk është në fazë ku mund të krijohet.
Rezultati	MEA/MMPH ka organizuar sistemin ku si qeveri mund të bëjë matje dhe konfirmojë rezultatet, dhe IHMK dhe KEK-u kanë në posedim nga një komplet të pajisjeve të matjes dhe manualët e operimit janë organizuar dhe ofruar, gjë që mund t'i ndihmojë që t'i kryejnë matjet në mënyrë të pavarur. Anëtarët e grupit të matjeve mund të kryejnë një sërë punësh nga përgatitja	

	<p>për matje, matja, pastrimi i pajisjeve, organizimi i të dhënave, deri te përpilimi i raportit, dhe përfundimisht kanë fituar aftësinë për të kryer matje në mënyrë të duhur. Në veçanti anëtarët nga IHMK mund ta udhëheqin aktivitetin e matjes.</p> <p>Mirëpo, në veçanti për pluhur, nevojiten së paku tre persona, por edhe IHMK e edhe KEK-u kanë nga dy anëtarë për matje, dhe të dyja palët duhet ta përforcojnë stafin e vetë.</p> <p>MEA/MMPH ka përvetësuar teknologjinë e matjes përmes IHMK-së, por është çështje tjetër për MEA/MMPH ta shfrytëzojë këtë kapacitet.</p> <p>Projekti nuk ka mundur ta arrijë fazën për t'i promovuar agjencitë private të matjes. Prandaj, korniza për përhapjen e matjes së gazit të shkarkuar nuk është përgatitur, dhe si rezultat nuk është krijuar korniza institucionale.</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Ligji i Kosovës qartas i obligon fabrikat që të kryejnë matje të gazit të shkarkuar dhe t'i raportojnë rezultatet, por në realitet ligji nuk zbatohet në nivel të mjaftueshëm, dhe ky është problem i madh.</p> <p>Shkaku supozohet të jetë se as zyrtarët në MEA/MMPH e as fabrikat private (burimet e tjera të palëvizshme) nuk e kuptojnë rëndësinë e matjes së gazit të shkarkuar dhe matja e gazit të shkarkuar nuk është pranuar në mënyrë të duhur. Rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar janë vegël efektive jo vetëm për t'i menaxhuar emisionet por gjithashtu për ta konfirmuar funksionimin e pajisjeve për trajtimin e gazit të shkarkuar në rast se ka pajisje të tilla të instaluar.</p> <p>Për ta zgjeruar të pranuarit e matjes së gazit të shkarkuar, zyrtarët përgjegjës në MEA/MMPH duhet ta rrisin njohurinë dhe të akumulojnë përvojë për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Kjo kërkon që zyrtarët që ta zgjerojnë njohurinë dhe të akumulojnë përvojë për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Për ta realizuar këtë, mënyra më e përshtatshme është TNP ku personat të cilët trajnohen vetë bëjnë inspektimin e secilës fabrikë dhe kryejnë matjet, pasi që secila fabrikë private zakonisht ka proceset dhe rrjedhën e proceseve të veta, dhe mund të përdorin lloje të ndryshme të lëndës djegëse.</p> <p>Kur përmes këtyre aktiviteteve MEA/MMPH fiton aftësinë për t'i udhëzuar fabrikat private, përhapet zbatimi i matjes së gazit të shkarkuar dhe pritet të krijohet baza për promovimin e agjencive private për matje.</p>

Tabela 2 Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve për Rezultatit 2

Niveli individual	Niveli organizativ	Niveli social
-------------------	--------------------	---------------



Pikat e Vlerësimit				
2-1	<u>MMPH dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s marrin njohuri teorike për matjen në terren të gazit nga oxhaku për IDM përmes seminareve në Kosovë dhe në Japoni.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne e dimë matjen e pluhurit që përfshin matjen e shpejtësisë dhe metodën e llogaritjes së saj, marrjen e mostrës së pluhurit dhe llogaritjen e tij	3,50	↑ 4.50	↓ 3.88

	(marrja e mostrës në mënyrë iso-kinetike) si dhe metodën e llogaritjes për konvertimin e vlerave të matura në vlera me përqendrim të O ₂ referente.			
A	Ne e dimë matjen e SO ₂ dhe NO _x që përfshin kalibrimin duke përdorur gazrat standarde dhe regjistrimin e të dhënave, si dhe metodën e llogaritjes për konvertimin në vlera me përqendrim të O ₂ referente.	3,50	↑ 4.50	→ 4.38
B	Organizata jonë ka mundësi për të mësuar se si të kryhen matjen në terren të gazit nga oxhaku në aspektin teorik dhe i di pajisjet dhe materialet shpenzuese të nevojshme.	3,75	↗ 4.20	→ 4.11
C	Kosova ka PSO ose dokumente teorike efektive dhe ofron mundësi për të mësuar se si të kryhen matjet në terren të gazit nga oxhaku në aspektin teorik.	3,00	↑ 4.00	→ 4.11
<p>Kjo pikë është për ta vlerësuar të kuptuarit e H/L për sa i përket parimit të matjes së gazit të shkarkuar.</p> <p>Në krahasim me rezultatet në pikën fillestare, çdo rezultat është rritur dhe çdo pikë vlerësohet lartë, dhe vlerësohet që H/L kanë kuptuar parimet e matjes së gazit të shkarkuar. Mirëpo, vetëm në nivelin individual, rezultati është zvogëluar në periudhën e tretë në krahasim me periudhën e dytë. Kjo është për shkak se H/L kuptuan ndërlikueshmërinë e llogaritjes e mostrimit iso-kinetik të pluhurit, e cila për H/L ishte e vështirë për t'u kuptuar. Për sa i përket llogaritjes, praktikisht nuk ka asnjë problem, pasi që është siguruar forma në Excel për llogaritje kur H/L bëjnë regjistrimin e të dhënave.</p> <p>Në nivelin organizativ dhe në nivelin shoqëror, H/L të cilët janë DMMU/DMNI, IHMK dhe KEK shënuan rezultate të larta, pasi ata mësuan parimet e matjes dhe përvetësuan teknologjitë, dhe për më tepër, gjithashtu janë përgatitur PSO-të.</p>				
2-2	<u>MMPH-ja dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s kryejnë trajnimin gjatë punës për matjen në terren të gazit nga oxhaku duke i futur në përdorim instrumentet e nevojitura duke i përfshirë gazrat standarde.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta përgatisim dhe kryejmë vetë matjen në terren të gazit nga oxhaku për IDM-të dhe burimet e tjera të palëvizshme.	2,75	↑ 4.00	→ 4.00
B	Organizata jonë di se si ta kryej matjen në terren të gazit nga oxhaku dhe i ka pajisjet dhe materialet shpenzuese të nevojshme për matjen e SO ₂ dhe NO _x .	2,76	↗ 3.30	↑ 4.22
B	Organizata jonë ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve të cilët e kuptojnë se si ta kryejnë matjen në terren të gazit nga oxhaku të Pluhurit, SO ₂ dhe NO _x , dhe ka pajisje dhe materiale shpenzuese për ta kryer matjen.	2,50	↗ 3.20	↗ 3.56
C	Kosova ofron mundësi për të mësuar se si të kryhen matjen në terren të gazit nga oxhaku përmes trajnimit në punë.	2,75	↗ 3.30	↗ 3.78

Kjo pikë është për ta vlerësuar kapacitetin e H/L për ta kryer matjen e gazit të shkarkuar.

Rezultatet kanë vazhduar të rriten nga pika fillestare deri në pikën përfundimtare. Nga periudha e parë deri në periudhën e dytë, rezultati në nivelin individual është rritur për shkak të përmirësimit të teknologjisë së gazit të shkarkuar. Nga periudha e dytë deri në periudhën e tretë, përmes matjes për burimet e tjera të palëvizshme (megjithëse KEK-u nuk mund të merrte pjesë), anëtarët nga DMMU/DMNI dhe IHMK ndërtuan vetëbesimin e tyre, dhe rezultatet në nivelin organizativ gjithashtu u ngritën. Në nivelin social, rezultati gjithashtu është rritur pasi ata vlerësuan se janë përgatitur mundësi të mjaftueshme për ta mësuar matjen.

Aktualisht, kur anëtarët nga DMMU/DMNI, IHMK dhe KEK bashkëpunojnë, matja mund kryhet si duhet, por edhe MEA/MMPH (DMMU/DMNI dhe IHMK) e edhe KEK-u nuk kanë numër të mjaftueshëm të stafit për matje dhe të dyja palët duhet të përforcojnë ekipin e tyre me të paktën edhe një person më shumë.

MEA/MMPH dhe KEK-u përvetësuan teknologjinë si organizatë, por në Kosovë nuk ka agjenci private për matje, dhe kjo është çështje për të ardhmen nga pikëpamja e përhapjes së matjes së gazit të shkarkuar tek sektori privat. Sidomos në nivelin social, ka pak nxitje për matjen e gazit të shkarkuar për sektorin privat. Në situatën aktuale, është shumë e vështirë të mendohet se në Kosovë do të krijohet korniza institucionale.

2-3	<u>MMPH-ja dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s i zhvillojnë ekspertët për matjen në terren të gazit nga oxhaku në Kosovë.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund t'i planifikojmë matjet në terren të gazit nga oxhaku duke përfshirë hetimin paraprak të objekteve të synuara si dhe t'i menaxhojmë ato.	2,88	↑ 4.00	↘ 3.62
A	Ne mund ta menaxhojmë matjen në terren të gazit nga oxhaku dhe mund të gjykojmë nëse matja në terren e gazit nga oxhaku është kryer në mënyrë të duhur.	3,00	↑ 3.90	↘ 3.66
B	Organizata jonë bën përpjekje që matja në terren e gazit nga oxhaku në Kosovë të jetë e suksesshme dhe ka aftësi për t'i dhënë udhëzime personave të tjerë për matjen në terren të gazit nga oxhaku.	2,50	↑ 3.90	↘ 3.66
B	Organizata jonë mund ta gjykojë vlefshmërinë dhe/ose përshtatshmërinë e rezultateve të matjes.	3,00	↑ 3.90	→ 3.88
C	Kosova ka ligj ose rregullore për t'i promovuar matjet dhe ofron mundësi për personat e tjerë që t'i mësojnë ato.	3,00	↗ 3.40	↗ 4.00

Kjo pikë është për ta vlerësuar mundësinë për t'i trajnuar ekspertët në Kosovë për ta kryer matjen e gazit të shkarkuar.

Përmes aktiviteteve të Projektit, anëtarët e ekipit për matje përvetësuan me dëshirë teknologjinë e matjes. Në të njëjtën kohë, përmes matjes për katër burimet e tjera të palëvizshme të kryera në periudhën e dytë dhe të tretë, ata filluan të mësojnë se është e nevojshme të kuptohen proceset, rrjedhat e proceseve, lëndët djegëse të konsumuara, etj. për secilën fabrikë në mënyrë që të bëhet matja e duhur. Pasi që ata kuptuan vështirësitë në matjen e gazit të shkarkuar, rezultati në nivelin

individual u ul pak nga periudha e dytë në periudhën e tretën. Në nivelin organizativ, nga periudha e parë deri në të dytën, rezultatet u rritën shumë, por nga periudha e dytë në periudhën e tretë, rezultatet ngecën për shkak të të kuptuarit e vështirësive të matjes. Mirëpo, meqë ata filluan t'i kuptojnë vështirësitë e matjes kjo do të thotë se teknologjia dhe njohuritë për matjen janë thelluar. Niveli i të kuptuarit u përmirësua në mënyrë të qëndrueshme dhe është vlerësuar lartë. Në nivelin social, ata pranuan se ligjet dhe rregulloret ishin të përgatitura mirë, dhe mësuan se ligjet dhe rregulloret mund të zbatohen për fabrikat private përmes matjes së gazit të shkarkuar. Prandaj, rezultatet u rritën nga periudha e dytë në periudhën e tretë.

Anëtarët e ekipit për matje përvetësuan teknologjinë e matjes dhe madje arritën nivelin ku mund ta mësojnë personelin tjetër. Mirëpo, nga tani e tutje, është e nevojshme të planifikohen matjet për fabrikat private, etj. bazuar në të kuptuarit e proceseve, rrjedhave të proceseve, lëndëve djegëse të konsumuara, etj. Për ta realizuar këtë, është e nevojshme të grumbullohen përvoja përmes kryerjes së matjes për më shumë burime.

2-4	<u>MMPH-ja dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s e krijojnë kornizën institucionale për zbatimin e matjes në terren të gazit nga oxhaku në Kosovë.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)		
A	Ne kemi agjenci/organizatë ose kompani private që mund ta kryejë matjen në terren të gazit nga oxhaku.	3,00	↓	2.40	↗	2.56
B	Organizata jonë ka aftësi të mjaftueshme për t'i aftësuar personat përgjegjës për matjen në terren të gazit nga oxhaku dhe ka sistemin e saj.	3,00	→	2.90	↗	3.44
C	Kosova ka ligje ose rregullore për ta bërë matjen në terren të gazit nga oxhaku të detyrueshme në Kosovë dhe ka buxhet të mjaftueshëm dhe sistem për t'i krijuar ato.	3,00	↗	3.30	↗	3.56
<p>Kjo është pikë për vlerësimin nëse në Kosovë mund të krijohet korniza institucionale apo jo. Rezultatet janë të ulëta në përgjithësi për secilën pikë.</p> <p>Rezultatet nuk kanë ndryshuar gjatë gjithë periudhës së Projektit. Në nivelin social, ata e njohin faktin se matja e gazit të shkarkuar duhet të bëhet, por ata gjithashtu e dinë që nuk është e përhapur në nivelin social. Ligji e rregullon këtë, por zbatimi i ligjit nuk është i mjaftueshëm, dhe fabrikat private nuk kanë nxitje për ta kryer matjen. Në të njëjtën kohë, ata gjyquan se në Kosovë nuk ka agjenci private për matje, dhe se për këtë nuk është siguruar ndonjë buxhet.</p> <p>Kjo situatë supozohet të jetë shkaktuar nga fakti se fabrikat private nuk e pranojnë rëndësinë e matjes, dhe kjo është shkaktuar kryesisht nga fakti se MEA/MMPH nuk i përmbush detyrat e saj për udhëzimin e fabrikave private. Meqenëse anëtarët e ekipit për matje kanë përvetësuar teknologjinë e matjes së gazit të shkarkuar, është e dëshirueshme të shfrytëzohet kjo aftësi dhe të përmbushen detyrat për udhëzime.</p>						
2-5	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s kryejnë matjen në terren të gazit nga oxhaku për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme të emisioneve, dhe e konfirmojnë pajtueshmërinë me VKE-të (Vlerat Kufitare të Emisioneve)</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)		

A	Ne i dimë VKE-të për IDM-të dhe burimet e tjera të palëvizshme.	4,00	↗	4.50	↘	4.13
B	Organizata jonë ka aftësi të mjaftueshme për ta gjykuar vlefshmërinë dhe përshtatshmërinë e rezultateve të matjes.	4,34	↘	4.10	↘	3.76
B	Organizata jonë ka aftësi të mjaftueshme për t'i vlerësuar kundërmaset për objektet e synuara nëse i tejkalojnë VKE-të.	4,00	→	4.10	↘	3.76
C	Kosova e ka sistemin e monitorimit të emisioneve dhe ka aftësi të mjaftueshme për të dhënë udhëzime ose për t'i imponuar kundërmaset për objektet e synuara nëse i tejkalojnë VKE-të.	4,00	↘	3.80	↘	3.50
<p>Kjo pikë është për ta vlerësuar kapacitetin e H/L për ta kryer vetë matjen e gazit të shkarkuar dhe për ta vlerësuar pajtueshmërinë e emisioneve me VKE-të. Gjatë periudhës së Projektit, çdo pikë ka pasur tendencën e zvogëlimit të rezultatit.</p> <p>Në nivelin individual, H/L njohin ekzistencën e VKE-ve, dhe njohuria e tyre për to është e lartë. Mirëpo, përmes aktiviteteve të Projektit, ata mësuan se shumë fabrika nuk janë në pajtueshmëri me VKE-të, dhe nuk zbatojnë masa adekuate për zvogëlimin e emisioneve, dhe për këtë arsye, rezultatet janë bërë të ulëta jo vetëm në nivelin organizativ, por edhe në atë social.</p> <p>Kjo çështje është një çështje e madhe për të ardhmen për përhapjen e matjes së gazit të shkarkuar dhe aplikimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për secilën fabrikë.</p>						

(3) Rezultati 3: Kryhen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit

Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultatin 3 janë paraqitur në Tabelën 3. Pastaj, paraqitet rezultati mesatar për secilin pyetësorë në të cilin janë përgjigjur H/L dhe GP-H/L dhe komentet nga ana e JET-it gjithashtu përshkruhen afër grafikut të pyetësorëve.

Rezultati 3 përfshinë aktivitetet lidhur me monitorimin e cilësisë së ajrit, që do të thotë monitorimin e cilësisë së ajrit nga SMCA-të, matjen e cilësisë së ajrit me pajisje portative në emergjencë dhe publikimin e rezultateve të monitorimit dhe përdorimin e tyre për vetëdijësim për mjedisin.

Në përgjithësi, nivelet janë përmirësuar shumë në nivelin individual, nivelin organizativ dhe nivelin social. Përgjigjet në pyetësorin nga pyetja e parë deri tek e pyetja e dyta janë përmirësuar ndjeshëm në nivelin individual, në nivelin organizativ dhe në nivelin shoqëror, por nga pyetja dy deri në pyetjen tre niveli është ulur, përveç matjes së cilësisë së ajrit të mjedisit me pajisje portative për emergjencë. Gjatë kësaj periudhe është bërë inspektimi i SMCA-ve, trajnimi për kalibrimin e analizatorëve, rehabilitimi i analizatorëve të SMCA-ve, përgatitja e manualit të mirëmbajtjes së SMCA-ve dhe trajnimi përmes manualit, si dhe udhëzimi për vendosjen e SMCA-ve. Në veçanti gjatë periudhës së tretë, MCC/MFK ka zëvendësuar analizatorët e në 7 SMCA jashtë zonës së Prishtinës, ka instaluar pajisjet meteorologjike në të gjitha 12 SMCA-të, ka kryer trajnim dhe ka pasur inspektimin për praninë. Kështu, orari i tyre ka qenë nganjëherë në të njëjtin orar të aktiviteteve të Projektit. Si rezultat pjesëmarrja e H/L u bë mjaft e kufizuar. Për më tepër, donatorët kanë përgatitur TER, për rehabilitimin të 5 SMCA-ve në zonën e Prishtinës nga JICA dhe për zëvendësimin e pajisjeve në 7 SMCA të tjera nga MCC/MFK. Kjo

konsiderohet të jetë arsyeja për vlerësimin e ulët në nivelin organizativ dhe nivelin social veçanërisht nga periudha e dytë në periudhën e tretë, përpos matjes së cilësisë së ajrit të mjedisit me pajisje portative për emergjenca.

Monitorimi i saktë dhe i besueshëm filloi në qershor të vitit 2019 me 5 SMCA në zonën e Prishtinës dhe në nëntor të vitit 2019 me 7 SMCA në zonat e tjera. Në fund të gjitha 12 SMCA-të u rehabilituan me ndihmën e donatorëve. Mirëpo, këtë herë nuk janë detektuar dhe analizuar në nivel të mjaftueshëm vlera të parregullta të të dhënave të matura të analizatorëve. Prandaj, nuk mund të konsiderohet se janë krijuar kapacitetet për ta gjetur dështimin e analizatorëve nga të dhënat.

Për sa i përket ekraneve për shfaqjen e të dhënave, Projekti i ka instaluar ato në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe në një lokacion në qytetin e Obiliqit. Numri i qytetarëve të cilët po tregojnë interes dhe po ndalen para ekraneve është duke u rritur, dhe instalimi i ekraneve është raportuar në gazeta dhe televizion. Është e nevojshme të rritet numri i stafit përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe të sigurohet buxhet i qëndrueshëm për O dhe M.




Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon


	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual (A)	<p>Stafi i IHMK-së përveç menaxhimit të kontraktorit përgjegjës për mirëmbajtje, ka kryer vetëm detyra shumë të thjeshta si zëvendësimin e filtrave për mënjanimin e pluhurit etj.</p> <p>IHKM nuk kishte as pajisjet e as njohuri për matjen e cilësisë së ajrit në mjedis në raste emergjente.</p>	<p>H/L kanë kuptuar parimin e kalibrimit të analizatorëve të NOx, SO₂, CO dhe O₃, dhe janë aftësuar për t'i kalibruar këta analizatorë. Por ende ka nevojë për TNP. Për më tepër, është e nevojshme që të ketë trajnim për t'i dalluar të dhënat normale nga të dhënat e parregullta, dhe për ta zbuluar dështimin e analizatorit.</p> <p>Në anën tjetër, është bërë e mundur që të bëhet matja e ndotjes së ajrit të mjedisit me pajisje portative për emergjenca.</p>
Niveli organizativ (B)	<p>Dymbëdhjetë SMCA-të janë instaluar nga viti 2009 deri në vitin 2012. Para fillimit të Projektit, buxheti i MEA/MMPH për mirëmbajtjen e SMCA-ve ka qenë përafërsisht 60,000 Euro për tetë vite me radhë.</p> <p>Në tetor të vitit 2017, kur filloi Projekti, vetëm 4 SMCA nga 12 SMCA në</p>	<p>Buxheti për O dhe M për vitin 2017 është rritur në rreth 150,000 Euro, dhe është mundësuar që të rikthehet funksioni i analizatorëve në më shumë se gjysmën e SMCA-ve.</p> <p>Për më tepër, është kryer edhe rehabilitimi nga Projekti dhe mund të konsiderohet se mund të sigurohen të dhëna të besueshme të cilësisë së ajrit nga pesë SMCA-të në zonën e Prishtinës. Pas JICA-s, MCC/MFK zëvendësoi analizatorët e 7 SMCA-ve të tjera</p>

	<p>Kosovë ishin në funksion.</p> <p>Për më tepër, kalibrimi i analizatorëve nuk ishte bërë për shumë vite.</p>	<p>në nëntor të vitit 2019, dhe si rezultat u rivendos sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit për të gjitha 12 stacionet në Kosovë.</p> <p>Aktualisht, dy punonjës të IHMK-së duhet t'i mirëmbajnë dhe menaxhojnë të dymbëdhjetë SMCA-të. Dy persona nuk janë të mjaftueshëm për t'i kryer të gjitha punët e O dhe M. Këta dy persona gjithashtu janë përgjegjës për punët laboratorike dhe është e nevojshme që të punësohet së paku edhe një person.</p>
Niveli social (C)	<p>Stafi i IHMK-së përveç menaxhimit të kontraktorit përgjegjës për mirëmbajtje, ka kryer vetëm detyra shumë të thjeshta si zëvendësimin e filtrave për mënjanimin e pluhurit etj.</p> <p>IHMK nuk kishte as pajisjet e as njohuri për matjen e cilësisë së ajrit në mjedis në raste emergjente.</p>	<p>Në anën tjetër, në fund të muajit janar 2018 ndodhi gjendja me ndotje të madhe të ajrit rreth Zonës së Prishtinës për rreth një javë. Kjo u bë çështje e madhe sociale dhe shqetësim i qytetarëve. Kjo u bë një nga arsyet përse është alokuar buxheti për mirëmbajtjen e SMCA-ve. Projekti instaloi ekranet për shfaqjen e të dhënave që tregojnë informacionin në kohë reale të ndotjes së ajrit në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe një lokacion në Obiliq. Në anën tjetër, MCC/MFK integroi rrjetin e të dhënave për cilësinë e ajrit nga të dymbëdhjetë SMCA-të, dhe këto të dhëna u vënë në dispozicion për publikun përmes internetit që pasoi rrjetin e KE-së. Ndikimi në nivelin shoqëror për monitorimin e cilësisë së ajrit tani është në rritje.</p>
Rezultati	<p>Rezultatet janë: Për O dhe M të SMCA-ve janë kryer punët e nevojshme në vijim, 1) Rehabilitimi/Riparimi gjeneral i analizatorëve në 5 SMCA në zonën e Prishtinës, 2) Përgatitja e gazrave standarde dhe kalibruesit të nevojitura për kalibrimin e analizatorëve, 3) H/L kanë mësuar se si t'i kalibrojnë analizatorët, 4) Zëvendësimi i 3 kabinave të cilat ishin të papërshtatshme për mirëmbajtje, 5) TNP për riparimin e analizatorëve, 6) Përgatitja e manualit të mirëmbajtjes, 7) Udhëzimi për vendosjen e duhur të SMCA-ve dhe 8) Ushtrimi dhe PSO për përdorimin e pajisjes portative për emergjenca. Konsiderohet se monitorimi i cilësisë së ajrit më në fund mund të bëhet me një shkallë të caktuar të besueshmërisë dhe mund të përmbushen</p>	


	<p>nevojat për riparime. Për më tepër, Projekti i ka instaluar ekranet për shfaqjen e të dhënave në katër lokacione në qytetin e Prishtinës dhe në një lokacion në qytetin e Obiliqit. Numri i qytetarëve të cilët po tregojnë interes dhe po ndalen para ekraneve është duke u rritur, dhe instalimi i ekraneve është raportuar në gazeta dhe televizion. Për më tepër, si rezultat i rrjetit të komunikimit të të dhënave të KE dhe rrjetit të MCC/MFK që e pasoi atë të KE, publiku i përgjithshëm tani mund ta shohin nivelin e ndotjes së ajrit në kohë reale përmes aplikacionit në smartfon.</p> <p>Në anën tjetër, ka pasur shumë pak mundësi për t'i ekzaminuar me kujdes të dhënat e cilësisë së ajrit, prandaj është e vështirë për H/L që të gjykojnë nëse janë të dhëna normale apo të dhëna të parregullta si dhe ta gjykojnë dështimin e analizatorit. Këto janë çështjet për të ardhmen. Për më tepër, nga tani e tutje çështje kryesore do të jenë mirëmbajtja sistematike dhe menaxhimi i buxhetit, siç është krijimi i ditarit të menaxhimit të pajisjeve dhe mbajtja e regjistrat të kalibrimit për secilën pajisje.</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Nga shkurti deri në prill 2019, është bashkëngjitur një person me përvojë në O dhe M të SMCA-ve, mirëpo në të njëjtën kohë një person tjetër përgjegjës është larguar nga kjo detyrë. Si rezultat numri i personave përgjegjës ka mbetur i njëjtë. Dy H/L përgjegjës për SMCA në IHMK nuk janë të dedikuar vetëm për O dhe M të SMCA-ve, por gjithashtu bëjnë monitorimin e dheut, analiza me JK, marrin pjesë në punëtori të organizuara jashtë vendit, marrin pjesë në takime, etj. Aktualisht, kompanitë e mirëmbajtjes në Kosovë nuk kanë aftësitë për t'i kalibruar në mënyrë të duhur analizatorët e NOx, analizatorët e SO₂, analizatorët e O₃ dhe analizatorët e CO. Është e nevojshme që të bëhet transferimi i teknologjisë. Mirëmbajtja e qëndrueshme do të jetë e vështirë pa punësimin e së paku edhe një personi. Për sa i përket ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit, është e nevojshme që të sigurohet buxheti për operim të vazhdueshëm të qëndrueshëm.</p>

Tabela 3 Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve për Rezultatin 3


Niveli individual	Niveli organizativ	Niveli social																								
3-1 Niveli i H/L për ta kuptuar gjendjen e analizatorëve																										
 <table border="1" data-bbox="167 1720 568 1926"> <caption>Data for 3-1 Individual Level</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Value</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>3.8</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>4.2</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>4.8</td></tr> </tbody> </table>	Period	Value	1st Period	3.8	2nd Period	4.2	3rd Period	4.8	 <table border="1" data-bbox="593 1720 994 1926"> <caption>Data for 3-1 Organizational Level</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Value</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>3.0</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>4.5</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>4.0</td></tr> </tbody> </table>	Period	Value	1st Period	3.0	2nd Period	4.5	3rd Period	4.0	 <table border="1" data-bbox="1019 1720 1420 1926"> <caption>Data for 3-1 Social Level</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Value</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>2.0</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>4.2</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>3.0</td></tr> </tbody> </table>	Period	Value	1st Period	2.0	2nd Period	4.2	3rd Period	3.0
Period	Value																									
1st Period	3.8																									
2nd Period	4.2																									
3rd Period	4.8																									
Period	Value																									
1st Period	3.0																									
2nd Period	4.5																									
3rd Period	4.0																									
Period	Value																									
1st Period	2.0																									
2nd Period	4.2																									
3rd Period	3.0																									
3-2 Vlerësimi për operimin dhe mirëmbajtjen e SMCA-ve nga H/L																										




3-3 Vlerësimi i planit të rehabilitimit dhe kryerja e mirëmbajtjes nga H/L




3-4 Vlerësimi për manualin e operimit dhe mirëmbajtjes (O dhe M) së SMCA-ve nga H/L




3-5 Vlerësimi për kalibrimin e analizatorëve të SMCA-ve nga H/L




3-6 Vlerësimi për shpërndarjen e duhur të SMCA-ve në Kosovë nga H/L



3-7 Vlerësimi i sistemit të rrjetit të komunikimit të të dhënave ndërmjet 5 SMCA-ve në zonën e Prishtinës



3-8 Vlerësimi i matjes së PM₁₀, PM_{2.5}, SO₂, NO₂ me pajisjen portative në raste emergjente



Pikat e Vlerësimit		Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
3-1	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s e bëjnë vlerësimin e stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit (SMCA) në Kosovë dhe bëjnë përmbledhjen e gjendjes së analizatorëve dhe të pajisjeve.</u>			
A	Ne e dimë gjendjen aktuale të analizatorëve të SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM10 dhe PM2.5 në IHMK, Rilindje, Obiliq, Palaj dhe Dardhishtë.	3,75	↗ 4.25	↗ 5.00
A	Ne e dimë gjendjen aktuale të analizatorëve të SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM10 dhe PM2.5 në Drenas, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Han të Elezit, Gjilan dhe Brezovicë.	3,75	↗ 4.25	↗ 5.00
B	Organizata jonë ofron mundësi për të mësuar se si të kontrollohet gjendja/statusi i analizatorëve të SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM10 dhe PM2.5.	3,00	↗ 4.50	↘ 4.00
C	Kosova ofron mundësi për personat që trajnohen që ta bëjnë kontrollin e gjendjes së analizatorëve të SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM10 dhe PM2.5.	2,00	↗ 4.25	↘ 3.00

Është pikë për ta vlerësuar gjendjen (normale, jonormale, çka nuk është në rregull) të analizatorëve të instaluar në SMCA-të.

Në nivelin individual, pas pyetësorit të parë, H/L të cilët morën pjesë në inspektimin e SMCA-ve në të gjithë Kosovën kontribuan në përmirësimin e vlerësimit sepse ata e kuptuan situatën aktuale të SMCA-ve. H/L një herë dhanë vlerësim të lartë sepse kishte përvoja të ndryshme dhe mundësi për të mësuar përmes Projektit. Vlerësohet se vlerësimi është ulur sepse është kryer nga donatorët

dhe jo nga MEA/MMPH dhe Kosova.				
Mirëpo, aktualisht aftësia për t'i gjetur parregullsitë në analizator është e pamjaftueshme.				
Fatkeqësisht, vlerësimi nga këndvështrimi i ekspertit është më i ulët se ai i pyetësorit.				
3-2	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s përgatisin planin e operimit dhe mirëmbajtjes dhe planin e rinovimit për SMCA-të në Kosovë.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne vetë mund ta përgatisim një plan të operimit dhe mirëmbajtjes së SMCA-ve në Kosovë dhe të analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} ?	3,75	↑ 4.75	↓ 4.00
B	Organizata jonë di si ta përgatisë një plan të operimit dhe mirëmbajtjes së SMCA-ve në KOSOVË dhe të analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} .	3,25	↑ 4.25	↘ 4.00
B	Organizata jonë ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve të cilët kanë njohuri për përgatitjen e planit të operimit dhe mirëmbajtjes së SMCA-ve në KOSOVË si dhe planin e ripërtëritjes së tyre.	1,75	↑ 4.00	→ 4.00
C	Kosova ofron mundësi për të mësuar përmes trajnimit se si të bëhet përgatitja e planit të operimit dhe mirëmbajtjes së SMCA-ve në KOSOVË si dhe planin e ripërtëritjes së tyre.	1,5	↑ 3.75	↓ 3.00
<p>Është pikë për ta vlerësuar të kuptuarit e planit të operimit dhe mirëmbajtjes dhe planit të rinovimit të SMCA-ve. Në nivelin individual, vlerësimi u rrit pasi H/L u trajnuan kryesisht për kalibrim, por konsiderohet se vlerësimi u zvogëlua sepse mbështetej tek donatorët si për planifikim ashtu edhe për financim. Në nivelin organizativ dhe në atë social, pasi donatorët (JICA dhe MCC/MFK) vendosën ta kryejnë rehabilitimin dhe rinovimin, u mor vlerësim i lartë, por në nivelin social, pasi që u pa se kontributi i Kosovës ishte i vogël konsiderohet se u mor vlerësim i ulët. Mirëpo, numri i stafit për O dhe M të vazhdueshme me cilësi të lartë nuk është i mjaftueshëm, dhe problemet si organizatë nuk janë zgjidhur.</p>				
3-3	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë rehabilitimin e SMCA-ve në zonën e Prishtinës bazuar në planet (3-2).</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta planifikojmë vetë rehabilitimin e SMCA-ve dhe analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} .	3,25	↑ 4.25	↘ 4.00
B	Organizata jonë ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve të cilët e kuptojnë se si ta kryejnë rehabilitimin e SMCA-ve dhe analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} .	1,75	↑ 3.75	↗ 4.00
B	Organizata jonë ka buxhet të mjaftueshëm për ta kryer rehabilitimin e SMCA-ve dhe analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} në baza periodike, p.sh. çdo 5 vite.	1,50	↑ 2.50	↘ 2.00
C	Kosova ofron mundësi për personat përgjegjës të mësojnë se si ta kryejnë rehabilitimin e SMCA-ve dhe analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} .	2,00	↑ 4.25	↘ 4.00

<p>Është pikë për ta vlerësuar zbatimin e rehabilitimit dhe rinovimit të SMCA-ve. Në nivelin individual, konsiderohet se donatorët (JICA dhe MCC/MFK) kryen rehabilitimin dhe rinovimin, i cili kontribuoi në vlerësimin e lartë. Në nivelin organizativ, buxhetet e pamjaftueshme të MEA/MMPH çojnë në një vlerësim mjaft të ulët. Gjithashtu, në nivelin social, konsiderohet se planet për rehabilitimin dhe rinovimin u vendosën përmes projektit dhe aktiviteteve të MCC/MFK, të cilat kontribuan në vlerësimin e lartë në periudhën e dytë. Mirëpo, nga tani është çështje që MEA/MMPH nuk mund ta përgatisë vetë buxhetin për rehabilitim dhe rinovim dhe konsiderohet se kjo është arsyeja pse vlerësimi në nivelin organizativ për sa i përket buxhetit është relativisht i ulët.</p>				
3-4	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s përgatisin manualët për operimin dhe mirëmbajtjen e SMCA-ve në Zonën e Prishtinës.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne dimë si ta kryejmë operimin dhe mirëmbajtjen e SMCA-ve dhe të analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} në baza rutinore duke u bazuar në manualët e përgatitur.	3	↑ 4.25	↘ 4.00
B	Organizata jonë ka aftësi të mjaftueshme për t'i udhëzuar personat përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e SMCA-ve dhe analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} .	2,25	↑ 3.75	↗ 4.00
C	Kosova ka SOP efektive për operimin dhe mirëmbajtjen e SMCA-ve dhe të analizatorëve të tyre për SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, PM ₁₀ dhe PM _{2.5} .	2,00	↑ 4.00	↓ 3.00
C	Kosova ka buxhet të mjaftueshëm për ta mbajtur operimin dhe mirëmbajtjen e duhur të SMCA-ve dhe analizatorëve të tyre.	1,75	↑ 2.75	↓ 2.00
<p>Është pikë për ta vlerësuar manualin e operimit dhe mirëmbajtjes së SMCA-ve në zonën e Prishtinës. Niveli individual dhe niveli organizativ kanë pothuajse të njëjtin vlerësim si më parë, por vlerësimi në nivelin social u zvogëluar. Në nivelin individual, përvoja të ndryshme dhe mundësi të mësimin u morën përmes Projektit, por konsiderohet se H/L nuk dhanë vlerësim më të lartë për shkak të vonesës në finalizimin dhe dhënien e manualit të mirëmbajtjes.</p> <p>Pyetja e fundit në nivelin social duket se ndikohet nga kontributi i donatorëve që zgjidhën problemet të cilat kishin ndodhur në mirëmbajtje, sepse donatorët realizuan rehabilitimin e 5 stacioneve në zonën e Prishtinës dhe rinovimin e 7 stacioneve të tjera.</p>				
3-5	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë kalibrimin e analizatorëve në SMCA-të në zonën e Prishtinës bazuar në manualët për operim/mirëmbajtje.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne dimë si t'i kalibrojmë vetë analizatorët e SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO.	1,50	↑ 3.50	↑ 5.00
B	Organizata jonë ofron mundësi për personat përgjegjës të mësojnë se si t'i kalibrojnë analizatorët e SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO.	1,75	↑ 3.75	↗ 4.00
B	Organizata jonë e din se çfarë pajisje dhe materiale shpenzuese nevojiten për t'i kalibruar analizatorët e SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO.	3,25	↑ 4.25	↘ 4.00

C	Kosova ofron mundësi për të mësuar përmes trajnimit-në-punë se si të kalibrohen analizatorët e SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO.	2,00	↑ 4.00	→ 4.00
<p>Është pikë për ta vlerësuar kalibrimin e analizatorëve të SO₂, NO_x, O₃ dhe CO bazuar në manualin e mirëmbajtjes. Përvoja para kryerjes së pyetësorit të periudhës së tretë ka çuar në përmirësimin e vlerësimit në nivelin individual dhe organizativ. Përvoja ka qenë që të kalibrohen me siguri analizatorët e SO₂, NO_x, O₃ dhe CO në kohën e rehabilitimit dhe TNP në 5 SMCA në zonën e Prishtinës duke përdorur kalibruesin (SG-741) të dhënë donacion nga JICA. Mirëpo, për të vazhduar nga tani e tutje, është thelbësor që të bëhet përfundimi i burimeve njerëzore.</p>				
3-6	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s përgatisin udhëzuesin për planifikimin e rrjetit të SMCA-ve në Kosovë.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne kemi njohuri bazike për sistemin e rrjetit të SMCA-ve.	3,75	↑ 4.50	↗ 5.00
B	Organizata jonë ofron mundësi për personat përgjegjës të marrin njohuri bazike për sistemin e rrjetit të komunikimit të SMCA-ve.	3,00	↑ 4.50	↘ 4.00
C	Kosova ofron mundësi për personat përgjegjës të marrin njohuri bazike për sistemin e rrjetit të komunikimit të SMCA-ve.	2,75	↑ 4.25	↘ 4.00
<p>Është pikë për ta vlerësuar planin e shpërndarjes së SMCA-ve për të gjithë vendin. Vlerësimi i nivelit individual është përmirësuar, por vlerësimi i nivelit organizativ dhe social është përkeqësuar. Projekti përgatiti draft udhëzimet për planin e vendosjes së SMCA-ve dhe mbajti një punëtori, por H/L nuk mund të merrnin pjesë sepse H/L duhej të merrnin pjesë në rinovimin e 7 SMCA që MCC/MFK po zhvillonte paralelisht. U bënë shpjegime individuale për opinionet e H/L para dhe pas punëtorisë, dhe mendohet se kjo çoi në rënien e vlerësimit në nivelin organizativ dhe shoqëror.</p>				
3-7	<u>MMPH bashkë me Ekspertët e JICA-s e konfirmojnë Rrjetin në mes SMCA-ve në Zonën e Prishtinës.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne kemi përvojë në hartimin e planit dhe krijimin e sistemit të rrjetit të komunikimit ndërmjet SMCA-ve në KOSOVË	2,00	↑ 4.25	↘ 4.00
B	Organizata jonë e din se çfarë lloji i përmbajtjes është i domosdoshëm në TeR për kontraktuesin përgjegjës në krijimin e sistemit të rrjetit të komunikimit ndërmjet SMCA-ve.	3,00	↑ 4.50	↘ 4.00
C	Kosova ofron mundësi për t'i mësuar dhe udhëzuar personat përgjegjës në MMPH mbi atë se çfarë lloji i përmbajtjes është i domosdoshëm në TeR për kontraktuesin përgjegjës në krijimin e sistemit të rrjetit të komunikimit ndërmjet SMCA-ve.	2,00	↑ 4.25	↘ 4.00
<p>Është pika për ta vlerësuar rrjetin e komunikimit të të dhënave nga analizatorët në SMCA në zonën e Prishtinës.</p> <p>Nga periudha e parë deri në të dytën, rezultatet në nivelin individual, nivelin organizativ dhe nivelin social janë rritur. Përfundimisht, MCC/MFK mori përsipër të gjithë këtë punë, dhe ndërtoi</p>				

rrjetin e komunikimit të të dhënave për cilësinë e ajrit për të gjitha SMCA-të në Kosovë, përfshirë ato në Zonën e Prishtinës. Pala japoneze shfrytëzoi këtë rrjet, instaloi ekranet dhe filloi të shfaqë të dhënat e cilësinë e ajrit.

Është e vështirë të thuhet se H/L kanë kontribuar në ndërtimin e këtij rrjeti. MCC/MFK ka përpiluar TER për të, dhe ka bërë punën. Pasi që H/L përfundimisht mund ta zotëronin rrjetin e komunikimit të të dhënave, duhet të jetë arsyeja që rezultatet në periudhën e tretë nuk ndryshuan shumë.

Çështje për të ardhmen është nëse H/L do të mund ta menaxhojnë dhe mirëmbajnë rrjetin e komunikimit të të dhënave dhe ekranet në mënyrë të duhur, dhe të vazhdojnë t'i shfaqin të dhënat në mënyrë të qëndrueshme.

3-8	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s përgatisin PSO-në për matjen e NO₂, SO₂, PM₁₀ dhe PM_{2.5} në mjedis përmes marrësit portativ të mostrës për nevoja emergjente.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne kemi mostrues portativ për matjen e NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ dhe PM _{2.5} në mjedis për emergjenca.	1,75	↑ 3.75	↗ 4.50
A	Ne kemi manuale të shkruara për matjen e NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ dhe PM _{2.5} në mjedis përmes marrësit portativ të mostrës për emergjenca.	1,05	↑ 3.50	↑ 5.00
B	Organizata jonë ka mundësi që të mësojë se si ta bëjë marrjen e mostrës në raste emergjente duke përdorur marrësin portativ të mostrës për NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ , dhe PM _{2.5} bazuar në PSO.	2,00	↑ 3.50	↑ 5.00
C	Kosova ka PSO efektive për kryerjen e marrjes së mostrës në raste emergjente duke përdorur marrësin portativ të mostrës për NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ , dhe PM _{2.5}	1,75	↑ 3.00	↑ 4.00

Është pikë për ta vlerësuar aftësinë e ndërlidhur me PSO-në për matjen e cilësisë së ajrit të mjedisit përmes pajisjes portative për raste emergjente. Vlerësimi është përmirësuar në nivelin individual, nivelin organizativ dhe nivelin social. Konsiderohet se dhënia e PSO-së pak para vlerësimit të periudhës së tretë ka çuar drejt përmirësimit të vlerësimit.

3-9	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s kryejnë matjen e NO₂, SO₂, PM₁₀ dhe PM_{2.5} në mjedis përmes marrësit portativ të mostrës bazuar në PSO (mesatarisht 1 orë), për nevoja emergjente për matje.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne kemi njohuri bazike për matjen e NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ dhe PM _{2.5} në mjedis për nevoja emergjente.	2,75	↗ 3.50	↗ 4.00
A	Ne kemi mostrues portativ për matjen e NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ dhe PM _{2.5} në mjedis për emergjenca.	1,50	↑ 3.50	↗ 4.00
B	Organizata jonë ofron trajnim-në-punë për personat përgjegjës për marrjen e mostrës së ajrit të mjedisit në emergjenca për NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ dhe PM _{2.5} duke përdorur mostruesin portativ.	2,00	↑ 4.00	→ 4.00
C	Kosova ofron mundësi për t'i mësuar dhe udhëzuar personat përgjegjës për ta kryer marrjen e mostrës në raste emergjente për NO ₂ , SO ₂ , PM ₁₀ dhe PM _{2.5} .	2,00	↑ 3.75	↗ 4.00

Është pikë për ta vlerësuar aftësinë e ndërlidhur me matjen e cilësisë së ajrit të mjedisit përmes pajisjes portative për raste emergjente.

Vlerësimi është përmirësuar në nivelin individual, nivelin organizativ dhe nivelin social. Edhe pse ishte një kohë shumë e ngarkuar për H/L për shkak të rinovimit të 7 SMCA-ve nga MCC/MFK, H/L dilnin gjatë kursit të trajnimit nga MCC/MFK dhe merrnin pjesë në trajnimin e tretë në TPP Kosova A. Konsiderohet se H/L bënë vetë të gjitha procedurat, të cilat çuan në rritjen e besimit të tyre dhe vlerësimin e përmirësuar.

3-10	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s shfrytëzojnë rezultatet e SMCA-ve për raportin vjetor për cilësinë e ajrit si dhe për vetëdijësimin e publikut.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne vetë mund ta përgatisim raportin vjetor të cilësisë së ajrit bazuar në rezultatet nga SMCA-të dhe t'i përdorim rezultatet nga SMCA-të për vetëdijësim të publikut.	4,25	↗ 4.75	→ 4.75
B	Organizata jonë din se si ta përgatisë raportin vjetor të cilësisë së ajrit bazuar në rezultatet nga SMCA-të dhe ta përdor atë për vetëdijësim të publikut.	3,75	↗ 4.5	→ 4.5
B	Organizata jonë ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve të cilët përgatisin raportin vjetor të cilësisë së ajrit bazuar në rezultatet nga SMCA-të dhe e përdorin atë për vetëdijësim të publikut.	1,75	↑ 4.25	→ 4.25
C	Kosova përmes trajnimeve ofron mundësi për të mësuar se si të përgatitet raporti vjetor i cilësisë së ajrit.	2	↑ 4.5	→ 4.5

Është pikë për ta vlerësuar shpalosjen e rezultateve të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe shfrytëzimit të tyre për vetëdijësimin e publikut për mjedisin. Vlerësimi është përmirësuar në nivelin individual, nivelin organizativ dhe nivelin social. Megjithëse është thjesht një formalitet, raportet vjetore dhe mujore tashmë janë publikuar në faqen e internetit të MEA/MESP dhe H/L janë përgjegjës, kështu që u vlerësua shumë nga periudha e parë në nivelin individual. Në fund të periudhës së dytë dhe periudhës së tretë, Projekti instaloi ekranet për shfaqjen e informacionit për cilësinë e ajrit në zonën e Prishtinës, kështu që konsiderohet se projekti ka pasur vlerësim të lartë nga pikëpamja e vetëdijësimin mjedisor.

(4) Rezultati 4: Zhvillohen kapacitetet për analizat relevante mjedisore laboratorike për sa i përket matjes së emisioneve dhe monitorimit të cilësisë së ajrit.

Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultat 4 janë paraqitur në Tabelën 4. Pastaj, paraqitet rezultati mesatar për secilin pyetësorë në të cilin janë përgjigjur H/L dhe GP-H/L dhe komentet nga ana e JET-it gjithashtu përshkruhen afër grafikut të pyetësorëve.

Rezultati 4 përbëhet nga përvetësimi i teknologjisë së analizave laboratorike (4-1~4-6) përmes matjes së gazit të shkarkuar sipas Metodës Standarde Referente dhe vlerësimit (4-7~4-10) për analizën e metaleve të rënda në PM në ajër.

Për sa i përket analizës laboratorike, H/L nuk kishte ndonjë njohuri për Metodën Standarde Referente në periudhën e parë dhe për këtë arsye rezultatet ishin të ulëta. Në periudhën e dytë, megjithëse vlerësimi i kapaciteteve u bë para aktiviteteve, por megjithëse H/L menduan se do ta përvetësojnë teknologjinë së shpejti, vlerësimi dukej se kishte më shumë rezultate të larta.

Në gjysmën e dytë të periudhës së dytë, Projekti mbështeti ri-funksionalizimin dhe rregullimin e JK dhe rregullimin e AAS. Për më tepër, Projekti bëri analiza të gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente. Në periudhën e tretë, H/L kërkuan vetë trajnim shtesë, dhe zgjeruan njohurinë në punën jo vetëm me JK por gjithashtu edhe me ICP-MS. Në të njëjtën kohë, ata përvetësuan teknologjinë për kryerjen e duhur të analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente.

Mirëpo, aplikimi i Metodës Standarde Referente është i kufizuar pasi që vetë direktiva e BE-së e kërkon këtë metodë për IDM në Kosovë, dhe JK-në e posedon vetëm IHMK. Në anën tjetër, kjo teknologji e analizës mund të jetë e aplikueshme për analiza të cilësisë së ujit, dhe teknologjia për analiza në IHMK, duke përfshirë ri-funksionalizimin e ICP-MS, është përmirësuar. Duhet të sqarohen nevojat në të ardhmen për analiza dhe është e dëshirueshme që të zgjerohet aplikimi i këtyre teknologjive.

Mirëpo, numri i stafit përgjegjës është problem. Vetëm një person mund t'i kryejë këto analiza dhe nevojitet së paku një person më shumë. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që të sigurohet buxheti. Këto analiza kërkojnë jo vetëm mirëmbajtje të analizatorëve por gjithashtu blerjen e tretjeve standarde dhe shumë materialeve shpenzuese siç janë reagjentë dhe pajisjet ndihmëse.

Në të njëjtën kohë, IHMK si institucion ka për qëllim marrjen e EN17025, por është shumë larg nga krijimi i sistemit dhe mbesin shumë çështje që duhet zgjidhur. Për t'i zgjidhur çështjet IHMK duhet të fillojë t'i ndërmarrë masat bazike siç është përforsimi i stafit, përforsimi i sistemit të menaxhimit të laboratorit për analiza dhe analizatorëve, etj.

Për sa i përket vlerësimit të analizës së metaleve të rënda në PM në ajër, Projekti bëri mostrimin e PM në ajër, i dërgoi ato në Japoni dhe i analizoi në periudhën e parë. Si rezultat, pala kosovare vendosi t'i monitorojë metalet e rënda në PM në ajër. Për më tepër, për shkak se fabrika e cila mund të ishte burim i ndotjes nuk punonte gjatë periudhës së parë, në periudhën e dytë u bë mostrimi shtesë dhe mostrat u analizuan përsëri në Japoni. Si rezultat, pala kosovare vendosi t'i monitorojë metalet e rënda në PM në ajër në Drenas dhe Mitrovicë. Kështu, H/L kanë përvetësuar teknologjinë e mostrimit. Në anën tjetër, analiza e metaleve të rënda kërkon funksionalizimin e ICP-MS që H/L e posedon në IHMK. IHMK nuk e ka operuar asnjëherë ICP-MS prej kohës kur është sjellë në IHMK, prandaj niveli i vlerësimit ka qenë i ulët në periudhën e parë. Si rezultat i rregullimeve vijuese të projektit, në periudhën e dytë dhe të tretë përmes aktiviteteve të Projektit bashkë me një H/L u bë riparimi i ICP-MS, rregullimet për analiza të metaleve të rënda dhe zgjidhja e problemit të dukurisë së shuarjes së plazmës. Kjo është arsyeja pse vlerësimi është ngritur në periudhën e dytë. Është planifikuar që MCC/MFK ta bëjë trajnimin e stafit në IHMK përmes projektit të vetë. Por trajnimi është shtyrë për shkak të COVID-19. Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.

Metoda Standarde Referente dhe analizatorët laboratorikë		
	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual (A)	H/L nuk e kanë kuptuar se çka është Metoda Standarde Referente. JK (njëjtë si ICP-MS) nuk ishte përdorur për gjashtë ose shtatë vite pasi që është sjellë në IHMK rreth vitit 2012.	H/L kanë kaluar nëpër përvojën me Metoda Standarde Referente, i kanë kuptuar parimet dhe kanë përvetësuar teknikat e operimit. Paralelisht, u ri-funksionalizua JK dhe H/L mësuan operimin e tij. Në të njëjtën kohë, gjithashtu u ri-funksionalizua ICP-MS.
Niveli organizativ (B)	H/L nuk kanë mundur ta analizojnë gazin e shkarkuar përmes Metodës Standarde Referente. H/L gjithashtu nuk mund ta përdornin JK (njëjtë si ICP-MS).	H/L kanë mësuar analizën e gazit të shkarkuar përmes Metodës Standarde Referente. Dy persona në IHMK mund ta përdorin JK-në për analiza. Mirëpo, në procesin nga mostrimi deri te analiza, vetëm njëri nga stafi mund ta bëjë mostrimin e gazit dhe vetëm njëri mund ta përdorë JK për analiza. Prandaj, është e vështirë që të kryhen këto analiza në mënyrë të qëndrueshme. Për sa i përket ICP-MS, vetëm stafi i njëjtë i cili mund ta përdorë JK-në mund ta përdorë edhe ICP-MS.
Niveli social (C)	Deri më tani është përdorur vetë AAS dhe shtrirja e aplikimit të tij për analiza është e vogël. Për më tepër, ky rezultat është pothuajse i zënë i tëri me elemente teknike. Prandaj, njohuria në nivelin social është shumë e ulët.	Fillimi i punës së JK-së e bëri të mundur kryerjen e analizës së gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente për IDM e cila kërkohet nga Direktiva e BE-së, e cila është bazë për PKZE-në. JK dhe ICP-MS u ri-funksionalizuan dhe kapaciteti për analiza i IHMK-së është përmirësuar mjaft shumë. Mirëpo, IHMK nuk ka ndonjë plan tjetër të aplikimit përveç për detyrat e kryera në Projekt (JK: analiza e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente, ICP-MS: analiza e metaleve të rënda në PM në ajër). Nuk mund të thuhet se këto analiza shfrytëzohen në nivel të mjaftueshëm. Është e nevojshme që të zgjerohet shtrirja e aplikimit të analizatorëve.

<p>Rezultati</p>	<p>IHMK si laborator ka përvetësuar teknologjitë bazike për analiza dhe këto aktivitete prodhuan rezultate të mira.</p> <p>Projekti bëri ri-funksionalizimin e JK dhe ICP-MS, dhe siguroi një komplet të tretjeve standarde të nevojshme, pajisjet ndihmëse, etj. prandaj analizat mund të vazhdoen për një kohë. Aplikimi i këtyre analizatorëve është i gjerë dhe ata janë të aplikueshëm për analiza të ndryshme.</p> <p>Ishte e nevojshme të bëhen analiza për punët e kryera në Projekt, pasi që Metoda Standarde Referente kërkohet nga direktiva e BE-së për matje të gazit të shkarkuar për IDM dhe gjithashtu nevojitet për monitorim të metaleve të rënda në PM në ajër.</p>
<p>Çështjet/Propozimet</p>	<p>IHMK ka përvetësuar teknikat e operimit me JK dhe ICP-MS. Mirëpo, është vetëm një punonjës i cili mund të bëjë analiza dhe nevojitet së paku edhe një punonjës. Është gjithashtu shumë e rëndësishme që të sigurohet buxheti për mirëmbajtjen e rregullt të analizatorëve, materialet shpenzuese, pajisjet ndihmëse, etj. Analizat për zbatimin e qëndrueshëm të aktiviteteve të Projektit janë sigurisht të nevojshme, por është e vështirë të thuhet se IHMK ka përvetësuar teknologjinë për analiza vetëm me kryerjen e këtyre analizave.</p> <p>IHMK deri më tani ka shpresuar se do të bëhet ri-funksionalizimi analizatorëve të ndryshëm. Mirëpo, vetëm ka shpresuar për ri-funksionalizim, përderisa nuk ka plan tjetër për aplikimin e analizatorëve përveç për detyrat e kryera nga Projekti. Është vështirë të thuhet se IHMK i shfrytëzon analizatorët si duhet. Është e nevojshme që të zgjerohet aplikimi i tyre.</p> <p>Për ta krijuar sistemin e analizave, kërkohen aktivitetet në vijim.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Për ta përdorur teknologjinë e analizave të përvetësuar rishtas, është e nevojshme të zgjerohet aplikimi i analizave dhe ato të vazhdoen. Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme që të forcohet stafi dhe të krijohet sistemi për analiza. 2) Gjendja ekzistuese në laborator tregon se nuk është duke u menaxhuar si duhet, për shembull pajisjet për analiza nuk përgatiten si duhet, laboratori i analizave nuk mbahet pastër sa duhet (rrezik i lartë i kontaminimit), analizatorët, analizat, reagjentët, etj. nuk janë të menaxhuara mirë. <p>Disponueshmëria e analizatorëve është shumë e ulët në gjendjen aktuale dhe nuk ka më përmirësim të teknologjisë së analizave, dhe në të njëjtën kohë analizatorët mund të bëhen jo-operacional për shkak të karakteristikave të analizatorëve të cilat mbahen në gjendje normale përmes përdorimit të vazhdueshëm.</p>
















	Për t'i zgjidhur çështjet IHMK duhet të fillojë nga masat bazike siç është përforcimi i stafit, përforcimi i sistemit të menaxhimit për pastërti të laboratorit për analiza, analizatorë të mirëmbajtur si duhet, etj.
--	--


Monitorimi i metaleve të rënda në PM në ajër		
	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual (A)	Pajisja e mostrimit (mostruesi me vëllim të ulët) është dhënë si donacion nga KE-ja në 2011~2012, mirëpo H/L nuk kishin përvojë kur vetë kanë kryer mostrimin e PM.	Projekti ka vënë në dispozicion mostruesin me vëllim të lartë dhe H/L janë aftësuar për kryerjen e mostrimit të PM (TSP). Mirëpo, analiza e metaleve të rënda në PM është kryer në Japoni. Është konfirmuar se mostruesi me vëllim të ulët i përdorur më parë nuk është duke punuar si duhet. Në nivelin individual H/L ende nuk e ka përvetësuar tërë teknologjinë duke përfshirë analizën e metaleve të rënda. Pritet trajnimi për ICP-MS nga MCC/MFK.
Niveli organizativ (B)	H/L nuk kanë pasur kapacitete për ta kryer vetë mostrimin e PM dhe analizën e metaleve të rënda në PM.	H/L u bënë të aftë për ta kryer mostrimin dhe mostrimi është bërë me mostrues me vëllim të lartë me metodën japoneze. Pala kosovare shpreson ta përdorë mostruesi me vëllim të ulët për mostrimin e PM ₁₀ në përputhje me standardin e BE-së, por pasi që mostruesi me vëllim të ulët nuk është në dispozicion, deri në blerjen e mostruesit me vëllim të ulët pala kosovare do ta përdorë mostruesin me vëllim të lartë. Për sa i përket analizës së metaleve të rënda, përmes aktiviteteve të Projektit, një nga H/L u bë i aftë për ta riparuar ICP-MS, për të bërë rregullime për analizë të metaleve të rënda dhe për t'i trajtuar problemet lidhur me shuarjen e plazmës. IHMK është duke pritur për trajnimin për ICP-MS nga MCC/MFK.
Niveli social (C)	Kosova ka burime të mëdha të metaleve të rënda dhe ka shqetësim të kontaminimit nga metalet e	Shqetësimet janë të mëdha dhe rezultatet e analizës së mesatares ditore kanë treguar praninë e metaleve të rënda në PM në ajër në nivel më të lartë se vlerat udhëzuese në

	rënda nga industrinë.	Japoni (mesatarja vjetore). H/L ka vendosur të vazhdojë me monitorimin e metaleve të rënda. MEA/MMPH ende nuk ka bërë të ditur praninë e metaleve në PM në ajër.
Rezultati	<p>H/L u aftësuan për ta kryer mostrimin e PM, mirëpo ende nuk mund ta bëjnë analizën e metaleve të rënda në ajër. Për më tepër, IHMK ka në posedim mostruesin me vëllim të ulët, që është metoda standarde e BE-së, por është konfirmuar se nuk është duke punuar si duhet. Prandaj, Projekti rekomandon që të përdoret përkohësisht mostruesi i ajrit me vëllim të lartë. Projekti ka funksionalizuar përsëri ICP-MS dhe është planifikuar trajnimi për ICP-MS nga MCC/MFK.</p> <p>Mirëpo, njëjtë siç është cekur më lartë, numri i personave përgjegjës është i pamjaftueshëm dhe në të njëjtën kohë kërkohet më shumë përvojë në analiza. Për më tepër, ekziston edhe problemi i gjendjes së laboratorit i cili nuk është i organizuar si duhet për kryerjen e analizave.</p> <p>Për më tepër, operimi i ICP-MS kërkon mbështetje buxhetore siç është mbështetja për blerjen e vazhdueshme të gazit të argonit dhe blerja e materialeve shpenzuese shtesë nga MEA/MMPH.</p>	
Çështjet/Propozimet	<p>Niveli i metaleve të rënda në PM në ajër duhet të vlerësohet në baza të mesatares vjetore, prandaj është e dëshirueshme që të bëhet mostrimi dhe analiza një herë në muaj. Është e nevojshme që mostrimi dhe analiza të bëhen së paku katër herë në vit dhe të llogaritet mesatarja vjetore. Prandaj, kërkohet së paku edhe një punonjës.</p> <p>Për ta kryer analizën e metaleve të rënda në përputhje me standardin e BE-së, kërkohet mostrimi i PM₁₀ dhe për këtë nevojitet blerja e mostruesit me vëllim të ulët. Mirëpo, metoda e mostrimit me mostruesi me vëllim të ulët është e njëjtë si ajo me mostrues me vëllim të lartë, prandaj nuk ka problem me mostrim.</p> <p>Megjithëse është vonuar për shkak të COVID-19, ICP-MS do të futet në operim pas trajnimit nga MCC/MFK.</p> <p>Pala kosovare ende nuk i ka publikuar rezultatet e analizës për sa i përket metaleve të rënda në ajër. MEA/MMPH planifikon t'i publikojë ato pas diskutimit me komunën e Drenasit dhe Mitrovicës. Është e dëshirueshme që kjo çështje të trajtohet sa më parë që është e mundur.</p>	


Tabela 4 Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve për Rezultatit 4

Niveli individual	Niveli organizativ	Niveli social
4-1 Vlerësimi i njohurive të H/L për mostrimin për matjen e gazit të shkarkuar me Metodën		


Standarde Referente		
		
4-2 Vlerësimi nëse H/L mund ta operojnë JK-në për Metodën Standarde Referente		
		
4-3 Vlerësimi nëse H/L mund ta kryejnë matjen e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente duke përdorur JK-në dhe AAS-në		
		
4-4 Vlerësimi nëse H/L mund ta kuptojnë matjen e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente që të jenë të aftë ta përpilojnë PSO-në		
		
4-5 Vlerësimi i aftësisë së H/L për ta kryer matjen e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente për burimet e tjera të palëvizshme		
		
4-6 Vlerësimi nëse H/L mund ta përpilojnë PSO-në matjen e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente për burimet e tjera të palëvizshme		




4-7 Vlerësimin nëse H/L mund ta kryejnë mostrimin e PM në ajër




4-8 Vlerësimi i mundësisë që H/L të aftësohen për ta kryer analizën e metaleve të rënda në PM në ajër



4-9 Vlerësimi i kapacitetit të H/L për ta vlerësuar rëndësinë e monitorimit të metaleve të rënda në PM në ajër



4-10 Vlerësimi nëse H/L janë aftësuar për ta kryer analizën e metaleve të rënda në PM në ajër



Pikat e Vlerësimit		Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
4-1	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA bën studimin e metodologjive të marrjes së mostrës dhe matjes për IDM.</u>			
A	Ne kemi instrumente për analizën e SO _x , NO _x , dhe Hg përmes metodës së referencës dhe ato janë në pronësinë tonë.	2,78	↗ 3.33	↑ 4.34
A	Ne dimë si t'i marrim mostrat dhe si t'i analizojmë SO _x , NO _x , dhe Hg përmes metodës së referencës dhe e dimë metodën e llogaritjes për konvertimin në vlera me O ₂ referente.	3,33	↗ 3.50	↗ 4.20

B	Organizata jonë ka mundësi të mësojë se si të aplikohet metoda e referencës në aspektin teorik dhe zotëron pajisjet, materialet shpenzuese dhe instrumentet e nevojshme.	2,56	↑	3.50	↑	4.30
C	Kosova ka dokumente teorike efektive dhe ofron mundësi për të mësuar se si të aplikohet metoda e referencës përmes KJ-së.	2,78	↗	3.42	↑	4.30
<p>Është pikë për t'i vlerësuar njohuritë për mostrimin dhe analizën për matjen e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente.</p> <p>Në periudhën e parë, H/L nuk kishte njohuri të mjaftueshme për Metodën Standarde Referente dhe për këtë arsye rezultatet ishin të ulëta. Mirëpo, nga periudha e dytë deri në të tretën, rezultatet u rritën në mënyrë drastike, pasi H/L kryen analizat e gazit të shkarkuar me anë të Metodës standarde referente dhe thelluan të kuptuarit. Në periudhën e tretë, bazuar në kërkesën e H/L u mbajt trajnimi shtesë, dhe H/L kuptuan shumë mirë analizën e gazit të shkarkuar me Metodën standarde referente.</p>						
4-2	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA e vë në dispozicion për analiza Kromatografin e Jonit (këtu e tutje "KJ").</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)		Mesatarja e dytë (31/1/2019)		Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta përdorim KJ-në për t'i analizuar vetë SO _x dhe NO _x .	2,56	↗	3.33	↑	4.30
B	Organizata jonë di se si ta marrë mostrën për metodën e referencës për KJ-në dhe mund ta operojë KJ-në për analizën e SO _x dhe NO _x .	2,44	↑	3.50	↗	4.10
C	Kosova ka dokumente teorike efektive dhe ofron mundësi për të mësuar se si të aplikohet metoda e referencës.	2,56	↑	3.67	↗	3.90
<p>Kjo është pikë për të vlerësuar nëse H/L mund ta operojë JK-në për Metodën Standarde Referente.</p> <p>Në periudhën e parë, JK-ja nuk mund të operohej, por në periudhën e dytë, Projekti ri-funksionalizoi JK-në, dhe bëri analizat. Për më tepër, në periudhën e tretë H/L kryen analizën e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente përmes trajnimeve të kërkuara nga vetë H/L, dhe të kuptuarit u thellua dhe rezultatet u rritën. Në nivelin individual, H/L u bënë të aftë ta përdorin JK-në, dhe në nivelin organizativ dhe social, rezultatet u rritën pasi IHMK përvetësoi teknologjinë e analizës përmes Projektit.</p>						
4-3	<u>MMPH me asistencën e Ekspertëve të JICA Kryen analizën me metodat e referencës për IDM, duke përdorur metodën e Jon Kromatografit për SO₂ dhe NO_x dhe metodën e absorbimit atomik (këtu e tutje "AAS") për Hg.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)		Mesatarja e dytë (31/1/2019)		Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund t'i përgatisim pajisjet dhe materialet shpenzuese të nevojshme për marrjen e mostrës për metodën e referencës dhe mund të operojmë me KJ dhe AAS.	3,00	↗	3.25	↑	4.20
B	Organizata jonë e kupton domethënien e metodave të referencës për IDM-të dhe ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve për t'i aplikuar metodat e referencës.	3,11	↗	3.25	↗	3.90
C	Kosova ka ligje ose rregullore për t'i aplikuar metodat e referencës për IDM-të dhe alokon buxhet	2,33	↑	3.17	↗	3.40

	të mjaftueshëm për t'i kryer ato			
<p>Kjo pikë është për të vlerësuar nëse H/L mund ta kryejnë analizën e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente duke përdorur JK-në dhe analizën e merkurit me AAS.</p> <p>Në periudhën e dytë dhe të tretë H/L me ndihmën e JET-it kryen analizën e gazit të shkarkuar duke përdorur JK-në e ri-funksionalizuar, dhe AAS tashmë të përdorur nga IHMK. Aktivitetet aktuale filluan pas vlerësimit të kapacitetit në periudhën e dytë. Meqenëse përgatitja filloi nga fillimi i periudhës së dytë, rezultati në periudhën e dytë u rrit. Nga gjysma e fundit e periudhës së dytë, H/L kaluan nëpër përvojën e analizës së gazit të shkarkuar, dhe për më tepër, në periudhën e tretë ata vazhduan analizën e gazit të shkarkuar përmes trajnimeve shtesë të kërkuara nga vetë ata. Ata e thelluan të kuptuarit e analizës së gazit të shkarkuar me Metodën standarde referente, dhe për këtë arsye, rezultati në nivelin individual u rrit më tej.</p> <p>Në IHMK, filloi përdorimi i analizatorëve dhe analiza shkoi një hap përpara. Mirëpo, pasi që në nivelin organizativ vetëm një person mund të operojë analizatorët, dhe në nivelin shoqëror ekziston shqetësimi për buxhetin, rezultatet nuk u rritën.</p> <p>Është e domosdoshme të përforcohet numri i stafit dhe të sigurohet buxheti i duhur në mënyrë që të mbahet teknologjia e analizave.</p>				
4-4	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA elaboron PSO-të për marrjen e mostrës dhe analizës së gazit nga oxhaku i IDM-ve.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne dimë se si t'i aplikojmë metodat e referencës për IDM-të.	2,33	↑ 3.33	↗ 4.00
B	Organizata jonë e kupton se si të aplikohen metodat e referencës për IDM-të dhe ka aftësi të mjaftueshme për t'i përpiluar PSO-të.	2,44	↑ 3.25	↑ 4.00
C	Kosova ka ligje ose rregullore për t'i bërë metodat e referencës për IDM-të të detyrueshme në Kosovë dhe ka PSO për to.	3,33	↗ 3.58	→ 3.70
<p>Kjo pikë është për të vlerësuar nëse H/L mund ta kuptojnë matjen e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente që të jenë të aftë ta përpilojnë PSO-në për IDM.</p> <p>Në periudhën e parë, H/L nuk kishte fare njohuri të mjaftueshme për Metodën Standarde Referente dhe rezultatet ishin të ulëta. Në periudhën e dytë meqenëse H/L kanë filluar të fitojnë njohuri, rezultatet janë rritur. Në periudhën e tretë, H/L thelluan të kuptuarit përmes trajnimit shtesë për Metodën standarde referente të kërkuar nga ata vetë, dhe rezultatet u rritën më tej.</p> <p>Për sa i përket PSO-ve, H/L dhe JET bashkëpunuan për t'i përpiluar PSO-të, dhe H/L kuptuan edhe më shumë për Metodën standarde referente.</p>				
4-5	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bën studimin e metodave të mostrimit dhe matjes për burimet e tjera të palëvizshme.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne i dimë VKE-të për burimet e tjera të palëvizshme dhe në cilat raste metodat e referencës duhet të aplikohet për burimet e tjera të palëvizshme.	4,11	→ 4.00	↘ 3.80
B	Organizata jonë ka aftësi të mjaftueshme t'i gjykojë dhe t'i aplikojë metodat e referencës për burimet e	2,67	↑ 3.83	↗ 4.00

	tjera të palëvizshme.			
C	Kosova ka ligje ose rregullore që përcaktojnë se cilave lloje të objekteve duhet t'iu aplikohen metodat e referencës.	3,22	↗ 3.75	→ 3.60
<p>Kjo pikë është për të vlerësuar aftësinë e H/L për ta përpiluar PSO-në për matjen e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente për burimet e tjera të palëvizshme.</p> <p>Metodat nuk kanë asnjë dallim nga ato për IDM, dhe për këtë arsye, rezultatet janë pothuajse të njëjta me ato të pikës 4-3.</p> <p>Prandaj, në rastin kur analiza e gazit të shkarkuar me anë të Metodës standarde referente zbatohet për burimet e tjera të palëvizshme përveç IDM-ve, përforcimi i stafit dhe sigurimi i buxhetit është i domosdoshëm njëjtë si në pikën 4-3.</p>				
4-6	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA-s elaboron PSO-të për metodat e marrjes së mostrës dhe matjes për burime të tjera të palëvizshme.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne dimë se si t'i aplikojmë metodat e referencës për burimet e tjera të palëvizshme.	2,11	↑ 3.50	↗ 4.20
B	Organizata jonë e kupton se si të aplikohen metodat e referencës për burimet e tjera të palëvizshme dhe ka aftësi të mjaftueshme për t'i përpiluar PSO-të.	2,11	↑ 3.42	↗ 3.80
C	Kosova ka ligje ose rregullore për t'i bërë metodat e referencës për burimet e tjera të palëvizshme të detyrueshme në Kosovë dhe ka PSO për to.	2,89	↗ 3.58	↗ 3.90
<p>Kjo pikë është për të vlerësuar nëse H/L mund ta përpilojnë PSO-në për analizën e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente për burimet e tjera të palëvizshme.</p> <p>PSO-të nuk kanë asnjë dallim nga ato për IDM, dhe për këtë arsye secili rezultat është pothuajse i njëjtë me atë të pikës 4-4. Pasi që metoda e zbatimit është e njëjtë Projekti nuk ka përpiluar PSO shtesë.</p>				
4-7	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bën marrjen e mostrës së Materieve Grimca (PM) përmes Marrësve të mostrës së ajrit me vëllim të lartë së paku për 2 pika të marrjes së mostrës.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne kemi përvoja në mostrimin e PM (Grimcave) përmes Mostruesit të ajrit me vëllim të lartë për analizën e metaleve të rënda.	2,56	↑ 3.58	→ 3.60
B	Organizata jonë ofron trajnim-në-punë për personat përgjegjës për sa i përket mostrimit të PM (Grimcave) përmes Mostruesit të ajrit me vëllim të lartë për analizën e metaleve të rënda.	1,78	↑ 3.42	↗ 3.60
C	Kosova mund t'i ofrojë mundësi personave përgjegjëse për të mësuar se si bëhet mostrimi i PM për analizë të metaleve të rënda.	2,22	↑ 3.75	↘ 3.40
<p>Kjo është pikë për të vlerësuar nëse H/L mund ta kryejë mostrimin e PM në ajër.</p> <p>Në kohën e vlerësimit të kapaciteteve në periudhën e parë, H/L vendosën vlerësim të ulët sepse ata nuk kishin njohuri për metodën e mostrimit të PM për analizën e metaleve të rënda. Pasi që</p>				

mostrimi është bërë në periudhën e parë dhe të dytë, vlerësimi u bë i lartë në periudhën e dytë. Projekti ka bërë mostrimin e PM në gjithsej 8 pika në 2 zona në Kosovë. Tani, H/L janë aftësuar për ta bërë mostrimin e PM.

4-8	<u>Ekspertët e JICA-s analizojnë përmbajtjen e metaleve të rënda (Mn, Ni, As, Cd, Pb dhe Zn) në PM në laborator në Japoni.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne në MMPH kemi në dispozicion pajisje për ta analizuar përmbajtjen e metaleve të rënda (Mn, Ni, As, Cd, Pb dhe Zn) në PM.	2,56	↑ 3.67	↗ 4.00
B	Organizata jonë ka aftësi të mjaftueshme për ta analizuar përmbajtjen e metaleve të rënda (Mn, Ni, As, Cd, Pb dhe Zn) në PM.	3,67	↘ 3.42	→ 3.50
C	Kosova ofron mundësi për personat përgjegjës që të mësojnë se si bëhet analiza e përmbajtjes së metaleve të rënda (Mn, Ni, As, Cd, Pb dhe Zn) në PM.	2,78	↗ 3.33	→ 3.40

Kjo është pikë për ta vlerësuar mundësinë që H/L të aftësohet për ta kryer analizën e metaleve të rënda në PM në ajër.

Në Kosovë IHMK e ka në posedim ICP-MS, dhe megjithëse nuk ishte brenda shtrirjes origjinale të punës, Projekti bashkë me H/L kreu riparimet, rregullimet për analizën e metaleve të rënda dhe diagnostikimin e problemeve për shuarjen e plazmës. Prandaj, konsiderohet se vlerësimi në nivelin individual është përmirësuar shumë. Për më tepër, MCC/MFK ka planifikuar të mbajë trajnim për ICP-MS për stafin e IHMK në fillim të vitit 2020, por për shkak të ndikimit të Covid-19, trajnimi nuk është mbajtur as në fund të majit të vitit 2020. Në nivelin organizativ, duket se H/L shqetësohen nëse kanë aftësi të mjaftueshme.

Në veçanti, kur ICP-MS operon përveç JK-së, rritet numri i analizatorëve që operojnë në IHMK, kështu që është thelbësore të sigurohen burimet njerëzore dhe buxheti për O dhe M.

4-9	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA-s vlerëson rëndësinë dhe urgjencën e ndotjes së ajrit me metale të rënda.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne e bëjmë vlerësimin e rëndësisë dhe urgjencës së ndotjes së ajrit nga metalet e rënda si Mn, Ni, As, Cd, Pb dhe Zn.	4,11	↘ 3.83	→ 3.70
B	Organizata jonë ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve për ta vlerësuar nivelin e ndotjes së ajrit nga metalet e rënda si Mn, Ni, As, Cd, Pb dhe Zn.	2,33	↑ 3.42	→ 3.40
C	Kosova ofron mundësi për të mësuar se si të bëhet vlerësimi i nivelit të ndotjes së ajrit nga metalet e rënda si Mn, Ni, As, Cd, Pb dhe Zn.	3,00	↗ 3.42	↗ 3.60

Kjo është pikë për ta vlerësuar kapacitetin e H/L për ta vlerësuar rëndësinë e monitorimit të metaleve të rënda në PM në ajër. Çështjet në lidhje me metalet e rënda u vlerësuan bazuar në analizën e PM të bërë në periudhën e parë. Për më tepër, gjithashtu u vlerësua edhe rezultati i analizës së mostrimit të PM në Drenas, i cili u krye në periudhën e dytë si përgjigje ndaj kërkesës nga MEA/MMPH, dhe kështu vlerësimi është relativisht i lartë. Për më tepër, dy H/L përgjegjës për mostrimin e PM në IHMK nuk janë të dedikuara për mostrimin e PM, por gjithashtu kryejnë O dhe M të SMCA-ve, monitorimin e dheut, analiza me JK, marrin pjesë në punëtoritë të cilat mbahen

jashtë shtetit, marrin pjesë në takime, etj. Është e dëshirueshme të bëhet mostrimi i PM për çdo muaj, por mostrimi duhet të bëhet të paktën katër herë në vit dhe duhet të vlerësohet vlera vjetore, sepse përqendrimi i metaleve të rënda vlerësohet si mesatare vjetore. Është e nevojshme të përforcohet stafi me të paktën një person më shumë.

4-10	<u>Ekspertët e JICA-s kryejnë diagnostikimin operacional të ICP-MS në laboratorin e IHMK-së.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne organizojmë diagnostikimin operacional të ICP-MS në laboratorin e IHMK-së duke shfrytëzuar shërbimet e prodhuesit e që përfshin edhe përgatitjen e TeR për diagnostikim.	2,38	↑ 3.45	→ 3.38
B	Organizata jonë ka pasur aftësi të mjaftueshme për t'i aftësuar (udhëzuar) personat përgjegjës për përgatitjen e TeR për diagnozën e operimit të ICP-MS në laboratorin e IHMK-së duke shfrytëzuar shërbimet e prodhuesit.	2,13	↑ 3.18	→ 3.13
C	Kosova iu ofron mundësi personave përgjegjës që të mësojnë se çfarë përmbajtje është e nevojshme në TeR për sa i përket diagnozës së operimit të ICP-MS në laboratorin e IHMK-së duke shfrytëzuar shërbimet e prodhuesit. Dhe Kosova do të alokojë buxhet të mjaftueshëm për ta bërë rehabilitimin e ICP-MS në të ardhmen.	2,13	↑ 3.18	→ 3.13

Kjo është pikë për të vlerësuar nëse H/L mund ta bëjë ri-funksionalizimin e ICP-MS.

Si rezultat, pothuajse të gjitha punët u kryen nga Projekti, dhe më në fund ICP-MS arriti në gjendjen ku mund të përdoret. Mirëpo, IHMK vetëm shprehin shpresat e tyre dhe mbështeten në aktivitetet e Projektit dhe të MCC/MFK. Tani e tutje, MCC / MFK do të japë trajnime për operimin, dhe ICP-MS do të fillojë funksionimin e saj. Prandaj, çdo rezultat është mbajtur i ulët.

Pas operimit të tij, është e rëndësishme të vazhdohet me analiza, por ekziston vetëm një personel që mund ta operojë ICP-MS përfshirë JK-në dhe AAS, prandaj është shumë e vështirë të vazhdohet me analiza. Është e domosdoshme të përforcohet stafi me të paktën një person më shumë. Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme të sigurohet buxheti për vazhdimin e analizave si për mirëmbajtje të analizatorëve, materialet shpenzuese, etj.

(5) Rezultati 5: Zhvillohen kapacitetet për modelimin e simulimit të cilësisë së ajrit.

Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultat 5 janë paraqitur në Tabelën 5. Pastaj, paraqitet rezultati mesatar për secilin pyetësorë në të cilin janë përgjigjur H/L dhe GP-H/L dhe komentet nga ana e JET-it gjithashtu përshkruhen afër grafikut të pyetësorëve.

Rezultati 5 ka pasur për qëllim zhvillimin e kapacitetit teknik për modelimin e simulimit të ndotjes së ajrit. H/L kanë mësuar qëllimin e modelit të simulimit, si të operojnë me programin dhe si t'i analizojnë kushtet e ndotjes së ajrit duke krijuar harta të shpërndarjes së përqendrimit me përdorimin e GIS. Disa nga H/L ishin në gjendje ta operojnë dhe ekzekutojnë programin vetë nën udhëzimin e JET-it, por ata ende nuk e kanë arritur nivelin ku ata mund ta llogaritin modelin e simulimit të pavarur duke përfshirë gjetjen dhe trajtimin e gabimeve. Për të fituar përvojë të




më tërësishme dhe për t'i ruajtur/përmirësuar aftësitë teknike, është e nevojshme që të përcaktohen detyrat për krijimin dhe shfrytëzimin e modelit të simulimit në përshkrimin e punës së MEA/MMPH, dhe gjithashtu janë të rëndësishme edhe përpjekjet individuale.

Në vijim keni përmbledhjen e situatës aktuale nga këndvështrimi i JET-it.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual (A)	H/L pothuajse nuk kishin njohuri/përvojë me modelin e simulimit, vetëm disa nga H/L dinin për rezultatin e modelit të simulimit të zbatuar nga donatorë të tjerë. Gjithashtu kapaciteti për përdorimin e kompjuterit dhe për llogaritjet në Excel nuk ishte i mjaftueshëm.	Disa nga H/L u bënë të aftë që t'i operojnë programet nën udhëzime të JET-it. Mirëpo, nuk është kuptuar plotësisht kuptimi i secilit manipulim.
Niveli organizativ (B)	Edhe MEA/MMPH e dhe IHMK janë të interesuar për modelin e simulimit. Në pikën filluese, IHMK-ja duhej të ishte organizata primare për kryerjen e këtij aktiviteti	H/L nga MEA/MMPH dhe IHMK kanë marrë pjesë në trajnime, dhe deri më tani të dy organizatat janë bashkëpunuese në këtë aktivitet. Në anën tjetër, për ta ruajtur kapacitetin pas projektit, rekomandohet që përshkrimi i punës së MEA/MMPH t'i përcaktojë detyrat e modelit të simulimit.
Niveli social (C)	Megjithëse qytetarët janë shumë të interesuar për shkaqet e ndotjes së ajrit, modeli i simulimit nuk është i njohur si vegël për ta analizuar këtë.	Nuk ka ndryshime nga pika filluese Modeli i simulimit nuk përdoret për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit, shpalsje të informacioneve për publikun, etj. Pasi që harta e përqendrimit është vegël e dobishme për shpërndarjen e informacionit tek publiku, rekomandohet që modeli i simulimit të shfrytëzohet për përpilimin e Planit të Veprimit të MEA/MMPH për kontrollin e ndotjes së ajrit, dhe për shpalsje të informacionit dhe komunikim me publikun.
Rezultati	H/L kanë mësuar qëllimin e modelit të simulimit, si të operojnë me programin dhe si t'i analizojnë kushtet e ndotjes së ajrit duke krijuar harta të shpërndarjes së përqendrimit me përdorimin e GIS. Përmes një sërë	

	<p>ushtrimesh praktike, disa nga H/L u bën të aftë t'i ekzekutojnë programet duke përdorur manualin e modelimit të simulimit nën udhëzimin e JET-it.</p> <p>Në nivelin organizativ, grupi punues për simulim, i organizuar kryesisht nga anëtarët e IHMK-së dhe në bashkëpunim me stafin e AMMK-së, ka qenë i organizuar dhe i gatshëm ta operojë modelimin e simulimit duke përfshirë mbledhjen e të dhënave dhe manipulimin me GIS. Në anën tjetër, për ta ruajtur dhe mbajtur kapacitetin pas projektit, rekomandohet që përshkrimi i punës së MEA/MMPH t'i përcaktojë detyrat e modelit të simulimit.</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Në këtë projekt është bërë trajnimi vetëm i çështjeve bazike në programin CALPUFF dhe kjo nuk adreson përmbajtjen e aplikuar. Individët përbrenda H/L ndryshojnë për sa i përket arritjes së kompetencës teknike dhe vetëm disa prej H/L kanë aftësinë për ta ekzekutuar modelin e simulimit të pavarur duke përdorur manualin. Ende mbetet si çështje të kuptuarit më të thellë të përmbajtjes së llogaritjeve dhe interpretimi i rezultateve.</p> <p>Në nivelin organizativ, përshkrimi i punës së H/L nuk përfshinë zbatimin e modelit të simulimit si pjesë të detyrave të tyre. Për ta mbajtur sistemin dhe aftësitë për të kryer simulime pas përfundimit të projektit, duhet të specifikohen detyrat në rregulloren e punës së ministrisë për t'i sqaruar rolet dhe përgjegjësitë së secilës organizatë përkatëse.</p> <p>Është e nevojshme që të sqarohen qëllimet dhe situatat në të cilat mund të shfrytëzohet modeli i simulimit dhe të arrihet konsensusi ndërmjet organizatave përkatëse.</p> <p>Kur të zgjidhen çështjet e ndërlidhura me kapacitetin dhe sistemet për modelimin e simulimit, do të jetë e mundur që të përdoret modeli i simulimit për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit dhe shpalosjen e informacionit tek publiku.</p>

Tabela 5 Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve për Rezultatit 5

Niveli individual	Niveli organizativ	Niveli social																								
5-1 Vlerësimi i krijimit të koordinimit të nevojshëm me agjencitë relevante në lidhje me modelin e simulimit																										
 <table border="1"> <caption>Individual Level Data for 5-1</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Score</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>4.0</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>3.8</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>3.5</td></tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	4.0	2nd Period	3.8	3rd Period	3.5	 <table border="1"> <caption>Organizational Level Data for 5-1</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Score</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>3.5</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>3.8</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>4.0</td></tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	3.5	2nd Period	3.8	3rd Period	4.0	 <table border="1"> <caption>Social Level Data for 5-1</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Score</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>4.5</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>4.0</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>4.0</td></tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	4.5	2nd Period	4.0	3rd Period	4.0
Period	Score																									
1st Period	4.0																									
2nd Period	3.8																									
3rd Period	3.5																									
Period	Score																									
1st Period	3.5																									
2nd Period	3.8																									
3rd Period	4.0																									
Period	Score																									
1st Period	4.5																									
2nd Period	4.0																									
3rd Period	4.0																									
5-2 Vlerësimi i mbledhjes së të dhënave të nevojshme për zbatimin e modelit të simulimit																										




Tabela 5 Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve për Rezultatin 5

Pikat e Vlerësimit	
--------------------	--

5-1	<u>MMPH-ja dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s përcaktojnë seksionet përgjegjëse për modelin e simulimit dhe krijojnë koordinimin e duhur me agjencitë relevante.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Është përcaktuar seksioni përgjegjës për modelin e simulimit dhe është themeluar koordinimi i duhur me agjencitë relevante.	4,0	↘ 3.8	↘ 3.4
B	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, organizata jonë ka aftësi për t'i trajtuar, zgjidhur dhe rregulluar konfliktet e interesit.	3,0	↘ 2.8	↑ 3.6
B	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, organizata jonë ka aftësi për të ndërtuar marrëdhënie të bashkëpunimit me palët e tjera relevante.	4,0	↑ 4.5	↑ 4.2
C	Në Republikën e Kosovës ekziston infrastruktura bazike për përgatitjen e inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit.	4,4	↓ 4.0	↓ 4.0
<p>Kjo pikë ka të bëjë me krijimin e kornizës institucionale për modelimin e simulimit midis MEA/MMPH dhe organizatave relevante.</p> <p>Pjesëmarrësit nga MEA/MESP dhe IHMK vazhduan të marrin pjesë në GP të Simulimit të themeluar në periudhën e parë të projektit. Rezultatet për kapacitetet në nivelin organizativ janë rritur. Në anën tjetër, rezultatet në nivelin individual dhe social janë zvogëluar. Kjo mund të vijë nga vështirësia për të marrë të dhëna për motin dhe çështje të tjera nga organizatat e jashtme.</p>				
5-2	<u>MMPH-ja dhe agjencitë relevante bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë mbledhjen e të dhënave ekzistuese siç janë të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit, të dhënat meteorologjike, informacionet gjeografike, etj.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Organizata jonë mund t'i mbledhë të dhënat e nevojshme siç janë të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit, të dhënat meteorologjike, informacionet gjeografike, etj.	4,4	↘ 4.2	↗ 4.4
B	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve, organizata jonë ka aftësi për ta monitoruar progresin, për t'i siguruar informatat prapa-kthyesë dhe për t'i modifikuar aktivitetet në mënyrë fleksibile për ta arritur qëllimin.	3,6	↗ 3.8	↗ 4.0
C	Kosova ka ligj, rregullore ose rregullim institucional efektiv për përgatitjen e inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit.	4,2	↘ 4.0	→ 4.0
<p>Kjo pikë ka të bëjë me mbledhjen e informacionit të nevojshëm për modelimin e simulimit.</p> <p>Rezultatet janë përmirësuar sepse të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit janë marrë nga stafi përgjegjës i IHMK-së në periudhën e tretë, dhe tani ka qasje në të dhënat e nevojshme. Mirëpo, ka ende çështje të tilla si besueshmëria e ulët e të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit.</p>				
5-3	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë analizën dhe validimin e të dhënave meteorologjike për aplikimin e modelit të simulimit të dispersionit.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)

A	Ne mund t'i analizojmë dhe ta vërtetojmë vlefshmërinë e të dhënave meteorologjike për aplikimin e modelit të simulimit të dispersionit.	3,8	↘	3.5	↗	4.0
B	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, organizata jonë është e gatshme të përfitojë aftësi për të ndërmarrë iniciativa dhe për të vepruar në zgjidhjen e sfidave.	3,8	↗	4.2	↘	3.8
C	Në Republikën e Kosovës ekziston sistemi administrativ për ta siguruar dhe zbatuar buxhetin për përgatitjen e inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit.	2,6	→	2.5	↗	3.2
<p>Kjo është pikë për vlerësimin e aftësisë për t'i analizuar dhe vërtetuar të dhënat meteorologjike. Megjithëse kapaciteti në nivelin individual është përmirësuar, të dhënat meteorologjike në dispozicion janë ende të kufizuara, dhe kjo është ndoshta arsyeja e rezultateve të ulëta në nivelin organizativ dhe social.</p>						
5-4	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë analizën dhe validimin e të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)		Mesatarja e dytë (31/1/2019)		Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund t'i analizojmë dhe ta vërtetojmë vlefshmërinë e të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit.	3,4		3,8		4,2
B	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, organizata jonë ka aftësi për t'i përdorur burimet në mënyrë efektive dhe efikase në përputhje me strategjinë si dhe ka aftësi për ta zbatuar aktivitetin dhe për t'i kryer punët.	3,0	→	3.0	↑	4.0
C	Në Republikën e Kosovës ekziston sistemi administrativ për ta siguruar dhe zbatuar buxhetin për përgatitjen e inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit.	2,6	↘	2.3	↑	3.2
<p>Kjo është pikë për vlerësimin e aftësisë për t'i analizuar dhe vërtetuar të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit.</p> <p>Kapaciteti në nivelin individual ka avancuar përmes seminareve për verifikimin e të dhënave të matjes së cilësisë së ajrit në periudhën e dytë dhe të tretë të projektit, si dhe rehabilitimit të pajisjeve të SMCA-ve dhe instalimin e ekraneve publike për shfaqjen e informacioneve për cilësinë e ajrit, Prandaj, rezultatet e vetëvlerësimit janë rritur në të gjitha nivelet. Mirëpo, duhet të theksohet se në praktikë, ka ende sfida në kontrollin e cilësisë së të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit. Do të jetë e nevojshme t'i kushtohet vëmendje nëse monitorimi i cilësisë së ajrit është i mirëmbajtur dhe verifikimi i të dhënave kryhet mjaftueshëm nga tani e tutje.</p>						
5-5	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë elaborimin e modelit të simulimit të dispersionit për vitin e synuar.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)		Mesatarja e dytë (31/1/2019)		Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta elaborojmë modelin e simulimit të dispersionit për vitin e synuar.	2,8	↗	3.0	↗	3.4
B	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, organizata jonë ka aftësi për ta përcaktuar dhe analizuar institucionin, mjedisin e krijimit të politikave dhe sistemin shoqëror në të cilin	2,6	↗	3.2	↑	4.2

	ndodhemi.			
C	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, Kosova e ka funksionin e vendimmarrjes politike të bazuar në demokraci.	2,8	↑ 3.8	↗ 4.2
<p>Kjo pikë ndërlidhet me zbatimin e modelit të simulimit.</p> <p>Ka pasur përmirësim të vazhdueshëm në vlerësim në të gjitha nivelet gjatë gjithë periudhës së dytë dhe të tretë të projektit. Në fakt, H/L po thellojnë të kuptuarit e tyre për modelin e simulimit dhe po mësohen me përdorimin e programit, dhe puna po bëhet më e lehtë. Megjithëse rezultatet e vlerësimit në nivelin organizativ dhe social janë të larta, përdorimi i modelimit të simulimit aktualisht nuk është përfshirë si pjesë e detyrave të MEA/MESP, dhe do të jetë çështje në mënyrë që të mbahen sistemet dhe aftësitë aktuale pas projektit.</p>				
5-6	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s bëjnë analizën e strukturës së ndotjes së ajrit.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta analizojmë strukturën e ndotjes së ajrit.	3,4	4,0	3,8
B	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, organizata jonë ka kapacitetin për gjykim dhe vendimmarrje për ta zhvilluar një strategji që i përmbush nevojat e organizatave relevante.	2,4	↑ 3.8	→ 4.0
C	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, Kosova ka model të sjelljes dhe koncept të vlerave të mbështetura dhe të pranuar në aspektin kulturor.	2,6	→ 2.7	↗ 3.4
C	Në Republikën e Kosovës, qytetarët në përgjithësi kanë detyrime etike dhe sociale që ta përgatisin inventarin e emisioneve të ndotësve të ajrit.	2,8	↗ 3.2	↘ 3.0
<p>Kjo pikë ndërlidhet me analizën e strukturës së ndotjes së ajrit.</p> <p>Në periudhën e dytë H/L kanë trajnuar ta bëjnë hartën e shpërndarjes së përqendrimit bazuar në rezultatet e modelimit të simulimit, dhe kanë diskutuar për vlefshmërinë e rezultateve. Kjo çoi në rritjen e rezultateve në të gjitha nivelet në periudhën e dytë. H/L treguan interes të lartë për analizën e rezultateve, dhe vlerësimet e tyre në nivelin individual janë të larta. Në anën tjetër, vlerësimi në nivelin social është i ulët, pasi shfrytëzimi i këtyre rezultateve nuk është i përhapur në nivelin organizativ dhe social. Llogaritja dhe shfrytëzimi i modelimit të simulimit nuk janë specifikuar në përshkrimin aktual të punës së MEA/MMPH. Është e dëshirueshme që shfrytëzimi i modelit të simulimit të përcaktohet në përshkrimin e vendit të punës dhe të mund të zbatohet rregullisht si pjesë e detyrave të tyre.</p>				
5-7	<u>MMPH-ja bashkë me Ekspertët e JICA-s marrin njohuri teorike të modelit të simulimit dhe e praktikojnë modelimin e simulimit përmes seminareve dhe punëtorive.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne studiojmë dhe praktikojmë në mënyrë rutine modelimin e simulimit përmes seminareve dhe punëtorive.	3	↗ 3.6	↗ 4.2
B	Për sa i përket inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, organizata jonë ka aftësi për të përfituar në	3,6	↗ 4.0	↗ 4.2

	vazhdimësi aftësi dhe njohuri për t'u përballur me sfidat e reja.			
C	Kosova ka ligje ose rregullore për ta bërë përgatitjen e Inventarit të Emisioneve në Kosovë dhe ka buxhet të mjaftueshëm dhe sistem për t'i krijuar ata.	2,4	↘ 2.2	↑ 3.6
<p>Ky seksion ndërlidhet me mësimin teorik dhe praktikën e simulimit. Pjesëmarrësit e GP të simulimit nga MEA/MMPH dhe IHMK janë bërë bashkë vazhdimisht në praktikën e simulimit që nga periudha e parë e projektit, dhe rezultatet e vetëvlerësimit janë rritur vazhdimisht gjatë gjithë periudhës së dytë dhe të tretë të projektit.</p>				

(6) Rezultati 6: Pala kosovare përmirëson vendimmarrjen bazuar në të dhënat teknike për kontrollin e ndotjes së ajrit.

Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultatin 6 janë paraqitur në Tabelën 6. Pastaj, paraqitet rezultati mesatar për secilin pyetësorë në të cilin janë përgjigjur H/L dhe GP-H/L dhe komentet nga ana e JET-it gjithashtu përshkruhen afër grafikut të pyetësorëve.

Rezultati 6 ka pasur për qëllim që H/L t'i kuptojë masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme dhe vetë t'i studiojnë dhe të japin udhëzime për masat. Stafii i KEK-ut ka thelluar njohuritë për studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM përmes procesit të zbatuar në TC Kosova A ku Projekti ka studiuar, propozuar dhe zbatuar masat për zvogëlimin e emisioneve. Për sa i përket pluhurit, janë propozuar masat për zvogëlim dhe ato janë pranuar. Propozimi rezultoi me zbatimin e modifikimit. Mirëpo, për masat për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x nevojitet investim jo i vogël dhe është vështirë që të realizohen ato. Aktualisht, investimet në TC Kosova A janë të kufizuara dhe të vështira për shkak të mbylljes së planifikuar për vitin 2023, pas fillimit të punës së TC Kosova e Re.

Në anën tjetër, për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, realiteti i situatës është bërë i qartë përmes matjes së gazit të shkarkuar dhe studimit të masave për zvogëlimin e emisioneve nga Projekti, ku nuk bëhet plotësisht zbatimi i matjes së gazit të shkarkuar dhe raportimi, ose rezultatet e matjes nuk janë të sakta edhe pse matja kryhet. Kjo supozohet se shkaktohet nga fakti se MEA/MMPH si autoritet kompetent nuk mund t'i shqyrtojë rezultatet e matjes, të gjykojë përshtatshmërinë e rezultateve, etj. Çështje për të ardhmen është rritja e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës në MEA/MMPH ku zyrtarët përgjegjës përmirësojnë njohurinë dhe përvojën për matje dhe masat për zvogëlimin e emisioneve, dhe në të njëjtën kohë inspektojnë rezultatet e matjes duke shfrytëzuar kapacitetin për matje të gazit të shkarkuar të përvetësuar nga IHMK, etj.




Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.


	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual (A)	Personat përgjegjës kishin pak njohuri për masat e zvogëlimit të emisioneve për IDM-të dhe burimet e	Seminaret, etj. për masat për zvogëlimin e emisioneve janë përsëritur shumë herë gjatë periudhës së Projektit. Stafii përgjegjës në KEK kanë përmirësuar njohurinë e tyre dhe

	tjera të palëvizshme.	kanë thelluar të kuptuarit e tyre. Mirëpo, zyrtarët përgjegjës në MEA/MMPH nuk e kuptojnë mirë dhe sapo kanë filluar ta kuptojnë mungesën e njohurisë.
Niveli organizativ (B)	Ligjet lidhur me rregullimin e emisioneve dhe obligimin për raportimin e emisioneve janë të organizuara mirë, mirëpo këto ligje nuk zbatohen në nivel të duhur.	<p>Në TC Kosova A, për shkak të planit që të mbyllet pas fillimit të punës së TC Kosova e Re në të ardhmen është e vështirë të investohet, prandaj njësitë nuk mund t'i përmbushin VKE-të dhe nuk mund të ndërmerret asnjë masë.</p> <p>Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, zyrtarët në MEA/MMPH nuk kanë arritur nivelin për t'i udhëzuar fabrikat private për përmirësime nga pikëpamja teknike, dhe në të njëjtën kohë, operatorët e fabrikave private nuk e kuptojnë rëndësinë e matjes së gazit të shkarkuar, etj. Aktualisht nuk është situatë ku ligji është duke u zbatuar mirë.</p>
Niveli social (C)	<p>Për sa i përket burimeve të palëvizshme, shqetësimi veçanërisht për pluhurin është shumë i madh për shkak të ankesave nga popullata. Por, ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme për SO₂ dhe NO_x.</p> <p>Shqetësimi për PM_{2.5} është shumë i lartë.</p>	<p>MEA/MMPH i mungon kapaciteti për t'i udhëzuar IDM-të dhe burimet e tjera të palëvizshme.</p> <p>Ka shumë ankesa nga qytetarët për IDM, por masat për zvogëlimin e emisioneve do të zbatohen me mbështetjen e BE-së.</p> <p>Në anën tjetër, zyrtarët në MEA/MMPH nuk i udhëzojnë në mënyrë të duhur fabrikat private (burimet e tjera të palëvizshme). Momentalisht në Kosovë industrinë nuk janë aq të zhvilluara, prandaj shqetësimi si nga MEA/MMPH po ashtu edhe nga qytetarët nuk është i madh për burimet e tjera të palëvizshme.</p>
Rezultati	Për sa i përket TC Kosova A, Projekti ka propozuar masat për zvogëlimin e pluhurit me investimet më të vogla të mundshme. Propozimet janë në drejtim të zbatimit dhe një pjesë e modifikimeve është aplikuar. Këto masa janë studiuar në bashkëpunim me UP dhe rezultatet e studimit u aplikuan, dhe kjo u bë një nga rezultatet më të mëdha. Gjithashtu janë propozuar masat	

	<p>për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x, por është vështirë që të aplikohen për shkak të investimit të nevojitur.</p> <p>Në anën tjetër, për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, nga rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar në burimet e tjera të palëvizshme të kryera nga Projekti, u bë e qartë se shumica e fabrikave nuk janë në pajtueshmëri me VKE-të e tyre. Gjithashtu u bë e qartë situata aktuale se as MEA/MMPH si autoritet kompetent e as operatorët e fabrikave private nuk e njohin rëndësinë e matjes dhe nuk i kontrollojnë emisionet. Është gjetur se zyrtarët në MEA/MMPH duhet ta rrisin njohurinë për matje të gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve, gjë që do të çojë drejt përfitimit të kapacitetit për t'i udhëzuar fabrikat private.</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Masat për zvogëlimin e pluhurit për TC Kosova A janë duke u aplikuar tani, por aplikimi i masave për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x është vështirë për t'i zbatuar për shkak të planit për ndërtimin e TC Kosova e Re. Rehabilitimi i TC Kosova B tani është në proces e sipër dhe është e nevojshme që të përcillet progresi. Në anën tjetër, aktualisht plani për ndërtimin e TC Kosova e Re është në pritje, dhe është e nevojshme të pritet për përgjigjen e qeverisë, duke përfshirë rishikimin e PKZE-së.</p> <p>Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, është e nevojshme që MEA/MMPH t'i udhëzojë burimet e tjera të palëvizshme për të kryer matje të gazit të shkarkuar, pra pikë së pari ta kuptojnë gjendjen e emisioneve nga secila fabrikë private dhe t'i udhëzojë ato. Për ta realizuar këtë, është e domosdoshme që zyrtarët në MEA/MMPH të marrin njohuri për matjen e gazit të shkarkuar dhe masat për zvogëlimin e emisioneve. Udhëzimet përmes TNP siç është kur e bëjnë inspektimin e fabrikave dhe kryejnë matje, pasi që secila fabrikë ka proceset e veta, rrjedhën e procesit, lëndën e konsumuar djegëse, etj. duhet të jenë mënyra më e përshtatshme për rritjen e aftësisë.</p>

Tabela 6 Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve për Rezultatin 6

Niveli individual	Niveli organizativ	Niveli social																								
6-1 Vlerësimi i kapacitetit të palës kosovare për të studiuar politika për TC Kosova A																										
 <table border="1"> <caption>Data for 6-1 Individual Capacity</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Score</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>4.5</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>3.5</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>3.8</td></tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	4.5	2nd Period	3.5	3rd Period	3.8	 <table border="1"> <caption>Data for 6-1 Organizational Capacity</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Score</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>2.8</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>4.0</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>3.5</td></tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	2.8	2nd Period	4.0	3rd Period	3.5	 <table border="1"> <caption>Data for 6-1 Social Capacity</caption> <thead> <tr><th>Period</th><th>Score</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td>1st Period</td><td>3.5</td></tr> <tr><td>2nd Period</td><td>4.0</td></tr> <tr><td>3rd Period</td><td>3.8</td></tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	3.5	2nd Period	4.0	3rd Period	3.8
Period	Score																									
1st Period	4.5																									
2nd Period	3.5																									
3rd Period	3.8																									
Period	Score																									
1st Period	2.8																									
2nd Period	4.0																									
3rd Period	3.5																									
Period	Score																									
1st Period	3.5																									
2nd Period	4.0																									
3rd Period	3.8																									
6-2 Vlerësimi i kapacitetit për t'i studiuar vetë masat për zvogëlimin e emisioneve për burimet e																										



Pikat e Vlerësimit		Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
6-1	<u>Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA bën shqyrtimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM që ndërlidhet me PKZE-në (Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve) nga pikëpamja teknike.</u>			
A	Ne mund ta bëjmë shqyrtimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM-të që ndërlidhen me PKZE-në (Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve) nga pikëpamja teknike.	4,4	↓ 3.5	↗ 3.7
B	Organizata jonë ka informacione të mjaftueshme dhe mund të planifikojë dhe zbatojë masa për zvogëlimin e emisioneve për IDM-të.	2,8	↑ 4.0	↓ 3.3
C	Kosova mund të mbledhë informacione të mjaftueshme mbi teknologjitë për zvogëlimin e emisioneve për IDM-të dhe ta koordinojë kornizën me agjencitë relevante për t'i planifikuar dhe zbatuar masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM-të.	3,6	↗ 4.0	↘ 3.7
<p>Kjo është pikë për vlerësimin e kapacitetit për t'i studiuar vetë masat për zvogëlimin e emisioneve për TC Kosova A.</p> <p>Studimi për TC Kosova A është kryer kryesisht nga inxhinierët në KEK. Meqenëse inxhinierët në TC Kosova A me ndihmën e JET-it studiuin masat për zvogëlimin e emisioneve përmes matjes dhe analizës, ata me siguri përmirësuan njohuritë dhe aftësinë e tyre, dhe rezultatet u rritën nga</p>				

<p>periudha e parë në të dytën. Projekti propozoi masat për zvogëlimin e emisioneve të pluhurit dhe masat tani po zbatohen. Masat për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x janë propozuar gjithashtu, por për to duhet investim jo aq i vogël. Mirëpo, investimi për TC Kosova A është i kufizuar në këtë moment për shkak të mbylljes së planifikuar në vitin 2023, dhe më shumë përmirësim nuk pritet.</p>				
6-2	<u>Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bën shqyrtimin dhe vlerësimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme nga pikëpamja teknike.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta bëjmë shqyrtimin e masave për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme nga pikëpamja teknike.	3,2	↑ 4.0	↗ 4.3
B	Organizata jonë ka informacione të mjaftueshme dhe mund të planifikojë dhe zbatojë masa për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme.	3,4	↗ 4.0	↘ 3.3
C	Kosova mund të mbledhë informacione të mjaftueshme mbi teknologjitë për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme dhe ta koordinojë kornizën me agjencitë relevante për t'i planifikuar dhe zbatuar masat për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme.	3,4	↗ 4.0	↘ 3.7
<p>Kjo është pikë për vlerësimin e kapacitetit për t'i studiuar vetë masat për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme.</p> <p>Projekti filloi studimin e masave të zvogëlimit të emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme nga gjysma e fundit e periudhës së dytë, dhe masat e zvogëlimit të emisioneve u studiuan paralelisht. Vlerësimi i kapaciteteve në periudhën e dytë u krye para aktiviteteve, dhe për këtë arsye H/L supozohet se mendonin se ishte e lehtë për t'i studiuar masat e zvogëlimit të emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme me ndihmën e JET-it. Mirëpo, pas studimit të masave për zvogëlimin e emisioneve, H/L kuptuan se ata nuk kishin njohuri dhe përvojë, dhe në nivelin organizativ dhe në nivelin social rezultatet u ulën. Mirëpo, në nivelin individual rezultati u ngrit, dhe supozohet se H/L fituan njohuritë për masat e studiuar nga Projekti.</p> <p>Në çfarëdo rasti, mungesa e njohurive të zyrtarëve në MEA/MMPH nuk mund të mohohet, dhe është e nevojshme që ata t'i thellojnë njohuritë.</p>				
6-3	<u>Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s i diskuton përmirësimet e politikave relevante bazuar në aktivitetet 6-1 dhe 6-2.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund t'i diskutojmë përmirësimet e politikave relevante dhe të hartojnë politika lidhur me aktivitetet 6-1 dhe 6-2.	3,8	↗ 4.0	→ 4.0
B	Organizata jonë mund të hartojë politika relevante dhe ta diskutojë përmirësimin e politikave lidhur me aktivitetet 6-1 dhe 6-2.	3,8	↘ 3.5	↗ 4.0
C	Kosova ka kornizë për t'i aplikuar politikat dhe aftësi të mjaftueshme për ta menaxhuar aplikimin e politikave.	3,0	→ 3.0	↗ 3.7
<p>Kjo është pikë për ta vlerësuar kapacitetin e palës kosovare për të studiuar politika për burimet e tjera të palëvizshme. Gjatë periudhës së Projektit, rezultati në nivelin social u rrit, por rezultatet e</p>				

tjera ishin të pandryshuara.

Për sa i përket studimit për masat e zvogëlimit të emisioneve për TC Kosova A, Projekti propozoi masat e zvogëlimit të pluhurit dhe ato tani janë duke u zbatuar. Mirëpo, për masat për zvogëlimin e SO₂ dhe NO_x nevojitet investim jo i vogël dhe është vështirë që të realizohen ato. Njësoj si vlerësimi në 6-1, rezultatet nuk u rritën për shkak të investimit të kufizuar dhe mbylljes së planifikuar në vitin 2023.

Për sa i përket aktiviteteve në burimet e tjera të palëvizshme, situata u bë e qarta se ka raste të cilat nuk janë në përputhje me VKE-të e parashikuara me ligj dhe rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar nuk raportohen ose nuk janë të sakta edhe pse ato raportohen.

Siç u përmend më lart, çështja më e madhe është se është konstatuar se ligjet nuk zbatohen siç duhet.

6-4	<u>Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bën shpërndarjen e njohurive relevante dhe informacioneve për kontrollin e ndotjes së ajrit të gjeneruara nga Projekti tek publiku përmes buletineve informuese, faqeve të internetit, etj.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne kemi masa për shpërndarjen e njohurive dhe informacionit përkatës për kontrollin e ndotjes së ajrit dhe kemi masa për ta vënë informacionin në dispozicion të publikut.	4	↓ 3.5	→ 3.5
B	Organizata jonë mund të marrë si dhe ka njohuri dhe informacione për kontrollin e ndotjes së ajrit, dhe ka masa për ta vënë informacionin në dispozicion të publikut si buletini, faqja e internetit.	3,8	↓ 3.5	→ 3.5
C	Kosova ka buxhet dhe sistem për shpërndarjen e njohurive dhe informacionit relevant për kontrollin e ndotjes së ajrit dhe mund ta shpërndajë njohurinë dhe informacionin relevant të gjeneruar nga Projekti.	2,8	↑ 3.5	↓ 3.0

Kjo është pikë për të vlerësuar kapacitetin e palës kosovare për të propozuar masa për zvogëlimin e emisioneve dhe për t'i shpalosur masat për publikun nëpërmjet aktiviteteve të Projektit.

Përmes aktiviteteve të Projektit H/L ka marrë njohuri dhe informacione për kontrollin e ndotjes së ajrit deri në një masë, por disa informacione të rëndësishme nuk duhet të shpaloseshin për shkak të arsyeve në vijim.

Për sa i përket çështjeve të ndotjes së ajrit në Zonën e Prishtinës, ekzistojnë çështjet në vijim. Rezultatet e simulimit është e vështirë të publikohen për shkak të vështirësisë për t'i vërtetuar ato për shkak të mungesës së besueshmërisë së të dhënave të cilësisë së ajrit nga e kaluara. Shkaku i vlerësuar për ndotje të ajrit mund të ketë kundërshtime nga qytetarët nëse publikohet ashtu si është. Për sa i përket emisioneve nga IDM dhe burimet e tjera të palëvizshme, shpalosja e të dhënave është e vështirë pasi që një pjesë e komponentëve tejkalojnë VKE-të. Për këto arsye JET-i ia la shpalosjen e informacioneve të përmendura më lartë krejtësisht MEA/MMPH dhe Projekti nuk ofroi informacione përmes buletinit informues.

Projekti tashmë ka publikuar katër buletine informuese. Mirëpo, aktivitetet e Projektit u

përqendruan kryesisht në krijimin e bazës së të dhënave për studimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit. Buletinet informuese u përqendruan në prezantimin e këtyre aktiviteteve.

Në anën tjetër, aktivitetet e Projektit shpesh u mbuluan nga media. Mediat intervistuan aktivitetin e mbledhjes së të dhënave për inventarin e emisioneve, aktivitetin e mostrimit të PM në Mitrovicë, fillimin e punës së ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit, etj. Pas shfaqjes së të dhënave përmes ekraneve për shfaqjen e të dhënave të cilësisë së ajrit, shqetësimi për cilësinë e ajrit është rritur dhe kontributi është i madh si rol i shpalosjes së informacionit.

(7) Rezultati 7: Zhvillohen masat e kontrollit të emisioneve në IDM.

Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultatin 7 janë paraqitur në Tabelën 7. Pastaj, paraqitet rezultati mesatar për secilin pyetësorë në të cilin janë përgjigjur H/L dhe GP-H/L dhe komentet nga ana e JET-it gjithashtu përshkruhen afër grafikut të pyetësorëve.

Në Rezultatin 7, pasi që përbërja e gazit të shkarkuar shpesh ndryshon për shkak të përbërjes së linjitet që është lëndë djegëse e përdorur nga IDM-të, synohet që të qartësohet sjellja e gazit të shkarkuar dhe të kuptohet teoria bazë për masat për burimet e emisioneve, në mënyrë që IDM-të të mund të zhvillojnë masa të cilat mund të arrihen me metodën e operimit të kaldajës dhe me investimet e vogla vetanake

Për sa i përket masave për zvogëlimin e Pluhurit, Pluhuri pritet se mund të jetë në pajtueshmëri me VKE-të nëse zbatohen masat për përmirësimin e performancës së FES-it bazuar në rezultatet e testeve të ndryshme të kryera në këtë Projekt.

Pika të cilat duhet zbatuar në anën e FES-it tashmë janë në proces e sipër përmes modifikimit aktual, por masat për zvogëlimin e sasisë së gazit të shkarkuar të cilat duhet të zbatohen nga ana e kaldajës (si zvogëlimi i sasisë së ajrit që rrjedhë në para-nxehësin e ajrit) nuk janë zbatuar për shkak se nevojitet investim. Në anën tjetër, aktualisht plani për ndërtimin e TC Kosova e Re është në pritje, dhe është e nevojshme të pritet për përgjigjen e qeverisë, duke përfshirë rishikimin e PKZE-së.

Për sa i përket masave për zvogëlimin e SO₂ dhe zvogëlimin e NO_x, është e vështirë që vetëm përmes përmirësimit të metodës së operimit të kaldajës të arrihet në nivel të pajtueshmërisë me VKE-të. Masat janë propozuar bazuar në rezultatet e testeve, por ato është vështirë të zbatohen sepse kërkojnë investime. Arsyeja është se investimet në TC Kosova A janë të kufizuara meqenëse planifikohet që të mbyllet në vitin 2023.

Përmes procesit të ekzaminimit, propozimeve për përmirësim dhe zbatimit të masave për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A, H/L kuptuan gjendjen aktuale të përbërjes së gazit të shkarkuar në IDM dhe mënyrën se si të vazhdohet me masat për kontrollin e emisioneve.

Për sa i përket zvogëlimit të emisioneve për IDM, përveç njohurisë për matjen e gazit të shkarkuar, kërkohet njohuri e gjerë për kaldajën dhe pajisjet ndihmëse. Megjithëse numri i H/L të cilët mund ta kuptojnë të tërën është i kufizuar, konsiderohet se personi kyç ka arritur nivelin në të cilin masat për zvogëlimin e emisioneve të zbatuara në këtë projekt mund të ekzekutohen edhe nëse JET-i nuk është prezent.

Në periudhën e tretë JET- ka dhënë mbështetje nga Japonia në mënyrë që H/L të mund të vazhdojnë aktivitetet e tyre. Si rezultat, rezultati i përgjithshëm i vlerësimit është më i lartë në krahasim me rezultatin e periudhës së dytë, dhe mendohet se kjo është për shkak të entuziazmit të H/L për parandalimin e ndotjes së ajrit

Komentet nga ana e JET-it për këto rezultate të vlerësuara janë siç vijon.

	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual (A)	Personi përgjegjës ka pak njohuri teknike për zvogëlimin e emisioneve të IDM.	Edukimi përmes seminareve, etj. është përsëritur. Personeli në TC Kosova A kishte njohuri më të mirë. Mirëpo, personat përgjegjës në MEA/MMPH nuk e kanë thelluar të kuptuarit e tyre dhe janë në fazën kur e pranojnë mungesën e njohurisë. Masat për zvogëlimin e emisioneve përmes operimit të kaldajës janë masa bazike të cilat nuk kërkojnë investim, por vetëm disa prej H/L kanë njohuri për operimin e kaldajës, dhe personeli përveç atyre të TC Kosova A janë më pak të interesuar.
Niveli organizativ (B)	Megjithëse ka ligje dhe rregullore të ndërlidhura me rregullimin e emisioneve, janë disa aspekte të cilat aktualisht nuk mund të zbatohen.	MEA/MMPH nuk është në nivel ku mund të ofrojë udhëzime për fabrikat, etj. nga pikëpamja teknike, ndërsa në anën tjetër, KEK-u është duke e zgjeruar njohurinë e vetë teknike. TC Kosova A nuk ka mundësi të jetë në pajtueshmëri me VKE-të për shkak të kufizimeve në investime, planin për mbyllje në të ardhmen, etj.
Niveli social (C)	Për sa i përket IDM-ve ka interes të madh për Pluhurin, sepse është i dukshëm dhe ka shumë ankesa nga banorët, por ka shumë pak interes për SO ₂ dhe NO _x .	MEA/MMPH ka mungesë në aftësinë për të ofruar udhëzime teknike për IDM dhe nuk ka mundësi që të përgjigjet në nivel të mjaftueshëm. Në veçanti, ankesat nga banorët tek KEK-u janë të shumta, dhe megjithëse është planifikuar zvogëlimi i emisioneve të Pluhurit përmes rehabilitimit të TC Kosova B, aftësia për t'i vlerësuar pajisjet që do të instalohen është i pamjaftueshëm. Investimi në masat mjedisore ndikon në

		<p>tarifat e energjisë elektrike, por si duket konsumatorët nuk kanë njohuri të mjaftueshme për këtë çështje.</p> <p>Për sa i përket përmirësimit të FES-ve, janë zbatuar rezultatet e studimit përmes bashkëpunimit ndërmjet industrisë, akademisë dhe qeverisë, dhe kjo është bërë një nga rezultatet më të mëdha të Projektit.</p>
<p>Rezultati</p>		<p>Masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM dallojnë për secilin impiant. Prandaj, kërkohet gjykimi i vlerave të emisioneve dhe njohuria teknike, por ka mangësi në burimet njerëzore të H/L të cilët e kanë këtë njohuri.</p> <p>Për sa i përket masave për zvogëlimin e emisioneve me përmirësimin e metodës së operimit të kaldajës, H/L përgjegjës në TC Kosova A pothuajse ka arritur nivelin ku vetë mund ta bëjë ekzaminimin, dhe ata do të jenë në gjendje të gjejnë mënyra për t'i menaxhuar emisionet dhe ta operojnë kaldajën në mënyrë që mundësisht t'i zvogëlojnë emisionet me pajisjet aktuale.</p> <p>Për sa i përket TC Kosova A, janë propozuar dhe janë duke u zbatuar metodat e zvogëlimit të SO₂ dhe NOX me përmirësimin e metodës së operimit të kaldajës si dhe masat për zvogëlimin e Pluhurit të cilat mund të zbatohen me investim të vogël.</p> <p>Disa përmirësime tashmë i janë aplikuar FES-ve bazuar në rezultatet e studimit të kryer në këtë Projekt përmes bashkëpunimit industri-akademi me Universitetin e Prishtinës, dhe ky ishte një rezultat i madh i Projektit.</p> <p>Janë bërë propozime për sa i përket masave për zvogëlimin e SO₂ dhe NOx, por këto kërkojnë investime të konsiderueshme dhe është vështirë që të aplikohen për shkak se përfshijnë modifikimin e kaldajës.</p>
<p>Çështjet/Propozimet</p>		<p>Për sa i përket zvogëlimit të emisioneve për IDM, rehabilitimi i TC Kosova B, ndërtimi i Termocentralit të ri (TC Kosova e Re), ndalja e TC Kosova A për shkak të fillimit të punës së Termocentralit të ri janë të planifikuara zë përfundojnë rreth vitit 2023.</p> <p>Prandaj, masat për zvogëlimin e emisioneve në TC Kosova A kanë problemin e anës financiare (financimi dhe ndikimi në tarifa) dhe është problem i madh sepse zbatimi i tyre nuk është i lehtë.</p> <p>Masat për zvogëlimin e emisioneve me përmirësimin e metodës së operimit janë masa bazike të cilat nuk kërkojnë investim, dhe gjithashtu mund të aplikohen në TC Kosova B e cila do të vazhdojë operimin.</p> <p>Gjatë futjes në përdorim të pajisjeve mjedisore në të ardhmen, është e rëndësishme që të zvogëlohen emisionet nga kaldaja për aq sa është e</p>

	mundur në mënyrë që të minimizohet kosto e pajisjeve për zvogëlimin e emisioneve.
--	---

Tabela 7 Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultatin 7

Niveli individual	Niveli organizativ	Niveli social
7-1 Vlerësimi i planifikimit dhe zbatimit të testit për ta sqaruar sjelljen e përbërjes së gazit të shkarkuar të IDM-ve		
7-2 Vlerësimi i masave për burimet e emisioneve bazuar në teorinë themelore		
7-3 Vlerësimi i masave për burimet e emisioneve përmes përmirësimit të operimit të IDM-së		

	Pikat e Vlerësimit			
7-1	<u>Pala kosovare me ndihmën e Ekspertëve të JICA bën analizën e sjelljes së gazit të shkarkuar nga oxhaku i IDM-ve duke përfshirë SO₂.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne tashmë i kemi konfirmuar informacionet ekzistuese	2,1	→ 2.3	→ 2.2
A	Ne tashmë i dimë mekanizmat e gjenerimit të ndotësve	1,8	→ 1.9	→ 2.2
B	Organizata jonë tashmë i ka caktuar personat përgjegjës për zvogëlimin e emisioneve të IDM-ve të cilët kanë njohuri të mjaftueshme për ndotësit e ajrit.	3,6	→ 3.6	↗ 4.3
C	Kosova mund ta krijojë kornizën për koordinimin e nevojshëm ndërmjet agjencive relevante për masat e zvogëlimin të emisionit për IDM-të.	3,0	↑ 3.9	↗ 4.2
Ky është vlerësim i aftësisë për ta sqaruar sjelljen e përbërjes së gazit të shkarkuar, duke përfshirë SO ₂ të TC Kosova A.				
Gjendja aktuale e përbërjes së gazit të shkarkuar është sqaruar nëpërmjet hetimit dhe analizës së				

ESP-së për sa i përket Pluhurit dhe matjes dhe analizës për SO₂ dhe NO_x, dhe vetëdijesimi i H/L është rritur.

Për sa i përket SO₂, pasi që u bë e qartë se dukuria ishte jashtëzakonisht e komplikuar, ata pranuan se nuk kanë njohuri të mjaftueshme në nivel individual.

Mirëpo, në periudhën e dytë u bë e qartë se SO₂ mund të ndryshohet me metodën e operimit të kaldajës, dhe në periudhën e tretë JET-i ofroi mbështetje nga Japonia dhe H/L vazhduan aktivitetet, si rezultat motivimi i H/L për zvogëlimin e emisioneve u rrit dhe rezultati i vlerësimit u rrit.

Në anën tjetër, në nivel organizativ, ata e kuptuan nevojën për të bashkëpunuar dhe nxitit studimin. Në nivelin social, rëndësia e masave të kontrollit të emisioneve të IDM-së është rritur.

7-2	<u>Ekspertët e JICA-s do ta mbajnë një seminar dhe një punëtori për t'i diskutuar masat për zvogëlimin e emisioneve për IDM-të dhe burimet e tjera të palëvizshme duke përfshirë teorinë fundamentale të kontrollit të emisioneve.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne tashmë i kemi informacionet për zvogëlimin e emisioneve nga IDM-të	3,9	→ 4.0	↗ 4.3
B	Organizata jonë mund ta propozojë metodën për masat e zvogëlimin të emisioneve për IDM-të.	4,3	↘ 3.9	↗ 4.2
C	Kosova e ka sistem administrativ për propozimin e masave për zvogëlimin e emisioneve.	3,7	↘ 3.5	↗ 4.0

H/L kanë mësuar për masat e kontrollit të emisioneve për IDM-të dhe burimet e tjera të palëvizshme përmes punëtorive dhe seminareve.

Kur të planifikohet futja në përdorim e pajisjeve të reja, është e nevojshme të merren parasysh rregulloret e ardhshme mjedisore, dhe për përdorimin e pajisjeve është e nevojshme të kuptohet teoria themelore e pajisjeve. Mirëpo, për sa i përket kësaj, duket se është e pakët, ndoshta për shkak të karakterit kombëtar të Kosovës.

Është e vështirë të ndryshohet së shpejti, por meqenëse rehabilitimi i TC Kosova B ka filluar, shpresohet që këto aftësi teknike të përmirësohen duke provuar pajisjet e reja mjedisore.

7-3	<u>Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s përcakton diagnozën për operacionet e IDM-ve dhe shtjellon përmirësimet operacionale për zvogëlimin e emisioneve.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta vlerësojmë metodën e zvogëlimin të emisioneve nga IDM-të përmes analizimit të sjelljes së gazit të shkarkuar nga oxhaku i IDM-ve	4,0	→ 4.0	↗ 4.4
B	Organizata jonë mund të vendosë mbi specifikimet e sistemit/pajisjeve të përshtatshme për zvogëlimin e emisioneve ashtu që ta respektojë rregulloren.	3,3	↗ 4.0	↘ 3.8
C	Kosova mund ta krijojë procedurën e përgatitjes së masave për zvogëlimin e emisioneve për IDM-të përmes koordinimit të duhur ndërmjet agjencive relevante.	3,0	↑ 3.8	↗ 4.4

Ka për qëllim aftësimin për ta kryer diagnostikimin e operimit të IDM-së dhe vetë të propozojnë masa të përmirësimit përmes përmirësimit të metodës së operimit të kaldajës për t'i zvogëluar emisionet.

Vetëdija e H/L u rrit përmes ekzaminimit të përmirësimit të shpërndarjes së rrjedhës së gazit në

FES, ligjëratat për përmirësimin e sistemit të ngarkimit të energjisë elektrike, hulumtimin e sjelljes së SO₂ përmes përmirësimit të metodës së operimit të kaldajës, etj.

Për sa i përket sjelljes së SO₂, duket se dukuria është aq e komplikuar sa që kërkon njohuri të përparuar dhe H/L duket se ka arritur kufirin në nivelin individual. Mirëpo, si rezultat i mbështetjes së JET-it nga Japonia dhe vazhdimin të aktivitetëve të projektit në periudhën e tretë, duket se motivimi i H/L për zvogëlimin e emisionëve u rrit.

(8) Rezultati 8: Pala kosovare zhvillon kapacitetet për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.

Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve për Rezultatin 8 janë paraqitur në Tabelën 8. Pastaj, paraqitet rezultati mesatar për secilin pyetësorë në të cilin janë përgjigjur H/L dhe GP-H/L dhe komentet nga ana e JET-it gjithashtu përshkruhen afër grafikut të pyetësorëve.

Aktivitetet e Rezultatit 8 filluan me seriozitet në mes të periudhës së dytë, dhe aktivitete mjaft të përqendruara u kryen në periudhën e tretë. Në periudhën e dytë, rishikimet e Masave të përgatitura tashmë në Kosovë dhe projektin tjetër të JICA-s ishin kryesisht të përqendruara, por në periudhën e tretë u konsideruan më gjerësisht planifikimi i Masave, llogaritja e zvogëlimeve të emisionëve dhe kosto - efektiviteti i Masave duke përdorur inventarin e emisionëve, studimin e metodës dhe çështjeve të zbatimit për sa i përket Masave, dhe rezultatet u përmbledhën si fletë e vlerësimit të Masave. Meqenëse përmes këtyre aktivitetëve u zhvillua kapaciteti dhe u qartësuan sfidat në zbatimin e Masave, zhvillimi i kapaciteteve u rrit në nivelin individual, nivelin organizativ dhe social, dhe u sqaruan fushat të cilat mungonin. Kjo u reflektua në rezultatin e testit të vetëvlerësimit.

Vlerësimi i zhvillimit të kapacitetit të H/L i gjykuar nga JET-i është përmbledhur si në vijim.


	Pika fillestare	Pika përfundimtare
Niveli individual (A)	H/L ishin në gjendje t'i përpilojnë Masat, mirëpo ata nuk ishin në gjendje ta bëjnë vlerësimin e plotë të arsyeshmërisë teknike, ekonomike dhe sociale të Masave.	Përmes përgatitjes së fletës së vlerësimit për Masat, u thellua të kuptuarit e nevojës për të dhëna shkencore dhe teknike në planifikimin, studimin dhe vlerësimin e Masave. Në të njëjtën kohë, H/L thelluan të kuptuarit e konsideratave socio-ekonomike. Përmes Projektit, H/L ishin në gjendje ta thellojnë të kuptuarit e tyre për rolet e qeverisë për sa i përket Masave. Në anën tjetër, nuk ka përvojë të mjaftueshme të H/L për planifikimin, studimin, vlerësimin dhe zbatimin e Masave në mënyrë të pavarur në të ardhmen.
Niveli organizativ	Ishte situatë ku masat janë	Meqenëse aktivitetet siç janë kuantifikimi i

(B)	<p>konsideruar jo si MEA/MMPH por si individë.</p> <p>Për më tepër, nuk ishte situatë ku masat janë përpiluar duke marrë parasysh arsyeshmërinë teknike, ekonomike dhe sociale.</p>	<p>zvogëlimeve të emisioneve duke përdorur inventarin e emisioneve dhe studimi i rezultateve të modelimit të simulimit u shkëmbyen përmes përgatitjes së fletës së vlerësimit të Masave, u përmirësua zhvillimi i kapacitetit në nivelin organizativ.</p> <p>Mirëpo, MEA/MMPH është ende në fazën e përpjekjes për ta krijuar kornizën institucionale për Masat dhe nuk është në gjendje që në mënyrë sistematike dhe të pavarur të planifikoj, studioj, vlerësoj dhe zbatoj Masat në të ardhmen.</p>
Niveli social (C)	<p>Megjithëse nevoja për Masat është kuptuar, të kuptuarit e masave konkrete ka qenë i paktë.</p>	<p>Pasi që përmes Projektit i cili ka përfshirë aktivitetet e përgatitjes së Fletës së Vlerësimit të Masave, aktivitetet për planifikimin, studimin, vlerësimin dhe zbatimin e Masave janë kryer përmes diskutimeve dhe konsultimeve me organizatat përkatëse, u rritën kapacitetet në nivelin social.</p> <p>Për më tepër, përmes aktiviteteve të Projektit të mbuluara nga mediat, siç janë hulumtimet masive në terren nga shumë studentë nën Projekt, etj., të kuptuarit në nivelin social gradualisht është duke avancuar.</p>
Rezultati	<p>Pasi që përmes përgatitjes së fletës së vlerësimit të Masave, është kryer kuantifikimi i zvogëlimeve të emisioneve dhe kosto - efektiviteti, konsiderimi i metodës dhe çështjeve të zbatimit, vlerësimi në aspektin teknik dhe social, etj., kapaciteti për secilin proces të Masave si planifikimi, studimi, vlerësimi dhe zbatimi i Masave janë përmirësuar.</p> <p>Duke përdorur 17 Objektivat e OZHQ-ve si tregues të vlerësimit në nivelin social për Masat, H/L ishin në gjendje ta bënin vlerësimin e efekteve sociale të Masave në mënyrë objektive jo arbitrare.</p> <p>Meqenëse kuantifikimi i zvogëlimeve të emisioneve është llogaritur duke përdorur inventarin e emisioneve, H/L me mbështetjen e JET-it ishin në gjendje që vetë t'i caktonin kushtet e llogaritjes dhe llogaritnin zvogëlimet e emisioneve në bashkëpunim me grupin e Rezultatit 1. Në të njëjtën kohë, H/L me mbështetjen e JET-it ishin në gjendje ta llogaritnin dhe vlerësonin kosto - efektivitetin sipas skenarit të zvogëlimit të emisioneve duke diskutuar</p>	

	<p>koston e kushteve të llogaritjes.</p> <p>Për sa i përket metodës së zbatimit të Masave, u bë e mundshme të ketë diskutime më të thella lidhur me masat duke u konsultuar jo vetëm me anëtarët e H/L por edhe policinë e trafikut (MPB) dhe kompaninë e ngrohjes qendrore publike (Termokos).</p>
Çështjet/Propozimet	<p>Meqenëse rezultatet e Projektit do të ndahen me shoqërinë në të ardhmen dhe aktivitetet e donatorëve të huaj si MCC/MFK gjithashtu janë duke përparuar, pritet që të kuptuarit në të ardhshmen i Masave në nivelin social do të përparojnë.</p> <p>Meqenëse udhëheqësja e H/L, e cila ka zbatuar planin e Masave në mënyrë proaktive në MEA/MMPH, u pensionua nga MEA/MMPH para fillimit të periudhës së tretë, personit të ri përgjegjës për Masat i mungonte përvoja. Mirëpo, pasi që Projekti e punësoi këtë udhëheqëse të mëparshëm si konsulente vendore dhe ofroi fushat e diskutimeve më të thella, puna për Masat ishte në gjendje të merrej përsipër. Në të ardhmen, do të jetë e nevojshme të përmirësohen kapacitetet, duke u përqendruar kryesisht tek ky person i ri.</p> <p>Në të ardhmen, do të jetë e nevojshme të kryhet planifikimi, studimi, vlerësimi dhe zbatimi i Masave në nivel të vendit. Për ta bërë këtë, është e nevojshme të merren parasysh Masat për shumë fusha siç janë kategoria e industrisë prodhuese, sektori i bujqësisë dhe sektori i mbeturinave, të cilat nuk janë konsideruar plotësisht në Projekt. Për më tepër, në lidhje me Masat e marra në parasysh nga Projekti, është e nevojshme mbështetja për planifikimin, studimin, vlerësimin dhe zbatimin e Masave të mëtutjeshme, duke përdorur të dhënat e hollësishme siç është konsiderimi i Masave sipas performancës aktuale të emisioneve në Kosovë dhe sipas rajonit.</p>

Tabela 8 Rezultatet e Vlerësimit të Kapaciteteve për Rezultatin 8

Niveli individual	Niveli organizativ	Niveli social																								
8-1 Vlerësimi i arsyeshmërisë teknike, ekonomike dhe sociale e masave të kontrollit të ndotjes për burimet e rëndësishme të emisioneve																										
<table border="1"> <caption>Individual Level Assessment Data</caption> <thead> <tr> <th>Period</th> <th>Score</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1st Period</td> <td>3.0</td> </tr> <tr> <td>2nd Period</td> <td>3.8</td> </tr> <tr> <td>3rd Period</td> <td>3.5</td> </tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	3.0	2nd Period	3.8	3rd Period	3.5	<table border="1"> <caption>Organizational Level Assessment Data</caption> <thead> <tr> <th>Period</th> <th>Score</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1st Period</td> <td>3.0</td> </tr> <tr> <td>2nd Period</td> <td>3.8</td> </tr> <tr> <td>3rd Period</td> <td>3.8</td> </tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	3.0	2nd Period	3.8	3rd Period	3.8	<table border="1"> <caption>Social Level Assessment Data</caption> <thead> <tr> <th>Period</th> <th>Score</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1st Period</td> <td>2.5</td> </tr> <tr> <td>2nd Period</td> <td>3.8</td> </tr> <tr> <td>3rd Period</td> <td>3.5</td> </tr> </tbody> </table>	Period	Score	1st Period	2.5	2nd Period	3.8	3rd Period	3.5
Period	Score																									
1st Period	3.0																									
2nd Period	3.8																									
3rd Period	3.5																									
Period	Score																									
1st Period	3.0																									
2nd Period	3.8																									
3rd Period	3.8																									
Period	Score																									
1st Period	2.5																									
2nd Period	3.8																									
3rd Period	3.5																									
8-2 Vlerësimi i efekteve të zvogëlimit të emisioneve të masave të kontrollit të ndotjes në burimet e rëndësishme të emisioneve																										



8-3 Vlerësimi i efekteve të përmirësimit të cilësisë së ajrit përmes masave të kontrollit të ndotjes duke shfrytëzuar modelin e simulimit të dispersionit

Pikat e Vlerësimit				
8-1	<u>Pala kosovare me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bën vlerësimin e arsyeshmërisë teknike, ekonomike dhe sociale të masave të kontrollit të ndotjes për burimet e rëndësishme të emisioneve.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne kemi të dhëna dhe informacione të mjaftueshme kuantitative dhe u ofrojmë vendimmarrësve informacione të mjaftueshme për ta studiuar arsyeshmërinë teknike, ekonomike dhe sociale të masave të kontrollit të ndotjes për burimet e rëndësishme të emisionit.	3,00	↗ 3.67	↘ 3.33
B	Organizata jonë mund ta bëjë vlerësimin e ndotjes së ajrit në mënyrë kuantitative për burimet e rëndësishme të emisionit si dhe të ketë agjenci relevante që do të ishin në gjendje ta vlerësojnë arsyeshmërinë teknike, ekonomike dhe sociale të masave të kontrollit të ndotjes.	3,00	↗ 3.67	→ 3.67
C	Kosova mund ta bëjë vlerësimin e arsyeshmërisë teknike, ekonomike dhe sociale të masave të kontrollit të ndotjes për burimet e rëndësishme të emisioneve.	2,50	↗ 3.67	↘ 3.33

Përmes rishikimit të planit të veprimit të Kosovës për çështjet e ndotjes së ajrit nga JET-i dhe ndarjes së aktiviteteve për përgatitjen e inventarëve të emisioneve, H/L kanë thelluar të kuptuarit e tyre për vlefshmërinë teknike dhe socio-ekonomike të masave për burimet e rëndësishme të emisioneve. Në anën tjetër, në periudhën e tretë në lidhje me masat më konkrete, janë marrë parasysh kuantifikimi i zvogëlimit të emisioneve, vlerësimi i kosto - efektivitetit, studimi i metodës së zbatimit të masave, çështjet për masa, etj. dhe janë marrë parasysh dhe janë përgatitur fletët për vlerësimin e masave. Si rezultat, pasi që H/l kuptuan edhe njëherë vështirësinë e ekzaminimit të vlefshmërisë teknike dhe socio-ekonomike të masave, rezultati nga H/L nuk është rritur aq shumë. Kjo tregon nevojat për mbështetje të vazhdueshme në këtë fushë.

8-2	<u>MMPH dhe agjencitë relevante me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bëjnë vlerësimin e efekteve</u>	Mesatarja e parë	Mesatarja e dytë	Mesatarja e tretë
------------	---	------------------	------------------	-------------------

	<u>të zvogëlimit të emisioneve përmes masave të kontrollit të ndotjes për burimet e rëndësishme të emisioneve.</u>	(6/2/2018)	(31/1/2019)	(25/2/2020)
A	Ne mund t'i dimë (matim ose vlerësojmë) emisionet nga burimet e rëndësishme të emisionit.	3,50	↗ 3.67	→ 3.67
B	Organizata jonë ka informacione të mjaftueshme dhe mund të planifikojë dhe zbatojë masa për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme.	3,25	↗ 3.67	→ 3.67
C	Kosova mund të mbledhë informacione të mjaftueshme mbi teknologjitë për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme dhe ta koordinojë kornizën me agjencitë relevante për t'i planifikuar dhe zbatuar masat për zvogëlimin e emisioneve për burimet e tjera të palëvizshme.	3,00	↑ 4.00	→ 4.00
<p>Meqenëse H/L ndanë aktivitetet e llogaritjes së zvogëlimit të emisioneve duke përdorur inventarin e emisioneve, konsiderohet se u thellua kuptuarit e H/L për efektet e zvogëlimit të emisioneve të ndotësve të ajrit të masave për burimet e rëndësishme. Në Projektin JICA, meqenëse u morën parasysh masat e zvogëlimit të emisioneve nga TC-të, shtëpitë rezidenciale dhe automjetet, u sqarua llogaritja e efektivitetit të zvogëlimit të emisioneve, si dhe çështjet për të ardhmen, siç është përmirësimi i zbatimit të masave. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë nevoja të mëdha për studimin dhe vlerësimin e burimeve të tjera të emisioneve. Për shkak të këtyre faktorëve, mendohet se rezultati për periudhën e tretë është i pandryshuar.</p>				
<u>8-3</u>	<u>MMPH-ja me asistencën e Ekspertëve të JICA-s bën vlerësimin e efekteve të përmirësimit të cilësisë së ajrit përmes masave të kontrollit të ndotjes duke shfrytëzuar modelin e simulimit të dispersionit.</u>	Mesatarja e parë (6/2/2018)	Mesatarja e dytë (31/1/2019)	Mesatarja e tretë (25/2/2020)
A	Ne mund ta përdorim modelin e simulimit të dispersionit për vlerësimin e efekteve të masave të kontrollit të ndotjes në përmirësimin cilësisë së ajrit.	2,75	↗ 3.33	↑ 4.33
B	Organizata jonë din se si ta përdorë modelin e simulimit të dispersionit për vlerësimin e efekteve të masave të kontrollit të ndotjes në përmirësimin cilësisë së ajrit.	2,75	↗ 3.33	↘ 3.00
C	Kosova ka kornizën për ta përgatitur dhe zbatuar modelin e simulimit për vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes.	2,00	↑ 3.00	↗ 3.33
<p>Meqenëse vlerësimi i efekteve në përmirësimin e cilësisë së ajrit nga masat e kontrollit të ndotjes duke përdorur modelin e simulimit të shpërndarjes nuk është zbatuar deri më 25 shkurt 2010 të periudhës së tretë, mendohet se rezultati nga H/L është paksa i ulët. Në anën tjetër, meqenëse H/L e kuptojnë se si të vazhdohet me vlerësimin e masave përmes ligjëratës për përgatitjen e fletëve të vlerësimit për masat e kryera në periudhën e tretë, supozohet se rezultatet në nivelin individual (A) janë në rritje.</p>				

**Republika e Kosovës
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe
Infrastrukturës**

**Republika e Kosovës
Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve
për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit
Raporti i Përfundimit të Projektit
Shtojca -3**

Gusht 2021

Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)

**SUURI-KEIKAKU CO., LTD.
JFE Techno-Research Corporation**



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor




Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.1 (Janar 2018)

Republika e Kosovës (këtu e tutje “Kosova”) është tërësisht e varur nga linjiti i cilësisë së dobët, të mihur në vend, si burim kryesor i energjisë për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes, etj. Për këtë arsye, ndotja e ajrit në zonat urbane është bërë problem serioz mjedisor dhe efekti i saj në shëndetin e njeriut është shqetësim i madh.

Në përgjithësi kontrolli i ndotësve të ajrit përbëhet nga 1) matja e burimeve të emisioneve të ndotësve të ajrit, 2) monitorimi i cilësisë së ajrit dhe 3) vlerësimi i cilësisë së ajrit duke marrë parasysh të dhënat shkencore dhe teknike. Figura e mëposhtme tregon këto aktivitete qeveritare.



Këto aktivitete janë të përfshira në Projektin e JICA-s dhe projekti i JICA-s zhvillohet në zonën e Prishtinës.

Qëllimi i Projektit të JICA-s është përmirësimi i kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (këtu e tutje “MMPH”) si dhe organizatave dhe agjencive të saj përkatëse për menaxhimin e ndotësve të dëmshëm të ajrit, duke kontribuar kështu në planifikimin dhe

zbatimin e masave më efektive për zvogëlimin e emisioneve në ajër, për mbrojtjen e shëndetit publik dhe zhvillimin e politikave të lidhura me menaxhimin mjedisor në Kosovë.

Projekti i JICA-s ka filluar në tetor 2017.

Aktivitetet e zhvilluara në dhjetor 2017 kanë qenë shqyrtimi i kontrollit të emisioneve në termocentrale (këtu e tutje “TC”) dhe mbledhja e informacionit për Vlerësimin e Cilësisë së Ajrit përmes mbajtjes së seminarit.



Vizitat për hulumtimin në terren të TC-ve



Seminari në MMPH



Takimi Konsultativ në Universitet

Në vitin 2018 do të fillojë aktiviteti për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit.

Përveç kësaj, ekspertët e JICA-s dhe Homologët (kryesisht MMPH-ja) do të kryejnë hulumtime të burimeve të emisionit me mbështetjen e studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Aktiviteti në TC-të gjithashtu do të kryhet



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes
së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.1 (Janar 2018)

në mënyrë të vazhdueshme duke matur
emisionet e gazit nga oxhaku për t'i studiuar
masat për zvogëlimin e emisioneve.



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.2 (Shkurt 2018)

Në fund të janarit të këtij viti, ajri në rajonin e Prishtinës u bë shumë i ndotur. Në lidhje me këtë shqetësim publik në Republikën e Kosovës u ngrit shumë shpejt. Si rezultat i kësaj situatë, Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor zhvilloi një takim me Ekipin e Ekspertëve të JICA-s më 12 shkurt 2018.

Në këtë takim Ekipi i Ekspertëve i JICA-s shpjegoi dhe diskutoi çështjet e cilësisë së ajrit me Ministren e MMPH-së. Për më tepër, ekspertët e JICA-s sqaruan se kushtet atmosferike kishin efekt të madh në cilësinë e ajrit në rajonin e Prishtinës.



Gjatë të njëjtës ditë, ky takim u raportua edhe në faqen e internetit të një gazete. Ju

lutemi ndiqni linkun:

URL:<http://www.gazetaexpress.com/lajme/japonezet-do-te-nisin-nj-hulumtim-per-identifikimin-e-ndotesve-te-ajrit-ne-prishtine-498731/>

Më 14 shkurt 2018, z. Shimizu (këshilltari kryesor i projektit të JICA-s) dhe znj. Nezakete Hakaj (menaxhere e projektit) morën pjesë në xhirimin e një programi televiziv. Ky program televiziv u shfaq më 15 mars 2018 në ora 20:00 në Radio Televizionin e Kosovës.

Për vlerësim dhe vendimmarrje për sa i përket kontrollit të ndotësve të ajrit në përgjithësi nevojiten tri lloje të të dhënave shkencore dhe teknike: 1) matja e burimeve të emisioneve të ndotësve të ajrit, 2) monitorimi i cilësisë së ajrit dhe 3) vlerësimi i cilësisë së ajrit përmes modelimit (llogaritjes) të simulimit duke përdorur inventarin e emisioneve, të dhënat meteorologjike dhe të dhënat gjeografike.

Në vitin 2018 do të fillojë inspektimi i Stacioneve të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit (SMCA-të). SMCA-të kanë pajisje automatike të matjes së cilësisë së ajrit të mjedisit. Kosova i ka 11 SMCA. Megjithatë, cilësia e të dhënave të marra nga SMCA-të nuk është e kënaqshme dhe ende nuk është në dispozicion të/e shfaqur për publikun.



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes
së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.2 (Shkurt 2018)



Projekti i JICA-s e mbështet krijimin e qëndrueshmërisë së SMCA-ve.

Për më tepër, ekspertët e JICA-s dhe H/L (përkatësisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) do të kryejnë hulumtimin e burimeve të emisionit me ndihmën e studentëve të Universitetit të Prishtinës. Më 29 janar 2018, Eksperti i JICA-s mbajti një ligjëratë për studentët në Universitetin e Prishtinës me qëllim të prezantimit të Projektit të JICA-s dhe që studentët t'i kuptojnë çështjet e ndotësve të ajrit.

Hulumtimi për ndotësit e ajrit do të fillojë në fund të shkurtit. Rezultatet e këtij hulumtimi do të bëhen të dhëna bazë për çështjet e ndotësve të ajrit.





Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes
së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.3 (Gusht 2018)

Hulumtimi për Konsumin Aktual të Lëndës Djegëse dhe Numërimi i Vëllimit të Trafikut në bashkëpunim me Studentët e Universitetit të Prishtinës

Gjatë Projektit të Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës (Projekt i JICA-s), hulumtimi në terren në zonën e Prishtinës siç janë intervistat e hulumtimit dhe numërimi i vëllimit të trafikut janë kryer nga studentët e Universitetit të Prishtinës (UP). Informacionet e mbledhura nga këto hulumtime janë të dhëna fundamentale dhe themelore për inventarin e emisioneve.



Këto hulumtime u kryen me qëllim të përgatitjes së inventarit të emisioneve të ndotësve të ajrit, e cila është listë gjithëpërfshirëse e burimeve të emisioneve duke përfshirë edhe sasitë e emisioneve të ndotësve të ajrit. Përmes përgatitjes së inventarit të emisioneve vlerësohen emisionet kuantitative për secilin burim të emisioneve. Megjithatë, pasi që është e pamundur të kryhet numërimi i plotë i burimeve të emisioneve, janë kryer hulumtimet përmes mostrës dhe emisionet janë vlerësuar duke përdorur rezultatet e këtyre hulumtimeve.

Para kryerjes së hulumtimit në terren, për studentët e UP-së janë dhënë ligjërata informuese për projektin JICA-s, kryesisht për inventarin e emisioneve.

Intervistat e hulumtimit për amvisëritë, shërbimet publike dhe private, si dhe objektet e vogla biznesore u kryen nga muaji shkurt deri në muajin mars, me qëllimin kryesor për t'i mbledhur informacionet për konsumin aktual të lëndës djegëse për ngrohje.

1 . Intervistat e Hulumtimit për Amvisëritë

Njëzetë (20) Studentë nga Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” kanë kryer intervista të hulumtimit për konsumin e lëndës djegëse në amvisëri. Pasqyra e intervistave për amvisëri është siç vijon.

Metoda	Intervistat e Hulumtimit nga 20 studentë
Pikat	Informacioni për lokacionin, Lloji i ndërtesës, Hapësira e banimit, Numri i banorëve, Viti i ndërtimit, Modeli ditor i ngrohjes, Modeli vjetor i ngrohjes, Lloji i lëndës djegëse, Sasia vjetore e konsumuar e lëndës djegëse, Lartësia e oxhakut
Plan-programi	Secili student ka kryer intervista për dhjetë (10) ditë nga 20 shkurti deri



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor




Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes
 së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.3 (Gusht 2018)

	më 31 mars.
Zona	Komuna e Prishtinës, Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Obiliqit



Amvisëritë e synuara për intervista të hulumtimit janë shtëpitë individuale, shtëpitë e bashkëngjitura, blloqet e banesave, apartamentet dhe të tjerat. Numri i përgjithshëm i mostrës është rreth dy mijë.



2. Intervistat e Hulumtimit për Shërbime Publike dhe Private

16 Studentë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” kanë kryer intervista të hulumtimit për konsumin e lëndës djegëse në shërbimet publike dhe private. Pasqyra e intervistave për shërbimet publike dhe private është siç vijon.

Metoda	Intervistat e Hulumtimit nga gjashtëmbëdhjetë (16) studentë
Pikat	Informacioni për lokacionin, Hapësira e ndërtesës, Numri i punëtorëve, studentëve, Viti i ndërtimit, Qëllimi i përdorimit (lloji i shërbimit), Pajisjet që konsumojnë lëndë djegëse, Modeli ditur i ngrohjes ose operimit, Modeli



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor




Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes
së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.3 (Gusht 2018)

	vjetor i ngrohjes ose operimit, Lloji i lëndës djegëse, Sasia vjetore e konsumuar e lëndës djegëse, Lartësia e oxhakut
Plan-programi	Secili student ka kryer intervista për dhjetë (10) ditë nga 22 shkurti deri më 31 mars.
Zona	Komuna e Prishtinës, Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Obiliqit



Shërbimet publike dhe private të synuara për intervista të hulumtimit kanë qenë zyrat, shkollat, restorantet, dyqanet, institucionet mjekësore, etj. Numri i përgjithshëm i mostrës është rreth 1250.





Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.3 (Gusht 2018)


3. Intervistat e Hulmtimit për Objekte të Vogla Biznesore

Dy Studentë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i UP “Hasan Prishtina” kanë kryer intervista të hulmtimit për konsumin e lëndës djegëse në shtatëmbëdhjetë (17) objekte të vogla biznesore. Aktivitetet kryesore ekonomike të këtyre objekteve të vogla biznesore janë prodhimi, riparimi dhe trajtimi i mbeturinave.



4. Numërimi i Vëllimit të Trafikut

Megjithëse në të kaluarën është bërë numërimi i vëllimit të trafikut në shkallë të vogël, Projekti i JICA-s ka kryer numërimin e parë në shkallë të plotë të vëllimit të trafikut në Kosovë, i cili mund të shfrytëzohet për Inventarin e Emisioneve. Gjithsej 160 Studentë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore të UP “Hasan Prishtina” kanë kryer numërimin e vëllimit të trafikut në 24 pika të zonës së hulmtimit.





Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.3 (Gusht 2018)


Pikat e Numërimit të Vëllimit të Trafikut të Automjeteve



Automjetet janë kategorizuar në pesë (5) lloje: veturë për pasagjerë, kombi, autobus, kamion i lehtë dhe kamion i mesëm dhe i rëndë. Në tetë (8) pika Studentët e UP-së kanë kryer numërimin e vëllimit të trafikut gjatë 24 orëve në ditë të punës dhe ditë të vikendit, duke përfshirë kohën e natës. Numërimi i vëllimit të trafikut në gjashtëmbëdhjetë (16) pikat e mbetura është bërë për 14 orë gjatë kohës së ditës në ditë të javës.

5. Në të Ardhmen e Afërt

Do të analizohen të dhënat e marra nga këto hulumtime në terren dhe do të përgatitet Inventari i Emisioneve për zonën e Prishtinës duke shfrytëzuar metodën e vlerësimit për emisionet e ndotësve të ajrit.





Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.4 (Dhjetor 2018)

Forcimi i matjes së gazit të shkarkuar nga Impiantet me Djegie të Mëdha

Studimi i masave të kontrollit të ndotjes së ajrit kërkon të kuptuarit e emisioneve ekzistuese nga burime të ndryshme. Ndër burimet e shumta të emisioneve, është esenciale të maten ndotësit si pluhuri, dyoksidi i sulfurit (SO_2), oksidet e azotit (NO_x), etj. nga Impiantet me djegie mëdha (IDM-të) siç janë impiantet me djegie të thëngjillit.

Republika e Kosovës (Kosova) është njëra nga palët kontraktuese të Traktatit të Energjisë dhe duhet ta zbatojë Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE). Në Kosovë, TC Kosova A dhe TC Kosova B janë IDM-të që janë synim i PKZE-së, dhe PKZE-ja kërkon që pluhuri, SO_2 dhe NO_x nga këto termocentrale t'i plotësojnë Vlerat e Kufirit të Emisioneve (VKE-të) në përputhje me Direktivën e BE-së për IDM-të.

Projekti për Zhvillimin e Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit (Projekti) po e mbështet Kosovën në përvetësimin e aftësisë për matjen e gazrave të shkarkuara,

Ky transferim i teknologjisë ka filluar rreth dy vite më parë përmes punës së mëhershme të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) dhe ende po vazhdon. Si fazë përfundimtare Projekti ka kryer transferimin e teknologjisë për matjen e gazit të shkarkuar, nga fillimi i muajit prill deri në mesin e muajit maj të këtij viti në TC Kosova A dhe TC Kosova B.



Fotografi të matjes së gazit të shkarkuar në TC Kosova A



Fotografi të matjes së gazit të shkarkuar në TC Kosova B





Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor




Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.4 (Dhjetor 2018)

Deri më tani, ndotësit janë matur me matës të pluhurit (matje të pluhurit) dhe analizator të automatizuar të gazit. Mirëpo, matësi i pluhurit kërkon kalibrim përmes teknologjisë të cilën Projekti është përpjekur ta transferojë dhe vlerat nga matësit e pluhurit nuk mund të jenë aq të besueshme pasi që nuk janë kalibruar me këtë metodë. Në të njëjtën kohë, Projekti ka përgatitur një analizator portativ të automatizuar të gazit i cili mundëson matjen në çdo kohë dhe sipas nevojës.


Më poshtë është shpjegimi për teknologjinë e matjes së pluhurit.

Në përgjithësi matja e pluhurit kryhet nga instrumenti i quajtur matësi i pluhurit. Një shembull i procesit të matësit të pluhurit është treguar më poshtë.



Ky matës i pluhurit emeton dritën nga njëra anë dhe një përqindje e dritës arrin në anën tjetër. Matësi llogarit përmbajtjen e pluhurit bazuar në intensitetin e dritës së transmetuar në anën tjetër. Kur përmbajtja e pluhurit është e lartë, drita reflektohet shumë dhe intensiteti i dritës që arrin anën tjetër zvogëlohet. Në anën tjetër, kur përmbajtja e pluhurit është e ulët, intensiteti i dritës së transmetuar është i lartë. Përmbajtja e pluhurit llogaritet përmes këtij parimi. Megjithatë, është e domosdoshme që kjo metodë të kalibrohet nga përmbajtja aktuale e pluhurit, sepse reflektimi i dritës ndikohet nga përmbajtja e pluhurit siç është diametri, forma, etj. të cilat janë të ndryshme nga objekti në objekt.

Në anën tjetër, Projekti është përpjekur ta transferojë teknologjinë e ashtuquajtur mostrimi iso-kinetik. Kjo teknologji bën mostrimin e pluhurit drejtpërdrejt nga gazi i shkarkuar, peshon pluhurin e mbledhur dhe llogarit përmbajtjen e pluhurit. Në këtë teknologji filtri cilindrik i quajtur "Gishtëz" futet në kanalën e gazit të shkarkuar dhe pluhuri mostrohet në rrjedhën e gazit të shkarkuar duke rregulluar shpejtësinë e thithjes së pluhurit me rrjedhën e gazit të shkarkuar. Dallimi i peshës së Filtrit për mostrimin e pluhurit para dhe pas mostrimit tregon përmbajtjen e pluhurit në gazin e shkarkuar. Kjo teknologji ofron përmbajtjen e saktë të pluhurit sepse bën matjen e përmbajtjes së pluhurit drejtpërdrejt në gazin e shkarkuar.



Filtri për

Pluhuri i Mbledhur





Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes
së Ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.4 (Dhjetor 2018)

Në përgjithësi, matësi i pluhurit mund ta masë përmbajtjen e saktë të pluhurit nëse kalibrohet duke përdorur këtë teknologji.

Përvetësimi i teknologjisë së matjes për SO₂, NO_x dhe pluhur jo vetëm që mbështet vlerësimin e saktë të vlerave të emisioneve por gjithashtu mbështet vlerësimin e efekteve nga kushtet e operimit. Vlerat e emisioneve mund të ndryshojnë varësisht nga kushtet e operimit siç janë përbërja e lëndës djegëse, shkalla e konsumit të lëndës djegëse, temperatura, raporti ajër/lëndë djegëse. etj. Teknologjia e matjes gjithashtu ndihmon në studimin e masave për zvogëlimin e emisioneve përmes përmirësimit të kushteve të operimit.

Aktivitetet e lartpërmendura ndihmojnë palën kosovare në kryerjen e matjeve në TC Kosova A dhe TC Kosova B, duke filluar nga përgatitja deri te pastrimi i pajisjeve. Nga tani e tutje, Projekti ka në plan ta bëjë matjen në burime të tjera stacionare dhe edhe më tutje do ta mbështesë palën kosovare në të mësuarit e procesit të matjes, siç janë planifikimi i matjes, përgatitja e pajisjeve dhe materialeve shpenzuese të kërkuar për matje, matja, pastrimi i pajisjeve pas matjes, si dhe organizimi i të dhënave dhe raportimi. Projekti do t'i hartojë këto procedura si Procedurë Standarde Operative.

Nga tani e tutje, Projekti do ta bëjë matjen e gazit të shkarkuar nga burimet e tjera stacionare. Bazuar në rezultatet e matjes, Projekti do ta bëjë vlerësimin e emisioneve, do t'i propozojë masat për zvogëlimin e emisioneve dhe do të sigurojë të dhëna të emisioneve për përgatitjen e inventarit të emisioneve. Shfrytëzimi i këtyre të dhënave për inventarin e emisioneve do të kontribuojë në vlerësimin e efektit të çdo burimi të emisioneve në ajrin e mjedisit.